

NJOHURI THEMELORE FETARE

Tekst mësimor

7

2001

Ky tekst është përgatitur nga një komision

Përkthyes: Dr. Mithat Hoxha

Stamboll, 2001

PERMBAJTJA

| | |
|----------------------------------------------------------------------------------|----|
| PJESA I: I BESOJ ALLAHUT | 1 |
| 1. NEVOJA PER TE BESUAR DHE BESIMI TE ALLAHU..... | 2 |
| a. Allahu ekziston | 2 |
| b. Atributet e Allahut | 3 |
| 2. DASHURIA PER ALLAHUN..... | 7 |
| Lexim letrar: Allahu ekziston..... | 8 |
| Lexim letrar: Ç'kërkon Allahu prej nesh?..... | 11 |
| 3. "AMENTU" DHE KUPTIMI I SAJ | 13 |
| | |
| PJESA II: U BESOJ ENGJEJVE | 14 |
| 1. VEÇORITE E ENGJEJVE | 15 |
| Lexim letrar: Vajza si një engjëll | 17 |
| 2. ENGJEJT QE PERMENDEN NE KUR'AN | |
| DHE VEÇORITE E TYRE | 18 |
| Lexim letrar: Zëri i engjëllit | 20 |
| Lexim letrar: Engjëjt e mëshirës dhe engjëjt e ndëshkimit | 23 |
| Lexim letrar: Edhe Allahu të do ty! | 27 |
| 3. TE JEMI TE MATUR KUDO E KURDO | 29 |
| 4. KREU "KUREJSH" DHE KUPTIMI I TIJ | 32 |
| | |
| PJESA III: U BESOJ LIBRAVE | 33 |
| 1. KUPTIMI MBI LIBRAT E SHENJTE | 34 |
| 2. PERSE ALLAHU KA DERGUAR LIBRA | 34 |
| 3. KATER LIBRAT E MEDHENJ | 35 |
| 4. LIBRI YNE, KUR'ANI | 36 |
| Lexim letrar: Kur'ani është fjala e Allahut | 38 |
| Lexim letrar: Kur'ani, libri ynë i shenjtë | 40 |
| 5. VENDI I KUR'ANIT MES LIBRAVE TE TJERE | 41 |
| 6. DETYRAT TONA PARA KUR'ANIT | 41 |
| Lexim letrar: Këndimi i Kur'anit duke e kuptuar | 44 |
| 7. "KREU MAUN" DHE KUPTIMI I TIJ | 46 |
| | |
| PJESA IV: U BESOJ PROFETEVE | 47 |
| 1. PROFETESIA DHE FEJA..... | 48 |
| Lexim letrar: Profeti është ftues..... | 49 |
| 2. PROFETET. PERSE ALLAHU KA DERGUAR PROFETE?..... | 51 |
| a. Profetët..... | 51 |
| b. Përse Allahu ka dërguar profetë?..... | 51 |
| c. Ç'na mësojnë profetët?..... | 52 |
| 3. Ç'NJEREZ JANE PROFETET?..... | 52 |
| 4. PROFETET QE KANE LIBRA..... | 56 |
| 5. PROFETI YNE, HZ. MUHAMMEDI (a.s.)..... | 58 |
| Lexim letrar: Profeti ynë, shpëtimtari ynë!..... | 60 |
| 6. DETYRAT TONA PARA PROFETIT..... | 61 |
| a. Ta duam dhe respektojmë Profetin tonë..... | 61 |
| b. T'i mbajmë këshillat, t'i marrim si shembull sjelljet dhe veprimet e tij..... | 62 |

| | |
|---------------------------------------------------------------------------|------------|
| Lexim letrar: Profeti ynë s'donte të ngacmonte askënd..... | 64 |
| Lexim letrar: Profeti ynë nuk e shihte veten të veçantë prej shokëve..... | 65 |
| Lexim letrar: Dashuria e Profetit për fëmijët..... | 66 |
| 7. KREU “KAFIRUN” DHE KUPTIMI I TIJ..... | 68 |
| | |
| PJESA V: I BESOJ DITES SE RINGJALLJES..... | 70 |
| 1. DITA E RINGJALLJES..... | 71 |
| Lexim letrar: Jeta e pasosur..... | 73 |
| 2. XHENNETI DHE XHEHENNEMI..... | 75 |
| Lexim letrar: Endrra e Ahmetit..... | 77 |
| Lexim letrar: Fqinji i xhennetit..... | 80 |
| Lexim letrar: Xhenneti dhe xhehennemi..... | 82 |
| Lexim letrar: Ilahi..... | 84 |
| 3. NDIKIMI I BESIMIT NE RINGJALLJEN MBI JETESEN TONE TE PERDITSHME..... | 85 |
| a. Në mendimet tona..... | 85 |
| b. Në sjellje dhe veprime..... | 85 |
| c. Në marrëdhëniet me të tjerët | 86 |
| Lexim letrar: Lutje..... | 87 |
| Lexim letrar: Shqetësimi i Ibrahimit..... | 88 |
| 4. KREU “NASR” DHE KUPTIMI I TIJ..... | 89 |
| | |
| PJESA VI: I BESOJ KADERIT..... | 90 |
| 1. KADERI..... | 91 |
| Lexim letrar: Kaderi i Enisit..... | 92 |
| 2. Ç'ESHTË KAZAJA..... | 96 |
| 3. RENDESIA QE I JEPET PUNES NE ISLAM..... | 96 |
| a. Puna është adhurim..... | 96 |
| b. Allahi i do ata që punojnë..... | 98 |
| c. Kush i ka dy ditë njëloj, është në humbje..... | 98 |
| Lexim letrar: Më mirë luan apo dhelpër e drobitur?..... | 100 |
| 4. KREU “LEHEB” DHE KUPTIMI I TIJ..... | 102 |
| | |
| PJESA VII: DETYRAT TONA MORALE..... | 103 |
| 1. E MIRA. TE JEMI BAMIRES..... | 104 |
| Lexim letrar: E mira..... | 106 |
| 2. TE KRIJOJME MARRËDHENIE TE MIRA ME TE TJERET..... | 108 |
| Lexim letrar: Profeti ynë e pëlqente dhënien e dhuratave..... | 111 |
| Lexim letrar: Fjalët e Profetit tonë për moralin e bukur..... | 112 |
| 3. TE RUHEMI PREJ LUKSIT DHE SHPENZIMIT TE TEPERT.... | 114 |
| Lexim letrar: Vedati dhe Sedati..... | 116 |
| 4. KREU “FELAK” DHE KUPTIMI I TIJ..... | 118 |
| | |
| PJESA VIII: PASTERTIA DHE NDERSHMERIA..... | 119 |
| 1. PASTERTIA..... | 120 |
| a. Pastërtia e brendshme..... | 120 |
| b. Pastërtia e trupit dhe e mjedisit..... | 121 |
| Lexim letrar: Kur shkoj në shkollë..... | 123 |
| 2. NDERSHMERIA..... | 126 |

| | |
|--------------------------------------------------|------------|
| a. Në mendim..... | 127 |
| Lexim letrar: Këshillat e gjyshit..... | 128 |
| b. Në fjalë..... | 129 |
| Lexim letrar: Ndershmëria çon në mirësi..... | 131 |
| c. Në sjellje, në tregti, në matje e peshim..... | 133 |
| Lexim letrar: Djali dhe hajdutët..... | 135 |
| 3. DHEMBSHURIA DHE MESHIRA..... | 137 |
| Lexim letrar: Vajza e qumështshitësit..... | 139 |
| 4. KREU “NAS” DHE KUPTIMI I TIJ..... | 141 |
| BURIMET..... | 142 |

PJESA I

I BESOJ ALLAHUT

ÇESHTJET

1. NEVOJA PER TE BESUAR DHE BESIMI TE ALLAHU
 - a. Allahu ekziston
 - b. Atributet e Allahut
2. DASHURIA PER ALLAHUN
3. "AMENTU" DHE KUPTIMI I SAJ

PUNE PERGATITORE

1. Merrni të dhëna nga më të mëdhenjtë mbi çështjen e ekzistencës së Zotit.
2. Kujtoni Fjalën e Dëshmisë dhe kuptimin e saj.
3. Shpjegoni kuptimin e shprehjes "Dashuria më e madhe është dashuria për Allahun!"

1. NEVOJA PER TE BESUAR DHE BESIMI TE ALLAHU

Njeriu është një qenie e përbërë prej shpirtit dhe trupit. Ashtu siç ka nevojë trupi për ushqime si ato që hahen e pihen, edhe shpirti ka nevojë për disa ushqime të përshtatshme për të. Ushqimi më i rëndësishëm për shpirtin tonë është besimi i shëndoshë.

Njeriu gjithmonë ndien nevojë për t'i besuar një qenieje të lartë më të fuqishme se veten. Kjo shfaqet sheshit më shumë në çastet kur njeriu ndodhet në gjendje të pashpresë. Atëherë ai ndien nevojën për t'u mbështetur te ajo qenie e lartë dhe pret ndihmë prej saj. Qenia e lartë që njeriu ndien nevojë për ta besuar, që e adhuron dhe prej të cilës pret ndihmë, është Allahu.

Njeriu është krijuar në atë mënyrë që të mundet ta kuptojë se Allahu ekziston dhe është një. Në saje të arsyes së dhënë në krijim, njeriu e ka pranuar ekzistencën e Allahut dhe e ka besuar atë.

a. Allahu ekziston

Njeriu, duke vështruar gjithësinë dhe të gjitha qeniet e gjalla e jo të gjalla që ndodhen në gjithësi, e kupton se Allahu ekziston dhe se është një.

Njeriu mund ta kuptojë ekzistencën e Allahut edhe duke bërë një sërë shqyrtime edhe në botën e tij të brendshme, edhe në botën jashtë tij. Për shembull, duke vështruar rregullsinë në organet e veta, përsosmërinë e funksionimit të tyre, njeriu e kupton se kjo përsosmëri nuk mund të arrihet me fuqinë e qenieve të krijuara. Veçanërisht, duke vështruar rregullsinë në natyrë, njeriu e kupton se malet dhe detet, stinët, ditët dhe netët, dielli dhe hëna nuk mund të lëvizin në mënyrë të harmonishme vetvetiu. Njeriu i arsyeshëm e kupton se prania e ujit në përbërjen e gjallesave, se vënia në lëvizje e reve nga era dhe se e gjithë kjo rregullsi si, bie fjala, ringjallja e tokës së vdekur pas rënies së shiut nuk mund të ekzistojnë, të kryhen vetvetiu dhe, si përfundim i kësaj, arrin në pranimin e ekzistencës dhe njësisë së Allahut!

Në Kur'an, Allahu, ekzistencën dhe njësinë e vetes ua parashtron kështu atyre që kanë arsye:

“Thua: “Allahu është një. Ai nuk ua ka nevojën të tjerëve, por të tjerët ia kanë nevojën Atij. As ka lindur e as është lindur. Dhe asgjë s’është e njëjtë me të!”¹ (Kur’ani, Ihlas: 1-4)

Me që Zoti e di se robtë, krijesat e Tij do të mendojnë se mund të ketë më shumë se një krijues, na e tërheq vëmendjen në këtë çështje dhe na sqaron kështu:

“Po qe se në tokë e në qiell do të kishte zota të tjerë veç Allahut, toka e qielli do të shkatërroheshin...” (Kur’ani, Enbija: 22)

Edhe ne e besojmë ekzistencën e Allahut ashtu siç është bërë e ditur në Kur’an, i zbatojmë urdhrat e Tij dhe ruhem prej gjërave të ndaluara prej Tij!

b. Atributet e Allahut

Për ta njohur edhe më mirë Atë, Zoti ynë i madh bën fjalë në Kur’an për atributet e veta. Për t'i besuar Allahut ashtu siç duhet, duhet t'i njohim edhe atributet e Tij.

Me që nuk mundemi ta njohim dhe ta mendojmë individualitetin dhe cilësinë e Allahut, e njohim atë me anë të emrave dhe attributeve dhe ashtu e besojmë. Lidhur me këtë çështje, në Kur’an urdhërohet:

¹ Interpretimet e fragmenteve të cituara nga Kur’ani janë të komisionit hartues. (Shën. i përkthyesit)

“Sytë nuk mund ta shohin Atë, por Ai i sheh sytë. Ai i njeh mirë sendet dhe ka dijeni për gjithçka!” (Kur’ani, En’am: 103)

Edhe Profeti ynë ka folur për këtë. Ai ka thënë: *“Mendoni për krijesat e Allahut, por mos mendoni për personin e Allahut. Pa dyshim, ju s’keni aspak fuqi për këtë!”* (Buhariu)

Atributet e Allahut mund t’i shqyrtojmë në dy grupe:

I. Atributet individuale (dhatí)

II. Atributet qenësore (thubutí)

I. Atributet individuale

Këto janë attribute të posaçme vetëm për individualitetin e Zotit dhe nuk ndodhen te asnjë qenie e krijuar. Atributet individuale të Zotit janë gjashtë:

a. Ekzistencë (vuxhud). Zoti ekziston, është i gjallë. Lidhur me këtë, në Kur’an thuhet: **“... Ai është i gjallë ...”**²

b. Paraqenie (kidem). Zoti është i paraqenë, ekzistenca e Tij nuk ka fillim. Për ekzistencën e Zotit nuk mund të mendohet një fillim. Sado të kthehemi pas në kohë, nuk mund të mendohet një pikë kohore kur Zoti të mos ketë ekzistuar. Në Kur’an kjo e vërtetë përcaktohet kështu: **“Ai është i parë** (ekziston para çdo gjëje tjetër)...”

c. Pasqenie (beká). Zoti është, gjithashtu, i pasqenë, i përhershëm. Ekzistenca e Tij nuk ka fund. Ashtu si ekzistenca e Tij nuk ka fillim, nuk ka as fund.

Në Kur’an thuhet: **“Çdo gjë që ndodhet mbi tokë, është e përkohshme, kalimtare, e asgjësueshme. Vetëm ekzistenca e Zotit tënd të lartë e bujar është e përhershme!”** (Kur’ani, Rahman: 26 -27)

ç. Njësi (vahdaniyet). Zoti është një i vetëm. Nuk ka krijues tjetër veç Zotit. Po të kishte, kjo rregullsi madhështore që shohim në gjithësi, nuk do të ishte. Do të shfaqej papërputhshmëria e gjërave dhe parregullsia. Të vërtetën se Zoti është një i vetëm e mësojmë nga libri ynë, Kur’ani, dhe e kuptojmë nga rregullsia në gjithësi. Kështu, në Kur’an urdhërohet: **“Thuaj: “Allahu është një. Ai nuk ka nevojë për asgjë. As ka lindur, as është lindur. Asgjë nuk është e njëvlershme me Të!”** (Kur’ani, Ihlas: 1-4)

d. Kundërqenie ndaj krijesave (muhafeftun li’l-havadith). Qenia e Zotit, në tërësinë e vet, është krejt e kundërta e qenieve të paskrijuara, domethënë të krijuara në një pikë kohore të caktuar e që kanë për t’u asgjësuar në një pikë kohore të caktuar. Zoti është i ndryshëm prej qenieve të krijuara.

Në Kur’an thuhet: **“Nuk ka gjë që t’i përngjasë Atij. Ai dëgjon dhe sheh!”** (Kur’ani, Shúrá: 11)

e. Qenie në vetvete (kijam binefsihi). Qenia, ekzistenca e Zotit është nga vetvetja dhe në vetvete. Prandaj është i përplotësuar, kështu që nuk ia ka nevojën asnjë qenieje.

Në Kur’an thuhet: **“Allahu është i tillë që nuk ka krijues tjetër veç Tij, është i gjallë, mbikqyrës i përhershëm mbi krijesat e Tij dhe që nuk ka nevojë për asgjë!”** (Kur’ani, Al-i Imran: 2)

II. Atributet qenësore

Këto attribute që ndryshe quhen edhe pozitive, ndodhen në mënyrë të kufizuar edhe te krijesat. Ato ndodhen edhe te njeriu. Megjithatë, ato nuk mund të përqasen me të njëjtat attribute të Zotit, sepse

² Në Kur’an është fjala “hajj”, “i gjallë”, “me jetë”.

atributet e Zotit janë të pakufizuara, kurse të njeriut, të kufizuara. Atributet qenësore mund t'i përmbledhim kështu:

a. Jetë (hajjat). Zoti është i gjallë. Ky atribut ekziston pa fillim e pa fund te Zoti. Në Kur'an bëhet e ditur se Allahu është i gjallë: **"...që i beson dhe mbështetet te Allahu i pavdekshëm dhe gjithmonë i gjallë..."**.

b. Dituri (ilm). Zoti di gjithçka. Dituria e Zotit është e pakufishme dhe e pafundme. Me diturinë e Tij, Zoti njih gjendjen e të gjitha qenieve. Zoti njih të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen. Ai njih të fshehtën si dhe atë që është dhe duket sheshit.

Në Kur'an thuhet: **"...Ai di gjithçka që ndodhet në tokë e në det. Jashtë dijes së Tij asnjë gjeth nuk bie..."** (Kur'ani, En'am: 59)

c. Vullnet (irade). Zoti dëshiron dhe çdo gjë që dëshiron Ai, bëhet në çast. Ai thotë vetëm "Bëhu!" dhe bëhet. Gjithashtu, gjëja që

s'dëshiron Zoti, s'bëhet. Çdo gjë ndodh dhe përfshihet në vullnetin e Tij.

Në Kur'an thuhet: **"Kur Ne dëshirojmë diçka, vetëm themi "Bëhu!" dhe ajo menjëherë bëhet!"** (Kur'ani, Nahl: 40)

ç. Fuqi (kudret). Zoti ka fuqi për çdo gjë. Ai është i fuqishëm. Ai s'ka nevojë për mbështetjen e dikujt apo diçkaje tjetër.

Zoti ka fuqi të pafundme. Në Kur'an thuhet: **"... Pa dyshim, Allahu ka mundësi për të bërë çdo gjë, ka fuqi për çdo gjë!"** (Kur'ani, Bakara: 20)

d. Dëgjim (semí). Zoti dëgjon. Fuqia e Zotit për të dëgjuar është e pakufizuar. Ai dëgjon dhe kupton për çdo çast dhe në tërë gjithësinë se ç'thonë krijesat e Tij. Për të dëgjuar, Zoti s'ka nevojë për ndonjë organ.

Në Kur'an thuhet: **"... Dijen se Allahu dëgjon dhe di!"** (Kur'ani, Bakara: 244)

e. Shikim (basar). Zoti sheh. Edhe shikimi i Zotit është i pakufizuar. Ai sheh atë që është larg, afër, i fshehur e i dukshëm.

Në Kur'an thuhet: **"... Allahu sheh saktë ato që bëni!"** (Kur'ani, Enfal: 72)

f. Fjalë (kelam). Zoti flet. Për të folur, Zoti s'ka nevojë për mjete të tilla si gjuha, tingulli, zëri, etj.

Allahu i Lartë, me disa prej profetëve ka folur. Ai ka folur me profetin Muhammed (a.s.) natën e miraxhit, me profetin Musa (Moisi), në malin Sina. Lidhur me këtë, në Kur'an thuhet: **"... Allahu vërtet foli me Musanë!"** (Kur'ani, Nisa: 164)

g. Krijim (tekvin). Zoti krijon. Ai krijon diçka nga hiçi. Me dijen dhe fuqinë e tij të pafundme Zoti ka krijuar gjithësinë dhe të gjitha qeniet që ndodhen në gjithësi. Për të krijuar, Atij s'i nevojitet asgjë. Akte të tilla si krijimi, plotësimi i nevojave të krijesave,

vdekja, ngjallja (ringjallja), falja, dhënia e dhuntive kryhen si rrjedhojë e domosdoshme e atributit “krijim” të Zotit.

Lidhur me këtë atribut, në Kur’an thuhet: **“Allahu i krijon krijesat së pari, pastaj, pas vdekjes, i ringjall. Më në fund, te Ai do të ktheheni!”** (Kur’ani, Rum: 11)

2. DASHURIA PER ALLAHUN

Eshtë e pamundur të numërohen dhuntitë që Allahu i Lartë na ka dhënë. Ai ka krijuar për ne botën ku jetojmë, qiellin, tokën. Na ka dhënë ajrin, që të mund të jetojmë, ujin, që të përfitojmë prej të mirave të tij. Si përgjigje ndaj këtyre dhuntive, Allahu i Lartë kërkon prej nesh vetëm ta duam, ta besojmë dhe ta adhurojmë.

Dashuria për Allahun është rrjedhojë e domosdoshme e besimit te Ai. Njeriu që e beson Allahun, duhet ta dojë Krijuesin e Lartë që i ka dhënë dhunti të pafundme.

Profeti (a.s.) është lutur: *“Allahu im! Mundësoma të të dua Ty, atë që të do Ty si dhe atë gjë që do të më afronte te Ti dhe dashurinë për Ty bëma më të pëlqyeshme se dëshirën për ujë të ftohtë në vapën e verës!”*

Dashurinë për Allahun mund ta tregojmë duke e adhuruar Atë, duke çuar në vend urdhrat e Tij dhe duke u ruajtur prej gjërave që na i ka ndaluar. Duhet të shkojmë sipas urdhrave të Tij jo vetëm për të hyrë në xhennet, por, në radhë të parë, për të fituar dashurinë e Tij! Po ashtu, duhet të ruhem prej gjërave të ndaluara jo nga frika e xhehennemit, por, në radhë të parë, për t’u bërë të denjë për dashurinë dhe për të fituar pëlqimin e tij!

Lexim letrar

Allahu ekziston

Mustafai ka një histori të çuditshme për pranimin e ekzistencës së Zotit. Po jua tregoj.

Një ditë, Mustafai, pas një debati me shokët mbi ekzistencën e Zotit, u kthye në shtëpi tërë nerva e i shqetësuar. Rrinte e rrinte e thoshte:

“Po të kishte Zot, edhe ne do ta shihnim!”

Të atit nuk i pëlqeu kjo. Megjithatë, u mjaftua t'i thoshte të birit vetëm kaq:

- Po qe se e vret pak mendjen, mund ta gjesh vetë në se ekziston Zoti apo jo. Çdo gjë tregon se Zoti ekziston!

I ati donte t'ia mësonte në një mënyrë të veçantë të birit ekzistencën e Zotit. Ndërsa Mustafai po flinte, ia mori fletoren e gjuhës shqipe dhe i zhgarraviti disa faqe.

Kur Mustafai e hapi fletoren, u nxeh dhe i bërtiti s'ëmës:

- Kush ma ka zhgarravitur fletoren kështu?

- S'e di, o bir! - lu përgjigj e ëma. Kurse i ati i tha:

- Siç duket, e ka bërë vetë lapsi!

I mërzhitur nga thënia pa vend e të atit, Mustafai foli me vete si me ironi:

- Punë që bëhet, besa!

Një ditë tjetër, Mustafai nuk po e gjente dot njërën këpucë. E kërkoi dhe e kërkoi gjithandej dhe ku e gjeti, do të pyesni: mu në një skaj të kuzhinës! Dhe foli gjithë zemërim:

- More, po ç'kërkon këtu kjo këpucë? Kush e ka sjellë këtu?

I ati, krejt i qetë, i tha:

- Vetë ka shkuar!

- Baba! Punë që bëhet është kjo? A mos ka këpuca këmbë? Më duket se ke qejf të zbavitësh!

Në ditët që pasuan, Mustafai vazhdoi t'i gjente pizhamet në dhomën e pritjes, stilolapsin brenda në këpucë e kështu me radhë... Më në fund, nuk duroi dhe, me një zë në të qarë, tha:

- Kush i bën këto? Kush po tallet me mua?

Me një ton qetësues, i ati i foli:

- Shiko, o bir! Kur unë të them se këto sende lëvizin dhe veprojnë vetë, më kundërshton me plot të drejtë. Duke menduar se është dikush që i bën këto, kërkon ta dish se kush është ai. Ke plotësisht të drejtë! Ashtu është!

Mirë, po, ndërsa e pranon se këto veprime të lehta e të thjeshta nuk mund të bëhen vetvetiu, pse nuk të shkon mendja se trupi yt, pemët, kafshët, dielli e hëna, madje edhe një gjethe e vogël nuk mund të bëhen vetvetiu?

Po qe se për çdo gjë e për çdo veprim duhet të jetë dikush që i bën, edhe për këto duhet të jetë dikush që i ka bërë e i bën. Një rregull i tillë i patëmetë, a mund të krijohet e organizohet vetvetiu? Ja, pra, është Allahu që e ka krijuar këtë rregull e harmoni dhe që i jep vazhdimësi asaj.

Atëherë, i bindur, Mustafai i tha:

- Ke të drejtë, baba!

Duke e pranuar gabimin, Mustafai njëkohësisht e falenderoi të atin që e drejtoi për të menduar mbi Zotin!

Lexim letrar

Ç'kërkon Allahu prej nesh?

Ahmeti po e ndihmonte të atin që po kosiste barërat në kopësht. I ati iu lut:

- A po më sjell një gotë ujë, o bir?

Ndërsa babai po pinte ujë, nisi të këndohej ezani.

- Të falemnderit, o bir, - i tha i ati. - Ti e bëre atë që t'u kërkua. Tani Allahu po kërkon prej nesh diçka!

- Mos vallë Allahu po kërkon prej nesh diçka? - Pyeti me sytë plot çudi Ahmeti.

- Po, o bir!

- Po unë s'po dëgjoj gjë!

- Pse, a s'po e dëgjon ezanin?

- Po; mirë po...

- Allahu na i bën të ditura me mënyra të ndryshme ato që kërkon prej nesh! - Tha i ati. - Për shembull, zëri i ezanit ua kujton muslimanëve urdhrin e Zotit, **“Falni namaz!”** Në çdo kohë namazi na duket sikur dëgjojmë këtë urdhër!

Kur vjen Ramazani dhe nisin të gjëmojnë topat e të bien daullet e tij, të ndizen dritat në minaretë, kujtojmë urdhrin e Zotit, **“Agjëroni!”**

Po qe se këndon Kur'an, i mëson se ç'kërkon Allahu prej teje!

Allahu ka urdhëruar:

“Silluni mirë me nënën, babanë, të afërmit, bonjakët, të varfërit, fqinjët e afërt e të largët, shokun dhe mikun e afërt!” (Kur'ani, Nisa: 36)

“O besimtarë!

Bëni ruku, bëni sexhde!

Adhurojeni Zotin tuaj!

Bëni të mira që me të vërtetë të jeni të lumtur!”

(Kur'ani, Haxh: 77)

- **Baba, ç'kërkon Allahu prej nesh?**

- Ja disa prej tyre: të falim namaz, të agjërojmë, t'ua dëgjojmë fjalën prindërve, t'u bëjmë të mira të varfërve, të sillemi mirë me të gjithë!

- **Si mund t'i mësojmë gjërat që kërkon Allahu prej nesh?**

- Po ta lexojmë Kur'anin e mësojmë çdo gjë që kërkon Allahu prej nesh!

“AMENTU” DHE KUPTIMI I SAJ

أمنت بالله وملكته وكتبه ورسله و اليوم الآخر و بالقدر خيره وشره من
الله تعالى اشهد ان لا اله الا الله واشهد ان محمدا عبده ورسوله .

Kuptimi: “Besova Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij, profetët, të dërguarit e Tij, Ditës së Ringjalljes dhe kaderit; besova se e mira dhe e keqja vijnë prej Allahut dhe se ringjallja pas vdekjes është e vërtetë! Dëshmoj se s'ka zot tjetër veç Allahut dhe dëshmoj se Muhammedi është robi dhe i dërguari i Tij!”

PERMBLEDHJE

1. Pse njerëzit ndiejnë nevojën për të besuar?
2. Si mund ta dimë ekzistencën e Allahut?
3. Në sa grupe ndahen atributet e Allahut?
4. Numëroni dhe shpjegoni shkurt atributet individuale të Allahut.
5. Numëroni dhe shpjegoni shkurt atributet qenësore të Allahut.
6. Si duhet të jetë dashuria jonë për Allahun?

PJESA II
U BESOJ ENGJEJVE

ÇESHTJET

1. VEÇORITE E ENGJEJVE
2. ENGJEJT QE PERMENDEN NE KUR'AN DHE VEÇORITE E TYRE
3. TE JEMI TE MATUR KUDO E KURDO
 - a. Në sjellje
 - b. Në fjalë
 - c. Në marrëdhëniet me të tjerët
4. KREU “KUREJSH” DHE KUPTIMI I TIJ

PUNE PERGATITORE

1. Ç'qenie janë engjëjt? Mësojeni duke pyetur më të mëdhenjtë.
2. Ç'përfitime na sjell besimi në engjëjt?
3. Pse duhet t'u kushtojmë kujdes fjalëve e sjelljeve tona kudo e kurdoherë?

1. VEÇORITE E ENGJËJVE

Njëri prej parimeve besimore është edhe besimi te engjëjt.³ Në Kur'an ka ajete që tregojnë se besimi te engjëjt është detyrim, farz. Allahu i Lartë urdhëron në Kur'an: **“Edhe i Dërguari i besoi asaj që iu zbrit nga Zoti, edhe besimtarët; secili prej tyre u besoi Allahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dërguarve të Tij...”** (Kur'ani, Bakara: 285)

Engjëjt janë qenie dritësore dhe shpirtërore që nuk mund të përceptohen e të njihen me anë të organeve të shqisave. Për rrjedhojë, njohuri të drejta mbi engjëjt mund të marrim prej Kur'anit dhe haditheve, porosive profetike.

Në një hadith, Profeti ynë (a.s.) ka porositur:

“Engjëjt janë krijuar prej drite, xhindët, prej flake, kurse Ademi, prej dheu...” (Sahih-i Müslim)

Engjëjt kanë një sërë veçorish të posaçme që i dallojnë ata prej qenieve të tjera.

1. Engjëjt janë qenie të krijuara prej drite. Te engjëjt nuk ka veçori njerëzore, të tilla si ngrënia e pirja, seksi, martesë, fjetja, lodhja, rinia dhe pleqëria.

Kur'ani urdhëron kështu:

“... Ata që ndodhen pranë Tij (engjëjt), as druhen për t'i bërë adhurim, as lodhen. Natë e ditë e përmendin Allahun, nuk mërzhiten!” (Kur'ani, Enbija: 19 -20)

2. Engjëjt nuk e kundërshtojnë Allahun, nuk ngrenë krye kundër Tij. Ata nuk shmangen prej urdhrit të Tij dhe kryejnë detyrën që u jepet.

Në Kur'an thuhet:

“Duke u frikësuar prej Zotit të tyre, Sundues i Plotfuqishëm, (engjëjt) bëjnë çfarëdo që t'u urdhërohet!” (Kur'ani, Nahl: 50)

3. Engjëjt janë qenie tejet të shpejta. Mund të shkojnë në çdo vend që t'u kërkohet dhe me shpejtësinë që të duan.

Në Kur'an thuhet:

“Lavdi Allahut që ka krijuar qiejt dhe tokën e që i ka bërë engjëjt korrierë me nga dy, me nga tre e me nga katër krahë...” (Kur'ani, Fatir: 1)

4. Me urdhrin dhe lejën e Allahut, engjëjt mund të marrin trajta të ndryshme. Në Kur'an thuhet:

“Pa dyshim, të dërguarit (engjëjt) tanë i shkuan Ibrahimit me myzhde dhe i thanë, “selam!” Edhe ai i përshëndeti me “selam” dhe, pa humbur kohë, u nxori një viç të pjekur. Pastaj nuk i pëlqeu që nuk zgjatën duart te mishi dhe

³ Në arabisht është fjala “melek”, e cila në trajtën “meleke” do të thotë “aftësi”. (Shën. i përkthyesit)

ndjeu frikë. Dhe ata i thanë: “Mos u frikëso, ne jemi dërguar te fisi i Lutit!”
(Kur’ani, 69 - 70)

5. Engjëjt nuk shihen me sy.

6. Engjëjt nuk e dinë të ardhmen.

Në Kur’an urdhërohet: **“Thuaj: “Në qiej e tokë, askush veç Allahut nuk mund ta dijë të fshehtën...”** (Kur’ani, Neml: 65)

Lexim letrar

Vajza si një engjëll

Zejnepi ishte një vajzë rreth të dymbëdhjetave, e zgjuar dhe punëtore. Ajo e donte shumë mësuesin. Të gjitha mësimet që shpjegonte ai, i dëgjonte me vëmendje.

Zejnepi merrej vesh shumë mirë me shokët e shkollës dhe ata të mëhallës. Ishte vajzë e edukuar. Askënd nuk ngacmonte, akujt s’ia thyente zemrën. Ndiante kënaqësi t’u ndihmonte të gjithëve. Nisur nga këto veçori, gratë e komshinjve thoshin gjithmonë për të, “vajzë si një engjëll!” Dhe Zejnepi që i kish shumë qejf këto fjalë, pandehte se gratë ia përngjasonin teze Meleqes. Edhe ajo ishte shumë e edukuar; ishte një zonjë që sillej me shumë respekt me këdo.

Kur mësuesi foli në mësimin e fesë për engjëjt, Zejnepi edhe u kënaq, edhe u turpërua pak. Ndjeu se ish skuqur në fytyrë. Në vetvete mendoi:

“O Zot, s’e kam marrë vesh ende pse më thonë mua “vajzë si engjëll”!

Pas shpjegimit të mësuesit, Zejnepi mendoi se nuk e përngjasonin me tezen Meleqe, por me engjëjt që ishin qenie të padukshme. Dhe kjo i pëlqeu më shumë. Dhe vendosi që atë ditë e tutje t’u kushtonte më tepër kujdes qëndrimit dhe sjelljeve të saj.

2. ENGJEJT QE PERMENDEN NE KUR'AN DHE VEÇORITE E TYRE

Allahu i Lartë ka engjëj të panumërt. Në Kur'an nuk përmenden emrat e të gjithë engjëjve, por emrat dhe detyrat e disave prej tyre.

a. Engjëjt e mëdhenj

1. Xhebraili. Njihet edhe si “Engjëlli i zbulësës”. Është engjëlli që u çon profetëve urdhrat dhe ndalimet e marra prej Allahut.

2. Mikaili. Është engjëlli që organizon dukuritë që ndodhin në natyrë: rënien e reshjeve, fryrjen e erës, krijimin e stinëve dhe furnizimin e njerëzve.

3. Israfili. Është engjëlli i cili, ditën e kiametit, do t'i fryjë bririt të quajtur “sur”⁴ duke lajmëruar se ka marrë fund jeta e kësaj bote dhe ka filluar jeta tjetër.

4. Azraili. Quhet edhe “Engjëlli i vdekjes”. Ndan nga trupi shpirtrat e njerëzve që u ka ardhur vdekja.

b. Engjëjt e tjerë që përmenden në Kur'an

1. Engjëjt shkruar (kiramen katibin). Janë dy engjëj që ndodhen gjithmonë pranë njeriut. Njëri shkruan punët e mira që bëjmë, tjetri, të këqiat.

Gjithashtu, këta engjëj, në ditën e kiametit, gjatë llogaridhënies, do të dëshmojnë për punët e bëra nga njerëzit në këtë botë.

2. Engjëjt hetues (Mynker dhe Nekir). Këta marrin në pyetje çdo njeri pasi futet në varr, për besimin dhe punët e bëra në këtë botë.

3. Engjëjt mbrojtës. Me lejë të Allahut, e ruajnë njeriun nga aksidentet dhe ngatërresat.

⁴ Sur (arab.): bori prej briiri.

Lexim letrar

Zëri i engjëllit

Halili ishte një fëmijë që i pëlqente shumë të mendonte, i zgjuar dhe i kujdesshëm. Kërkonte të gjente shkaqet e një ngjarjeje ose të një ideje që i kishte shkuar nëpër mend dhe shpesh arrinte në përfundime të bukura e të dobishme.

Një ditë i tha të atit:

- Disa herë, kur shoh se nëna punon e lodhet për ne, hidhërohem shumë. Dhe atëherë më vjen të ngrihem e ta ndihmoj. Dhe ashtu bëj. Kurse disa herë të tjera, megjithëse e di se ajo ka shumë nevojë për mua, më tërheq loja dhe dal jashtë e luaj. Nuk e di, megjithëse e dua nënën, pse sillem kështu, baba?

I ati ishte mësuar me këto lloj pyetjesh të Halilit. E donte të birin se bisedonte hapur me të, pa i fshehur ndjenjat.

- Kjo gjë nuk ndodh vetëm me ty, o bir, - i tha i ati.

- Me të vërtetë, o baba? Ç'është e drejta, u gëzova shumë. E fajësoja veten duke kujtuar se vetëm unë isha i tillë. Megjithatë, kërkoj ta di se cili është shkak i kësaj. A nuk janë këto mendime të kundërta me njëra-tjetrën?

- Sigurisht. **Njeriu mendon kështu, në mënyra të ndryshme e të kundërta në se ndodhet vazhdimisht nën ndikimin e dy qenieve të kundërta që nuk i sheh dot me sy.** Njëra nga këto dy qenie është engjëlli, tjetra, shejtani, djalli.

- Ç'na bën engjëlli neve, o baba?

- Engjëlli na e kujton të mirën. Na duket sikur dikush na thotë: **"Bëhu i mirë!"** Ose: **"Bëje këtë të mirë!"** Ai nuk do që ne të bëjmë gjë të keqe. Po të ndodhë që të bëjmë një veprim të keq, engjëlli hidhërohet.

- Po djalli, o baba?

- Kurse djalli na i kujton gjithmonë gjërat e këqia. Do që ne të thyejmë diçka, t'i ngacmojmë dhe shqetësojmë të tjerët. Ai dëshiron t'u dalim kundër urdhrave të Zotit. Ai gëzohet e lumturohet kur ne i kundërshtojmë të mëdhenjtë, kur nuk ua dëgjojmë fjalën prindërve!

- Mirë, po kur unë dua të bëj ndonjë të mirë ose të keqe, nuk dëgjoj ndonjë zë të tillë që të më thotë, **"Bëje këtë!"** ose, **"Mos e bëj këtë!"**

- Zëri i engjëllit e i djallit nuk i ngjet zërit tonë, o bir! Ata veprojnë drejtpërsëdrejti mbi mendimin tonë. Le të mendojmë mbi shembullin që dhe ti!

Ti mendon kështu: “Nëna lodhet shumë. Nuk ka as ndonjë ndihmës që të pushojë pak. E shpenzon veten për ne. Ta ndihmoj pak!” Në këtë rast, dije se ky mendim është **zëri i engjëllit**.

Por ti mund të mendosh edhe kështu: “E ç’më duhet mua se po lodhet nëna? Tani s’kam mundësi të ndihmoj askënd!” Në këtë rast, duhet ta dish se djalli kërkon të të mashtrojë!

Disa herë djalli vepron më rëndë dhe të shtrëngon ty të sillesh në një mënyrë që, në të vërtetë, s’të pëlqen aspak.

Dhe ti mendon: “Në se përpiqet, përpiqet për shtëpinë! Fundja, secili bën detyrën e vet! E ç’të bëj unë në se ajo lodhet?”

Ja, pra, pikërisht atë çast duhet të vimë menjëherë në vete dhe të mos biem në kurthin e djallit!

Që të mundesh ta dallosh se cili është zëri i engjëllit e cili i djallit, po të jap edhe një shenjë tjetër.

Po që se ndiejmë dëshirë për të bërë gjëra që kërkojnë prej nesh Allahu dhe Profeti, dije se kjo dëshirë na lind në shpirt nën ndikimin e engjëllit. Por në se ndiejmë një dëshirë në anë të kundërt, kjo na lind nën nxitjen e djallit sepse djalli kërkon të na largojë nga feja, domethënë nga gjërat e mira e të bukura!

- Pse nuk i shohim engjëllin dhe djallin, o baba? Të lutem, m’i përshkruaj ata, o baba!

- Ne s’i shohim dot ata se ndërtimi i tyre është i ndryshëm prej tonit. Por për këto do të të flas tjetër herë. Tani më duhet të shkoj, o bir!

Halili e falenderoi të atin. Ai nisi të mendonte për engjëllin dhe djallin: “Ç’gjëra duhet të ishin, vallë, këto qenie që bënë t’u shkante fjala kaq shumë tek ne?”

Lexim letrar

Engjëjt e mëshirës dhe engjëjt e ndëshkimit

Një ndodhi e treguar nga Profeti ynë, pandeh se do t'ju pëlqejë më shumë se ndodhia që kam për t'ju treguar unë! Temën e sotme le ta fillojmë me një ndodhi të dalë prej gojës së Profetit, që e ka fjalën më të ëmbël se mjalti!

Një herë e një kohë, një njeri kishte vrarë nëntëdhjetë e nëntë vetë. Pastaj kish ardhur koha dhe njeriu ishte penduar. Kishte dashur ta linte rrugën e keqe e të bëhej njeri i mirë. Dhe kishte nisur të mendonte: “A ka, vallë, për mua ndonjë rrugë shpëtimi?” Pastaj kishte nisur të pyeste këdo që takonte:

- A mos e dini se kush është dijetari më i madh i botës?

Pyeste kështu duke menduar se dijetari më i madh i botës me siguri do t'i gjente një zgjidhje e do ta shpëtonte nga ajo rrugë e keqe!

Disa njerëz e kishin këshilluar të takohej me një murg:

- Ai murgu është dijetari më i madh i botës. Ai ka për të të shpëtuar!

Dhe ishte ngritur njeriu mëkatar e kishte shkuar te murgu.

- Imzot, kam vrarë nëntëdhjetë e nëntë vetë! - Kish nisur t'ia qante hallin murgut. - Tani jam penduar për ç'kam bërë. Dëshiroj që Zoti të më falë. A ka për të më falur mua Zoti, vallë, a ka për të ma pranuar pendimin?

Murgu kishte kqyrur me kujdes pamjen e njeriut, por s'kishte dalluar dot ndonjë shenjë se kishte shans për shpëtim. Kish tundur kokën me keqardhje e i kishte thënë:

- Mëkate shumë të mëdha ke bërë, o njeri! Zoti nuk mund të të falë. Ai s'ta pranon pendimin. Mos u lodh më kot!

Njeriu mëkatar ishte nxehur menjëherë. Kur kishte parë se s'i kishte mbetur shpresë shpëtimi, e kishte humbur mendjen.

- Nuk po më tregon ndonjë rrugëdalje, ë? - I ishte sulur murgut. - Megjithëse jam penduar, Zoti nuk ka për të më falur, ë? Mirë, pra, po të vras edhe ty që të bëhen plot njëqind!

Dhe e kishte vrarë edhe murgun!

Vrasësi i njëqind vetëve mendonte, megjithatë, se duhej të kishte patjetër një rrugë shpëtimi! Dhe ishte vënë sërish në udhë për të kërkuar dijetarin më të madh të botës!

Këtë radhë e kishin këshilluar të shkonte te një i ditur tjetër.

- Me siguri që ai ka për të të gjetur shpëtim! - I kishin thënë.

Njeriu kish shkuar me një të madhe shpresë te dijetari dhe ia kishte qarë hallin:

- Gjer tani kam vrarë njëqind vetë! Kam dëshirë që Zoti të më falë. A mundet imzot të më shohë në sy e të më falë?

Ky dijetari na kishte qëlluar vërtet njeri i madh! Dhe i kishte thënë vrasësit:

- Sigurisht që Zoti ka për të të falur! Mjafton që të pendohesh për ç'ke bërë! Mjafton të thuash: "O Zot! Të jap fjalën se kurrë s'kam për të bërë më një gjë të tillë!"

Dhe kishte vazhduar ta këshillonte:

- Një kusht tjetër për t'u bërë njeri i mirë, është të jetosh mes njerëzve të mirë. Atje ku jeton ti, është vend shumë i keq. Kurrësi mos u kthe më atje! Dhe tani ngreu dhe shko në aksh fshat. Atje ka shumë njerëz të mirë që adhurojnë Zotin. Edhe ti adhuroje Zotin bashkë me ta!

Këto fjalë kishin ndikuar shumë mirë mbi njeriun mëkatar. Ai kishte dalë në udhë për të shkuar në fshatin që e kishte këshilluar dijetari. Kur kishte arritur në gjysmë të rrugës, i ishte mbaruar jeta dhe kishte vdekur. Shpirtin e çdo njeriu të vdekur e marrin engjëjt. Shpirtin e njerëzve të mirë e marrin **engjëjt e mëshirës**, kurse shpirtin e njerëzve të këqinj e marrin **engjëjt e ndëshkimit**.

Sapo kish vdekur njeriu, kishin ardhur edhe engjëjt e mëshirës, edhe engjëjt e ndëshkimit. Engjëjt e mëshirës kishin thënë:

"Ky njeri u pendua me tërë qënien e tij. Prandaj shpirti i tij na takon ne, jo ju!"

Engjëjt e ndëshkimit i kishin kundërshtuar:

"Ky njeri nuk bëri asnjë të mirë në jetën e vet. Për më tepër, vrau njëqind vetë! Vrasësit janë njerëzit më të këqinj. Shpirtin e tij do ta marrim ne!"

Për të zgjidhur mosmarrëveshjen mes engjëjve që përpiqeshin ta kryenin detyrën pa asnjë të metë, Zoti kishte ngarkuar një engjëll tjetër. Ky kishte marrë pamje njeriu dhe kishte ecur drejt engjëjve, të cilët, kur e kishin vënë re, i kishin thënë njëri-tjetrit:

"Pa shihni, dikush po vjen! Le ta bëjmë atë gjykatës mes nesh! Si të vendosë ai, të veprojmë!"

Engjëlli – gjykatës, pasi i kishte dëgjuar të dy palët, u kishte thënë:

"Matni largësinë e vendit nga erdhi ky njeri, dhe largësinë e vendit ku ka për të shkuar. Po qe se ndodhet më afër me vendin nga erdhi, ta marrin engjëjt e ndëshkimit. Po qe se ndodhet më afër me vendin ku ka për të shkuar, ta marrin engjëjt e mëshirës!"

Edhe Zoti kishte dashur ta falte atë njeri që, megjithëse kishte aq shumë mëkate, ishte penduar dhe ishte lutur me gjithë zemër për falje. Dhe, pa u kuptuar, e kishte afruar njeriun te vendi ku kishte për të shkuar.

Engjëjt i kishin matur të dyja largësitë dhe kishin parë se njeriu ndodhej më afër vendit ku kishte për të shkuar. Engjëjt e mëshirës ishin gëzuar shumë! E kishin marrë shpirtin e njeriut dhe e kishin çuar.

Të dashur fëmijë!

Mësuam, kështu, se sa i duan engjëjt e mëshirës njerëzit e mirë, se ata nuk ndahen prej tyre dhe se si u ndihmojnë njerëzve të mirë në çaste të vështira! Në këtë rrëfim, Profeti ynë na mëson edhe një tjetër detyrë të tyre.

Sa të mirë që janë engjëjt e mëshirës, apo jo! Jo vetëm sa jemi në këtë jetë, por edhe pasi të vdesim, ata na dalin për zot e s'na lenë vetëm!

Atëherë, themi se, për njerëzit, vdekja nuk është ndonjë gjë për t'u trembur! E rëndësishme është të fitojmë dashurinë e engjëjve të mëshirës që e njohin shumë mirë jetën e pastajme që ne nuk e njohim aspak dhe të fluturojmë e të ikim bashkë me ta!

Lexim letrar

Edhe Allahu të do ty!

Engjëlli merr trajtën që dëshiron. Këtë ta shohim nën dritën e një hadithi profetik.

Një herë e një kohë, një njeri po shkonte mik te një i njohuri i tij në një fshat tjetër.

Me që Zoti e dinte qëllimin e mirë të njeriut, deshi ta gëzonte e t'i tregonte se kjo që po bënte, ishte një punë e mirë. Dhe për këtë ngarkoi me detyrë një engjëll.

Engjëlli mori trajtë njeriu, i doli udhëtarit para dhe e përshëndeti:

- Selamu alejkum! Paqe ty!

- Alejkum selam! Ia ktheu përshëndetjen udhëtari.

- Nga po shkon?

- Te aksh fshat kam një vëlla; po shkoj t'i bëj një vizitë!

- E ke vërtet vëlla?

- Jo. Eshtë një miku im, një njeri që e dua për hir të Allahut!

- Siç duket, ai të ka bërë ndonjë të mirë, prandaj e do dhe po shkon për ta falenderuar!

Udhëtari tundi kokën në shenjë mohimi:

- Jo, jo! Unë s'e dua atë për ndonjë interes, vetëm për hir të Zotit!

Atëherë engjëlli i tha kështu udhëtarit:

- Unë jam i dërguar tek ti nga ana e Allahut. Detyra ime është për të të thënë se, ashtu siç e do ti atë njeri për të fituar dashurinë dhe pëlqimin e Allahut, edhe Allahu të do ty! Për këtë, të uroj!

3. TE JEMI TE MATUR KUDO E KURDO!

a. Në sjellje

Profeti ynë i dashur na ka këshilluar të duam për të tjerët atë që duam edhe për vete dhe të mos u bëjmë të tjerëve atë që s'duam të tjerët të na bëjnë neve. Fjalët dhe sjelljet e tij duhet të jenë shembull për ne! Duhet të na kujtojnë se është e nevojshme që gjithmonë t'u kushtojmë kujdes sjelljeve tona. Sepse Allahu i Lartë e di se ç'bëjmë ne, e dëgjon ç'themi ne. Engjëjt që ka ngarkuar me detyrë, mbajnë shënim çdo punë të mirë apo të keqe që bëjmë. Me këtë mendim duhet t'u kushtojmë kujdes fjalëve e sjelljeve tona. Nuk duhet të harrojmë se Allahu na sheh e na vëzhgon. Duhet ta dimë se Ai mbetet i kënaqur nga sjelljet tona të bukura. Prandaj, lidhur me këtë çështje, duhet t'u kushtojmë vëmendje këtyre gjërave:

Në shtëpi duhet të sillemi me respekt ndaj nënës, babait dhe të mëdhenjve të tjerë. Me motrat dhe vëllezërit duhet të shkojmë mirë. Në marrëdhëniet dhe shakatë me ta duhet të jemi të matur.

Në shkollë duhet të ruhem nga sjelljet ngacmuese e shqetësuese për mësuesit. Marrëdhëniet me shokët duhet t'i ndërtojmë shumë mirë. Po qe se sjellja e një shoku na shqetëson, nuk duhet t'i përgjigjemi me të njëjtën sjellje e nuk duhet të sillemi edhe vetë po në të njëjtën mënyrë ndaj të tjerëve. Shokun që na shqetëson me sjelljen e tij jo të mirë, duhet ta paralajmërojmë në mënyrë të hijshme. Në se na ndodh që të sillemi gabim, duhet të kërkojmë falje menjëherë.

Gjithashtu duhet t'u kushtojmë kujdes të gjitha sjelljeve tona në marrëdhëniet me mjedisin tonë: me njerëzit, farefisn, fqinjët.

b. Në fjalë

Profeti ynë i dashur ka thënë: *"Ai që u beson Allahut dhe Ditës së Ringjalljes, ose të thotë fjalë të mira e të dobishme, ose të heshtë!"* (Buhari) Ja, pra, e tillë është përcaktuar nga Profeti ynë njësia e masës, kriteri që duhet të përdorim në fjalë e në biseda. Atëherë, pra, kur flasim, duhet të jemi gjithmonë të matur në fjalë. Në bisedat me pjesëtarët e familjes, me mësuesit dhe me shokët, duhet të kemi kujdes në këto gjëra:

1. Gjithmonë duhet të themi fjalë të mira, të drejta e të bukura.
2. Duhet të ruhem nga biseda për gjëra të pavërteta.
3. Duhet të jemi me brishtësi dhe hijeshi. Nuk duhet të përdorim fjalë të ashpra e ngacmuese për bashkëbiseduesit.
4. Që të mos themi gjëra të gabuara, duhet të mos flasim pa u menduar mirë.
5. Neve s'na vjen mirë të na përgojnë pas shpine. Atëherë as ne s'duhet t'i përgojmë të tjerët.

6. Askujt s'ia ka qejfi që të tjerët të tallen me të. Atëherë, edhe ne s'duhet të tallemi me të tjerët.

7. Duhet të ruhem nga fjalët poshtëruese për të tjerët.

8. Kur flasim, duhet ta ngremë zërin sa të na dëgjojnë bashkëbiseduesit. Nuk duhet të shqetësojmë askënd duke thirrur e bërtitur.

9. Pëshpëritja mes dy vetëve në një mjedis ku ndodhen shumë vetë, nuk shihet me sy të mirë. Bisedat personale ose private duhet t'i bëjmë pasi të marrim leje nga shokët ose duhet t'i lemë për më pas.

10. Nuk na pëlqen të na e presin fjalën kur flasim. Atëherë, edhe ne s'duhet t'ua presim fjalën të tjerëve kur flasim.

ç. Në marrëdhëniet me të tjerët

Sipas kriterit të përcaktuar nga Profeti ynë, muslimani, me gjuhën dhe dorën e tij nuk i bën dëm askujt. Ai krijon marrëdhënie të mira me të tjerët. Kalon mirë me ta dhe të tjerët kalojnë mirë me të.

Përshëndetja dhe pyetjet e dyanshme për punët dhe shëndetin, mes njerëzve, është njëra prej rrugëve për të krijuar marrëdhënie të mira. Profeti ynë ka bërë të ditur se përshëndetja islame, selami, urimi për paqe, e forcon dhe e zhvillon besimin. Njerëzit nuk mund ta çojnë jetën të vetmuar. Ata janë të detyruar të jetojnë së bashku. U ndihmojnë të tjerëve dhe përfitojnë nga ndihma e të tjerëve. Sipas fesë sonë, njeriu më i dobishëm, është njeriu nga i cili shohin dobi të tjerët. Prandaj, marrëdhëniet duhet t'i vendosim mbi bazën e dobisë. Duhet të ruhem nga përfitimi i padrejtë. Nuk duhet të harrojmë se kjo lloj sjelljeje do të na përftojë kënaqësinë e Allahut ndaj nesh. Për këtë arsye, në marrëdhëniet me të tjerët duhet t'u kushtojmë kujdes këtyre gjërave:

1. Duhet të mendojmë se si të bëhemi të dobishëm për të tjerët.

2. Për të tjerët duhet të mendojmë gjithmonë mirë dhe të jemi optimistë për ta.

3. Me të mëdhenjtë duhet të sillemi me respekt, kurse me të vegjlit, me dhembshuri.

4. Në marrëdhëniet me shokët duhet të sillemi të sigurtë e me qëllim të mirë. Nëse u vemë re sjellje të këqia, duhet t'i paralajmërojmë me qëllim të mirë.

5. Duhet të sillemi mirë me fqinjët. Duhet të ndajmë me ta gëzimet e hidhërimet.

4. KREU “KUREJSH” DHE KUPTIMI I TIJ

لايلاف قريش . ايلافهم رحلة الشتاء والصيف . فاليعدوا رب هذا البيت . الذى اطعمهم من جوع و آمنهم من خوف .

Kuptimi: “Për hir të garancisë që gëzojnë kurejshët! Për sigurinë e udhëtimit dimrit dhe verës! Le ta adhurojnë të Zotin e kësaj shtëpie i cili i ushqeui pas urisë dhe i siguroi prej çdo frike!”

PERMBLEDHJE

1. Shpjegoni kuptimin e emrit engjëll.
2. Thoni emrat e katër engjëjve të mëdhenj dhe detyrat e tyre.
3. Cilat janë ndikimet e besimit të Allahut dhe engjëjt mbi sjelljen tonë?
4. Ç’duhet të kemi kujdes në sjelljen tonë?
5. Ç’duhet të kemi kujdes në fjalët tona?
6. Ç’duhet të kemi kujdes në marrëdhëniet tona me të tjerët?

PJESA III

U BESOJ LIBRAVE

ÇESHTJET

1. KUPTIMI MBI LIBRAT E SHENJTE
2. PERSE ALLAHU KA DERGUAR LIBRA
3. KATER LIBRAT E MEDHENJ
4. LIBRI YNE, KUR'ANI
 - a. Kthimi i Kur'anit në libër
 - b. Shumimi i Kur'anit
5. VENDI I KUR'ANIT MES LIBRAVE TE TJERE
6. DETYRAT TONA PARA KUR'ANIT
7. KREU "MAUN" DHE KUPTIMI I TIJ

PUNE PERGATITORE

1. Kemi parë se të mëdhenjtë tanë sillen me shumë respekt ndaj Kur'anit. Kërkoni të dini shkakun dhe shkruajeni në fletore.
2. Cilëve profetë u janë dërguar katër librat e mëdhenj? Mësojeni duke pyetur më të mëdhenjtë.
3. Mësoni nga më të mëdhenjtë se pse Kur'ani është libri i fundit.

1. KUPTIMI MBI LIBRAT E SHENJTE

Një prej parimeve tona besimore është edhe besimi te librat e Allahut.

Allahu i Lartë herë pas here ka dërguar profetë dhe disave prej tyre u ka zbritur libra. Këta quhen **“librat e shenjtë”**. Muslimanët duhet t’u besojnë këtyre librave. Sipas fesë sonë, ata që s’u besojnë librave të shenjtë, s’quhen muslimanë.

Në librat e shenjtë përmbahen urdhrat dhe ndalimet e Zotit. Urdhrat dhe ndalimet e Tij njerëzit i mësojnë nga librat e shenjtë dhe i zbatojnë. Gjatë gjithë historisë, Allahu i Lartë ka dërguar shumë libra, disa të mëdhenj e, disa, të vegjël. Njerëzit i kanë lexuar këta libra, kanë zbatuar urdhrat e Zotit dhe janë përpjekur të fitojnë kënaqësinë e Tij.

Kohë pas kohe, për shkaqe të ndryshme, librat e shenjtë në duar të njerëzve ose janë harruar, ose u janë nënshtruar ndryshimeve. Ja, pra, në situata të tilla, Allahu i Lartë ka dërguar një libër tjetër, të ri, duke vazhduar, kështu, t’u mësojë njerëzve kujt t’i besojnë dhe si të sillen. Në librat e shenjtë përmbahen urdhrat, ndalimet dhe këshillat që Allahu na ka përcjellë neve. Njerëzit që i zbatojnë ato, bëhen të lumtur edhe në këtë jetë, edhe në jetën tjetër!

2. PERSE ALLAHU KA DERGUAR LIBRA

Allahu që e ka krijuar njeriun në formën më të bukur, do që ai të jetë i lumtur. Që njeriu të arrijë lumturinë, i duhet të plotësojë disa detyra. Këto detyra na i mësojnë librat e shenjtë. Nga këta libra ne mësojmë t’u besojmë Allahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, profetëve, të dërguarve të Tij, Ditës së Ringjalljes dhe kaderit, mësojmë adhurimet dhe rregullat morale. Në librat e shenjtë janë dhënë njohuri mbi të vërtetat, gabimet, të mirat, të këqiat. Kështu, njerëzit janë orientuar për te e mira dhe janë penguar prej së keqes

Siç mësojmë nga ajeti 213 i kreut “Bakara” të Kur’anit, një kohë njerëzit i besonin vetëm një feje. Të gjithë pranonin ekzistencën dhe njësinë e Allahut. Duke u shtuar me kalimin e kohës, njerëzit mërguan në vende të ndryshme. Në këtë mes, e harruan fenë e tyre të vjetër. Kur besimi i tyre dobësohej dhe futeshin në rrugë të gabuara, Allahu i Lartë u dërgonte profetë që ua tërhiqnin vëmendjen dhe i mbronin të mos futeshin në rrugë të këqia. Kjo gjendje vazhdoi gjer te profeti i fundit, Hz. Muhammedi (a.s.).

3. KATER LIBRAT E MEDHENJ

Allahu i Lartë u ka dërguar profetë shoqërive të kaluara me qëllim për t’u treguar rrugën e drejtë. Disave prej tyre u ka dhënë libra.

Disa prej librave janë të vegjël, vetëm disa fletë. Këtyre u thonë “fletë”.⁵ Ndërkaq, katër profetëve të veçantë u ka dërguar katër libra të mëdhenj. Tani le të shohim se cilët janë këto libra dhe kujt i janë dërguar.

1. Teurati.⁶ I është dhënë Hz. Musait (a.s.). Është libri i shenjtë i hebrenjve.

2. Zeburi.⁷ I është dhënë Hz. Daudit (a.s.). Rrëfëhet se Hz. Daudi e ka kënduar Zeburin me zë të bukur dhe dëgjuesit, të prekur nga kjo, e kanë besuar. Zeburi qe bashkuar si shtojcë në fund të Teuratit.

3. Ungjilli.⁸ I është dhënë Hz. Isait (a.s.). Ashtu si Teurati dhe Zeburi, edhe Ungjilli është ndryshuar nga ana e njerëzve. Është libri i shenjtë i krishterëve. Ungjilli nuk qe hedhur në shkrim në të gjallë të Hz. Isait. Atë e shkruan, më vonë, apostujt e tij.

4. Kur’ani.⁹ Është i fundit i librave të shenjtë. I është dërguar profetit tonë të dashur, Hz. Muhammedit (s.a.v.).

Muslimanët i pranojnë të gjithë librat e shenjtë. Ata e dinë se ata janë dërguar nga ana e Allahut. Ndërkaq, besojnë se prej tyre, vetëm Kur’ani ka ardhur gjer në ditët tona pa pësuar asnjë ndryshim.

Me këtë besim, muslimanët përpiqen të zbatojnë urdhrat e Allahut që përmbahen në Kur’an.

4. LIBRI YNE, KUR’ANI

Kur’ani i Lartë është libri ynë i shenjtë i zbritur pjesë-pjesë gjatë 23 vjetëve Profetit tonë me ndërmjetësinë e engjëllit Xhebrail. Të gjitha ajetet që përmbahen në Kur’an, i përkasin Allahut, janë fjalë e Tij. Në Kur’an nuk përmbahen fjalë të Profetit apo të dikujt tjetër.

Në Kur’an ka shumë sure (krerë) dhe ajete.

Sure (kre): Është emërtimi i secilës pjesë të Kur’anit. Për nga tematika dhe kuptimi, sureja përbëhet prej ajetesh që janë vazhdim i njëri-tjetrit. Në Kur’an ka gjithsej 114 sure të shkurtra apo të gjata.

Ajet: Çdo fjali e sures quhet ajet. Disa ajete janë të gjatë e, disa, të shkurtër.

Profeti ynë, ajetet e Kur’anit që ia sillte Xhebraili (a.s.), edhe i mësonte vetë përmendësh, edhe ua bënte të ditura, pa humbur kohë, muslimanëve, shumica e të

⁵ Në terminologjinë përkatëse është emri arabisht shumë “suhuf”. (Shën. i përkthyesit)

⁶ Tora, Testamenti i Vjetër, Dhjata e Vjetër. (Shën. i përkthyesit)

⁷ Libri i Psalmeve, Psalmet e Davidit. (Shën. i përkthyesit)

⁸ Testamenti i Ri, Dhjata e re. (Shën. i përkthyesit)

⁹ Duhet të kihet kujdes në shkrimin dhe leximin e kësaj fjale arabishte që është e së njëjtës familje me fjalën “ikra”, “lexo”. Heqja e apostrofit dhe leximi i kësaj fjale pa apostrof, e përngjason me emrin persisht “kuran” që është një fjalë krejt tjetër dhe ka kuptim krejt tjetër. (Shën. i përkthyesit)

cilëve, gjithashtu, i mësonin përmendësh. Ajetet që i vinin, Profeti ua jepte menjëherë për t'i shkruar muslimanëve që kishin shkrim të bukur, të cilët u quajtën **“qatipët e zbulesës”**. Kështu, ajetet e Kur'anit u ruajtën në po atë formë që i erdhën Profetit. Ja, në këtë mënyrë Kur'ani ka ardhur gjer në ditët tona pa pësuar asnjë ndryshim! Në ajetin e 9 të kreut Hixhr të Kur'anit, Allahu i Lartë pati urdhëruar: **“Pa dyshim, Ne e kemi zbritur Kur'anin dhe, pa dyshim, Ne do ta mbrojmë atë!”** Dhe 14 shekujt që pasuan, e vërtetuan premtimin e Zotit. Po kështu, Kur'ani do të arrijë gjer në kiamet pa iu ndryshuar edhe një shkronjë e vetme! Kur'ani përbëhet prej rreth 600 faqesh.

Këndimi i Kur'anit është *sevap*, mirësi. Prandaj muslimanët e këndojnë Kur'anin dhe e dëgjojnë me respekt kur e këndojnë të tjerët. Disa muslimanë të kohës së Profetit e patën mësuar Kur'anin përmendësh. Kjo traditë ka ardhur gjer në ditët tona. Gjatë gjithë historisë, me qindra mijra vetë e kanë mësuar Kur'anin përmendësh, gjë që vazhdon edhe sot. Atyre që e mësojnë Kur'anin plotësisht përmendësh, u thonë **“hafizë”**.

a. Kthimi i Kur'anit në libër

Kur'ani u mblodh dhe u bë libër pas vdekjes së Profetit (a.s.). Kjo ndodhi kështu:

H.z. Ebu Bekri që ishte kalif, ngriti një komision nën kryesinë e Zejd b. Sabitit. Komisioni lajmëroi popullin që kush të kishte ajete të shkruara të Kur'anit, t'i sillte. Gjithashtu, komisioni kërkoi nga ata që sillnin ajete të shkruara, nga dy dëshmitarë të besueshëm që të dëshmonin se ajetet ishin shkruar pasi ishin dëgjuar drejtpërsëdrejti nga Profeti. Në mënyrë të veçantë, komisioni e kontrollonte saktësinë e tyre duke ua kënduar atyre që e dinin Kur'anin përmendësh. Kështu, Kur'ani u mblodh me një kujdes dhe korrektësi të madhe dhe u bë libër.

b. Shumimi i Kur'anit

Me kohë, islami u përhap në të gjitha anët. Numri i muslimanëve u shtua. Çdo njeri kërkonte ta këndonte e ta mësonte Kur'anin përmendësh. Kjo gjendje kërkonte që, pa i lënë rast asnjë gabimi, Kur'ani të shumohej. Po qe se shembulli ose modeli ku do të drejtohej populli për ta gjetur të vërtetën, do të ishte Kur'ani, nuk do të bëheshin gabime. Duke menduar kështu, kalifi H.z. Osmani, e shumoi Kur'anin duke marrë për bazë tekstin e vetëm të tij të mbledhur kohë më parë e të sjellë në formë libri. Pastaj dërgoi nga një kopje në qytetet kryesore. Atje, pastaj, muslimanët e shumuan atë kopje sipas nevojave dhe kështu erdhi Kur'ani gjer më sot pa pësuar anjë ndryshim!

Lexim letrar

Kur'ani është fjala e Allahut

Ishin vitet e para të profetësisë.

Profeti ynë u këndonte Kur'an atyre që i shkonin pranë dhe ua mësonte urdhrat e Allahut.

Në atë periudhë, arabët kishin arritur një nivel të lartë letrar. Poezitë e poetëve të shquar, me burra e me gra, i dinin të gjithë përmendësh. Kur'ani nuk ishte poezi, megjithatë, ishte më i ëmbël, më me kuptim se një poezi. Ata që e dëgjonin Kur'anin një herë, kërkonin ta dëgjonin përsëri!

Disa arabë që nuk i besonin Profetit, nuk afroheshin për ta dëgjuar Kur'anin. Ata thoshin me frikë: "Po ta dëgjojmë Kur'anin, magjepsemi pas tij e bëhemi muslimanë"! Prandaj edhe popullin e ndalonin të dëgjonte.

Mirëpo kënaqësia që jepte dëgjimi i Kur'anit, ishte diçka krejt e veçantë!

Disa vetë që krenaria nuk i lejonte të shkonin te Profeti për të dëgjuar Kur'an, të nxitur, megjithatë, nga një dëshirë e papërballueshme për të, prisnin sa të binte errësira e natës dhe, në fshehtësi, duke u përpjekur të mos i shihte kush, shkonin pranë shtëpisë së Profetit dhe dëgjonin nën dritare Kur'an. Dhe, kur ndodhte që të takoheshin aty, të strukur nën dritare, me njëri-tjetrin, ulnin kokën e largoheshin pa folur, ashtu siç kishin ardhur, si hije!

Velidi ishte nga fisi aristokrat i kurejshve. Ishte një burrë i moshuar me autoritet që i dëgjohej fjala. Prandaj nuk mund të bënte si të tjerët. Kështu, një ditë, shkoi te Profeti e i tha:

- Këndona pak Kur'an, të dëgjojmë!

Profeti nisi të këndonte.

Velidi dëgjonte me veshët e zemrës.

Aman, o Zot, ç'fjalë të bukura që të preknin thellë!

Velidi ishte emocionuar shumë!

Kur Profeti mbaroi, Velidi foli me gjithë zemër:

- Betohem se në Kur'an ka një shije të mrekullueshme, një bukuri të pashoqe! Këto janë fjalë të thella e shumë të dobishme! Jo, jo, këto s'janë fjalë njeriu, njeriu s'mund të flasë kështu!

Pastaj Velidi iu kthye të pranishmëve:

- Nuk ka prej jush që ta njohë poezinë më mirë se unë. Fjalët që këndoi Muhammedi, nuk i ngjasin asnjë fjale. **Ato janë mbi çdo fjalë tjetër. Askush nuk mund të thotë fjalë më të bukur se ato!**

Kështu foli Velidi. Sa e sa të tjerë u mahnitën pas Kur'anit si ai! Poetët arabë përkulën kokën para tij!

E ç'gjë mund të ishte më e natyrshme se kjo! **Sigurisht, Allahu që e kishte krijuar njeriun e që i kishte dhënë atij mendje dhe kënaqësi të larta, do ta dinte më mirë se gjithkush tjetër se si ta kënaqte, se si ta emociononte shpirtin e njeriut!..**

Lexim letrar

Kur'ani, libri ynë i shenjtë

Allahu na ka treguar në Kur'an gjërat e dobishme e të dëmshme dhe na ka kërkuar të bëjmë të dobishmet e të ruhemi prej të dëmshmeve. Në Kur'an ka shumë këshilla për këtë jetë e për jetën tjetër, ka rrëfime që na tregojnë për gjendjen e keqe ku patën rënë popujt e shkuar për shkak të moralit të keq.

Para se çdo gjë tjetër, Kur'ani bën të ditur njësinë e Allahut. Ai thotë se pas jetës së kësaj bote është jeta tjetër pas ringjalljes. Atje njerëzit do të marrin dobinë dhe dëmin e të mirave dhe të këqiave të bëra në këtë botë dhe asnjë e keqe nuk do të mbetet pa u ndëshkuar.

Pastaj, në Kur'an është urdhëruar: "Jini të pastër, falni namaz, agjëroni, jepni zeqat, ecni në rrugën që ua kanë treguar Allahu dhe i dërguari i Tij. Ndihmoni nevojtarët, bëjuni mirë të gjithëve sa t'ju vijë për dorë, kurrsesi mos mendoni keq për të tjerët. Mësoni, respektoni prindërit, mos ua thyeni zemrën. Tregoni respekt ndaj të mëdhenjve dhe dhembshuri ndaj të vegjëlve. Përpiquni vazhdimisht ta zbukuroni moralin tuaj dhe largohuni prej veseve të këqia."

Çdo musliman i beson Kur'anit dhe tregon respektin më të madh ndaj tij. Ne s'e marrim në dorë Kur'anin pa abdest. U besojmë thënieve të tij. Bëjmë ato që na thotë të bëjmë dhe nuk bëjmë ato që na thotë të mos i bëjmë. Ç'të ketë thënë Kur'ani, është e drejtë, e vërtetë. Çdo fjalë e Kur'anit është fjalë e Allahut. Kështu i besojmë ne, muslimanët, Kur'anit!

5. VENDI I KUR'ANIT MES LIBRAVE TE TJERE

Kur'ani i është dërguar Profetit tonë pjesë-pjesë për rreth 23 vjet me radhë.

Pas Kur'anit që është i fundit i librave të shenjtë, nuk ka për të ardhur libër tjetër. Sepse Kur'ani u flet të gjitha kohëve!

Kur'ani nuk i është dërguar një kombi të, një race apo një shoqërie të caktuar. Ai i është dërguar gjithë njerëzimit! Prandaj edhe është i gjithë botshëm.

Librat e tjerë të shenjtë nuk janë mësuar përmendësh. Kurse Kur'anin e ka mësuar përmendësh Profeti, i cili, pastaj, u ka kërkuar edhe të tjerëve ta mësojnë. Sot në botë ka me miliona hafizë që e dinë Kur'anin përmendësh.

Shkurt, Kur'ani na e ndriçon edhe këtë jetë, edhe jetën tjetër. Ai u flet çdo lloj mendimi dhe ndjenje. Ai është një libër që ka veçorinë t'u japë përgjigje nevojave të çdo periudhe. Të gjithë njerëzit janë të ngarkuar me përgjegjësinë për ta zbatuar Kur'anin, sepse ai është i vetmi libër hyjnor i pranueshëm te Allahu!

6. DETYRAT TONA PARA KUR'ANIT

Kur'ani është libri ynë i shenjtë. Nga ai e mësojmë fenë. Urdhrat dhe ndalimet e Allahut i mësojmë duke e kënduar Kur'anin. Ai na këshillon të bëjmë mirë. Na kërkon të ruhem i prej të këqijave. Në Kur'an Allahu na mëson rrugët për t'u bërë të lumtur në këtë botë e në jetën tjetër. Të gjitha këto na ngarkojnë me detyra para Kur'anit.

a. Ç'duhet të kemi kujdes kur e kemi me vete Kur'anin?

Respekti ndaj Kur'anit është detyrë për çdo musliman. Në shtëpi, Kur'anin duhet ta mbajmë në një vend të pastër e të lartë, mbështjellë në një këllëf. Edhe kur e bartim me vete, duhet ta ruajmë në një çantë ose këllëf që të mos griset.

Kur e vemë Kur'anin në një vend ose kur e marrim, duhet të jemi me abdest. Duhet të ruhem nga sjelljet ose veprimet pa respekt ndaj Kur'anit dhe duhet të bëjmë çmos që të mos fëlliqet e të mos griset.

b. Ç'duhet të kemi kujdes kur këndojmë apo dëgjojmë Kur'an?

Para se të nisim të këndojmë Kur'an, duhet të pastrojmë trupin dhe rrobat. I pastër duhet të jetë edhe vendi ku do të këndojmë Kur'an. Veçanërisht, para këndimit të Kur'anit duhet të marrim abdest, sepse Allahu i Lartë urdhëron kështu në Kur'an: **"Atë mund ta prekin vetëm ata që pastrohen!"** (Kur'ani, Vakia: 79) Allahu na e ka ndaluar ta marrim në dorë Kur'anin pa abdest.

Këndimin e Kur'anit duhet ta dëgjojmë në heshtje, me respekt dhe me sinqeritet. Në këtë mes nuk duhet të merremi me punë të tjera. Nuk duhet të bisedojmë me të tjerë. Duhet të përqijemi që gjithë interesimin dhe vëmendjen ta përqëndrojmë te ai!

c. Allahu e ka dëguar Kur'anin për ta kuptuar dhe për të vepruar siç thotë ai!

Allahu i Lartë e ka dërguar Kur'anin për t'u treguar njerëzve rrugën e drejtë. Kur'ani na mëson mirësitë e bukuritë. Na tregon se si duhet të ruhem prej ligësive e shëmive. Në Kur'an përmbahen urdhrat dhe ndalimet e Allahut. Muslimani i mëson të gjitha këto duke i lexuar në Kur'an. Prandaj duhet të tregojmë kujdes që ta këndojmë Kur'anin duke e kuptuar. Dhe për këtë, duhet të lexojmë edhe përkthimin dhe komentimin e tij.

Ajeti i parë që i erdhi Profetit tonë, fillon me urdhrin "lexo!" kurse në një ajet tjetër, Allahu i Lartë urdhëron: **"Ta zbritëm ty këtë libër të shenjtë me qëllim që të mendojnë për ajetet e tij dhe, ata që kanë mend, të kuptojnë..!"** (Kur'ani, Sa'd: 29) Edhe Profeti ynë ka thënë se *"njeri i dobishëm është ai që e mëson Kur'anin dhe ua mëson edhe të tjerëve pastaj!"* (Tâc Tercümesi)

Të gjitha këto tregojnë për rëndësinë e këndimit, mësimit dhe zbatimit të Kur'anit!

Lexim letrar

Këndimi i Kur'anit duke e kuptuar

"Kur këndohet Kur'an, dëgjojeni dhe heshtni që të mëshiroheni!" (Kur'ani, A'raf: 204)

Çdo libër, madje çdo fjalë, duhet të kuptohet mirë nga ana e dëgjuesve në mënyrë që të mund të zbatohet. Në të kundërt, e mërzit dhe e lodh si atë që e tregon, ashtu edhe atë që e dëgjon. Ndërkaq, sjell prehje e kënaqësi dhe jep gëzim në atë masë që kuptohet.

Njeriu i sotëm, për shkak të shkëputjes nga kultura e vet, ka bërë fli shumë vlera vetiake, urat mes të shkuarës, të sotmes dhe të ardhmes i janë shembur. Ai bërtet e thërret si dy vetë që i thërrasin, pa u marrë vesh dot, njëri-tjetrit, njëri në njërin breg të lumit e, tjetri, në bregun tjetër, dhe as ai që flet e, as ai që dëgjon, nuk marrin vesh gjë! Edhe mënyra me të cilën e shohim fenë dhe librin tonë, s'është e ndryshme prej kësaj. Lidhur me këtë, në veprën poetike "Mesnevi" të poetit të shquar Xhelaleddin Rumi, ka një histori të bukur. Ajo është kështu:

“Një i shurdhër kërkon t’i bëjë vizitë fqinjit të tij të sëmurë. Ndërkaq, mendon me dyshim se si do të mund t’i dëgjonte fjalët e një të sëmuri me zërin të mpakur nga sëmundja dhe, para se të niset për të shkuar, bën një plan të bisedës së mundshme që do të zhvillonte me të sëmurin.

Unë do ta pyes: “Si je, o komshi?” Dhe ai do të më përgjigjet: “Më mirë!” Unë do t’i them: “Gëzohem! Po çfarë po ha?” Ai: “Nja dy lugë supë e një gotë sherbet!” Pastaj do ta pyes: “Kush vjen e shkon!” Dhe ai do të më thotë: “Po, ja, filani e filani...” Pastaj edhe unë shoh e bëj e i them ndonjë gjë...

Dhe ngrihet e shkon shurdhi në shtëpinë e të sëmurit!

“Si je, o komshi?”, e pyet të sëmurin. “Po vdes!...”, i përgjigjet i sëmuri. “O, po më vjen mirë”, ia kthen shurdhi, “gëzohem!” Pastaj e pyet të sëmurin: “Me se po mbahesh, çfarë po ha?” Kurse i sëmuri: “Ç’pyet! Helm! Asgjë s’më shkon poshtë!” Dhe shurdhi ia kthen: “Të bëftë mirë!”

I sëmuri i nervozuar nga përgjigjja e parë e vizitorit, hidhërohet shumë nga kjo e dyta. Prandaj, kur vizitori i bën pyetjen e tretë për ata që po i hyjnë e dalin, i përgjigjet gjithë zemërim: “Azraili!.. Këput qafën, more!” Kurse shurdhi, krejt i qetë, ia kthen duke e luajtur mendsh, këtë radhë, të sëmurin: “Pastë këmbën e mbarë!”

Ja, pra, edhe halli ynë nuk ndryshon prej kësaj. Jemi si të huaj ndaj librit tonë. E këndojmë Kur’anin pa marrë vesh gjë se ç’kërkon Allahu i Lartë prej nesh! E këndojmë sipas ndjenjave dhe interesave tona. Kurse ai është një libër i zbritur për ta rregulluar e harmonizuar jetën tonë, për të na bërë që ta kalojmë të kënaqur e të lumtur këtë jetë dhe jetën tjetër. Është burimi i të gjitha diturive. Ai i ka bërë dritë çdo çështjeje për të cilën njerëzit kanë nevojë. Vetëm se ai duhet kuptuar, duhet kënduar duke e kuptuar. Ai s’kuptohet duke e kënduar si shurdhët apo qorrat, pa marrë vesh gjë prej tij!

7. KREU “MAUN” DHE KUPTIMI I TIJ

أَرَأَيْتَ الَّذِي يُكَذِّبُ بِالذِّينِ (١) ۚ إِنَّكَ الَّذِي يُدْعُ الْيَتِيمَ (٢) وَلَا يَحْضُ عَلَى طَعَامِ
الْمِسْكِينِ (٣) فَوَيْلٌ لِّلْمُصَلِّينَ (٤) الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ (٥) الَّذِينَ هُمْ
يُرَآؤْنَ (٦) وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ (٧)

Kuptimi: “A e ke parë atë që përgënjeshton fenë? Eshtë ai që e përze bonjakun. Dhe nuk nxit për të ushqyer të varfërin. Sa keq për ata që falin namaz, që nuk janë seriozë ndaj namazit të tyre! Ata vetëm sa shtiren dhe i bëhen pengesë së mirës!”

PERMBLEDHJE

1. Ç’kuptojmë me emërtimin “libër i shenjtë”?
2. Librat e shenjtë përse janë dërguar?
3. Cilët janë katër librat e mëdhenj dhe cilëve profetë u janë dërguar?
4. Pse Kur’ani është bërë libër?
5. Ç’janë suret dhe ajetet?
6. Si është ruajtur Kur’ani pa iu bërë asnjë ndryshim?
7. Në ç’vend të shtëpisë duhet ta vendosim dhe ruajmë Kur’anin?
8. Ç’duhet të kemi kujdes kur këndojmë dhe dëgjojmë Kur’an?
9. Pse duhet të përpiqemi për ta kuptuar Kur’anin?

PJESA IV
U BESOJ PROFETEVE

ÇESHTJET

1. PROFETESIA DHE FEJA
2. PROFETET. PERSE ALLAHU KA DERGUAR PROFETE?
 - a. Profetët
 - b. Përse Allahu ka dërguar profetë?
 - c. Ç'na mësojnë profetët?
3. Ç'NJEREZ JANE PROFETET?
4. PROFETET QE KANE LIBRA
5. PROFETI YNE, HZ. MUHAMMEDI (a.s.)
6. DETYRAT TONA PARA PROFETIT
 - a. Ta duam dhe ta respektojmë Profetin tonë
 - b. T'i mbajmë këshillat, t'i marrim si shembull sjelljet dhe veprimet e tij.
7. KREU "KAFIRUN" DHE KUPTIMI I TIJ

PUNE PERGATITORE

1. Kush janë profetët dhe përse janë dërguar?
2. A keni njerëz prej të cilëve mund të merrni të dhëna mbi profetët? Merrni të dhëna dhe i shkruani në fletore.
3. Pse duhet t'i duam profetët?
4. Ç'dini për profetin e fundit, Hz. Muhammedin (a.s.)?

1. PROFETESIA DHE FEJA

Njëri prej parimeve tona besimore është edhe besimi te profetët.

“Profet” do të thotë i dërguar, përfaqësues, lajmëtar i Zotit. Profetët janë personat që urdhrat dhe ndalimet e marra prej Zotit me ndërmjetësinë e engjëllit Xhebrail, ua kanë përcjellë njerëzve.

Allahu i do krijesat e Tij. Ai nuk do që ata të shmangen për në rrugë të gabuara. Prandaj, njeriun e parë, Ademin, e ka ngarkuar edhe me detyrën e profetit. Edhe Hz. Ademi, duke ua kumtuar njerëzve urdhrat e Allahut të Lartë, i ka udhëzuar ata për në rrugën e drejtë.

Urdhrave të dërguara njerëzve nga Allahu me anë të profetëve, u thuhet “**fe**”.

Të gjithë profetët janë robtë e zgjedhur të Zotit. Secili prej tyre është i dallueshëm prej njerëzve të tjerë dhe bartës i cilësive dhe tipareve të veçanta. Askush nuk mund të bëhet profet me dëshirën e vet. Allahu ngarkon me detyrën e profetit kë të dojë. Ne u besojmë të gjithë profetëve.

Lexim letrar

Profeti është ftues

Profeti ynë i dashur, ne dhe feja që solli ai... A e dini me ç’ngjason kjo treshe? Po deshët, le ta marrim vesh këtë nga goja e engjëjve.

Një ditë, ndërsa Profeti po rrinte në shtëpi, ra në një gjumë të ëmbël.

Engjëjt iu ulën përreth. Dikush te kryet, dikush te këmbët. Njëri prej tyre pyeti:

“Kujt i përngjet puna e Muhammedit, a e dini? Kush e thotë?”

“Po ai është në gjumë tashti - tha tjetri - s’na dëgjon. Biseda jonë s’i sjell ndonjë dobi!”

Një engjëll tjetër që e njihte mirë Profetin dhe ishte më i ditur se të tjerët, shpjegoi:

“Jo, ai nuk u përngjet njerëzve të tjerë. Edhe pse sytë i flenë, zemra i rri zgjuar!”

Atëherë, një tjetër prej engjëjve e mori fjalën dhe tha kështu:

“Një herë e një kohë, një i pasur kishte ndërtuar një pallat të bukur. Ndërkaq, fama e pallatit ishte përhapur aq shumë, sa ata që e dëgjonin, digjeshin nga dëshira për ta parë! Edhe i pasuri bënte plane për këtë punë. Ai kishte menduar që, para se ta hapte pallatin për vizitorët, të jepte një gosti të madhe. Dhe kishte nisur nga përgatitjet. Kuzhinierët kishin gatuar lloj-lloj gjellësh të mira, ishin bërë gati sofa të mëdha e të mbushura plot e përplot. Atëherë, i pasuri kishte thirrur një prej njerëzve të vet që i besonte shumë dhe e kishte porositur:

“Do të ftosh të gjithë njerëzit që të shohësh dhe do t’u thuash se ata që do të vijnë në këtë gosti, do të kenë mundësi ta shëtisin tërë pallatin, kurse ata që s’kanë për të ardhur, nuk do të mund ta vizitojnë kurrë më pallatin me që nuk iu përgjigjën ftesës!”

Dhe ftuesi kishte bërë si i kishin thënë.

Të ardhurit në gosti e kishin shëtitur krejt atë pallat të bukur, kurse ata që s’kishin ardhur, e kishin humbur rastin!”

Në këtë mes, në bisedë ish përzjerë një engjëll tjetër:

“Sikur të na e sqaroje se ç’lidhje ka mes kësaj historie dhe Muhammedit e ta merrim vesh edhe ne!”

Një engjëll tjetër tha:

“Megjithatë, njeriu që fle, nuk kupton gjë se ç’thuhet për të!”

Këtu ndërhyri engjëlli i ditur:

“Ju thashë se edhe në se këtij i flenë sytë, zemra i rri zgjuar! Na dëgjon dhe na kupton!..”

Një engjëll tjetër tha:

“Ngjasimin po e sqaroj unë! Në këtë shembull, i pasuri që ka ndërtuar pallatin, është **Allahu**; pallati është **xhenneti**; ftuesi është **profeti Muhammed**; ftesa për në gosti është ftesa për në **islam**; të ardhurit në gosti, janë ata që e kanë pranuar islamin!

Kjo do të thotë se ata që i besojnë fesë së vërtetë të sjellë nga profetët, do të hyjnë në xhennet, kurse ata që nuk i besojnë, në asnjë mënyrë s’do të pranohen në xhennet!”

Pas pak Profeti u zgjua nga gjumi dhe ua tregoi të pranishmëve një për një bisedën e engjëjve!

2. PROFETET. PERSE ALLAHU KA DERGUAR PROFETE?

a. Profetët

Zoti ynë i Lartë na do shumë ne. Ai dëshiron gjithmonë të mirën tonë. Kohë më kohë Ai ka dërguar profetë me qëllim që ne të mos biem në rrugë të këqia, që të na ndihmojë të ecim gjithmonë në rrugë të drejtë.

Profeti i parë është Hz. Ademi. Kurse i fundit, profeti ynë i dashur, Hz. Muhammedi (a.s.). Mes këtyre të dyve kanë ardhur shumë profetë të tjerë. Ne nuk e dimë numrin e plotë të tyre. Në Kur'an përmenden emrat e vetëm njëzet e pesë prej tyre dhe jepen, nga ana e Allahut, të dhëna për ta. Emrat e tyre janë:

Adem, Idris, Nuh, Hud, Salih, Lut, Ibrahim, Ismail, Is'hak, Jakub, Jusuf, Shuaib, Musa, Harun, Daud, Sulejman, Ejub, Junus, Iljas, Eljesa, Dhulkif, Zekeria, Jahja, Isa, Muhammed.

Profetët nuk shmangen nga e drejta. Kurrë nuk ka ndodhur të gënjejnë. Janë njerëz shumë të zgjuar. Ata nuk bëjnë mëkate. Urdhrat e marra nga Zoti ua kumtojnë njerëzve pa të metë.

Kur përmendet emri i një profeti, duhet shoqëruar me shprehje lutëse për mëshirë dhe paqe, si “**alejhisselam** “ (a.s.), “paqja qoftë mbi të!” ose “**sal'lallahu alejhi vesel'lem**” (s.a.v), “mëshira dhe paqja e Allahut qofshin mbi të!” Për profetët e tjerë veç Hz. Muhammedit, përdoret, përgjithësisht, lutja “alejhisselam”.

b. Përse Allahu ka dërguar profetë?

Le të mendojmë, për një çast, se kemi mbetur në një natë të errët, krejt të vetëm e pa orientim! A mundet ta gjejmë vetë rrugën e të kthehemi në shtëpi?

Ose le të mendojmë ditët tona të para në shkollë. A do të mund të mësonim, vallë, shkrim e këndim pa ndihmën e mësuesit e të prindërve?

Ecja nëpër pyll në një natë të errët, mësimi i shkrimit dhe i këndimit pa mësues, s'janë aspak gjëra të lehta! Pa profetët, është shumë e vështirë t'i mësojmë në mënyrë të mjaftueshme rregullat fetare. Edhe sikur ta mësojmë ekzistencën e Zotit duke menduar, nuk mund ta mësojmë dhe dimë se si duhet ta adhurojmë atë. Prandaj Allahu i Lartë u ka dërguar njerëzve profetë, që t'ua mësojë fenë!

Hz. Ademi, njeriu i parë, është edhe profeti i parë. Njerëzimi ka rrjedhur prej tyre dhe është shumë. Ndërkaq, me kalimin e kohës, njerëzit janë larguar nga rruga e drejtë. E kanë harruar Zotin dhe kanë nisur të adhurojnë idhujt. Atëherë, Zoti u ka dërguar njerëzve profetë për t'u kujtuar dhe mësuar rrugën e drejtë. Dhe kjo ka ndodhur kështu herë pas here gjer në ardhjen e profetit të fundit, Hz. Muhammedit (a.s.)!

c. Ç'na mësojnë profetët?

Profetët na mësojnë se si duhet t'i bindemi Zotit dhe ta adhurojmë atë, pra, siç thuhet ndryshe, të kryejmë detyrën e robit ndaj Tij! Me moralin e tyre të bukur, profetët bëhen shembull për ne. Ata na mësojnë të vërtetën, të drejtën, ndershmërinë, mirëkuptimin, faljen, mëshirën, dhembshurinë, na mësojnë se si të jemi punëtorë e të papërtuar. Ata na kujtojnë ne se pas kësaj bote është një botë dhe një jetë tjetër duke na njoftuar se ata që zbatojnë urdhrat dhe ndalimet e Zotit, do të jenë të lumtur në këtë botë dhe, në jetën tjetër, do të hyjnë në xhennet, në parajsë. Kurse kundërshtuesit e urdhrave të Zotit do të ndëshkohen!

3. Ç'NJEREZ JANE PROFETET?

Profetët janë njerëz si ne. Hanë e pinë, shëtisin, martohen e krijojnë familje. Edhe ata sëmuren si gjithë njerëzit e tjerë dhe, në fund, vdesin. Ndërkaq, ata kanë cilësi dhe tipare të veçanta shumë të vlefshme e të rëndësishme që i dallojnë prej njerëzve të tjerë.

Këto cilësi dhe tipare janë:

E para, drejtësia. Profetët janë njerëz të drejtë, të ndershëm e besnikë.¹⁰

Ç'është e vërteta, çdo njeri duhet të jetë i drejtë. Ndërkaq, kërkohet që njeriu i cili do të përcjellë e kumtojë tek të tjerët urdhrat e Zotit, të jetë model. Prandaj ndodh që profetët nuk gënjejnë, nuk venë dorë padrejtësisht mbi gjënë e tjetrit, janë gjer në fund të drejtë, të ndershëm e besnikë!

Sa për Profetin tonë, edhe ata që s'e besonin, edhe armiqtë e tij më të betuar e pranonin, madje edhe hapur, se ai ishte fjalëdrejtë! Në krye të tyre vinte Ebu Xhehli. Një ditë, njëri prej fisnikëve mekas e takon në rrugë, në një vend pa lëvizje, Ebu Xhehlin dhe i thotë:

"Këtu s'ka njeri tjetër veç nesh. Pra, më thuaj të drejtën, Muhammedi të vërtetën thotë, apo gënjen?"

I drojtur, Ebu Xhehli hedh sytë përreth dhe, pasi sigurohet se s'e dëgjon kush, përgjigjet:

"Ç'është e drejta, Muhammedi thotë të vërtetën! Ai kurrë s'ka gënjer!"

"E pse s'e besoni, atëherë?"

"Ka shumë kohë që mes fiseve tona ka fërkime. Secili fis kërkon të shquhet. Gjer më sot kemi qenë aty aty. Kurse tani ata do të thonë se nga fisi i tyre doli një profet! Prandaj edhe nuk i shkojmë pas, nuk i besojmë profetësisë së tij!"

E dyta, besueshmëria.¹¹ Profetët janë njerëz të besueshëm.

¹⁰ Në terminologjinë fetare osmane përdoret termi "sıdk" , i drejtë, i ndershëm, besnik. (Shën. i përkthyesit)

Të gjithë profetët ua kanë përcjellë dhe kumtuar njerëzve urdhrat e Zotit pa asnjë të metë, pa u shtuar ose lënë mangut gjë. Dhe këtë e kanë bërë edhe pse s'kanë pasë frikë asgjë e askënd tjetër veç Zotit!

Edhe para se të bëhej profet, të gjithë bashkëvendasit e tij pa përjashtim, kushdo që e njihte, e besonte Muhammedin. Atë e patën mbiquajtur njëzëri **“Muhammed Emin”, “Muhammedi i Besueshëm”!** Dhe kjo gjë për atë kohë ishte diçka krejtësisht e rrallë, krejtësisht e veçantë, krejtësisht e jashtëzakonshme!

E treta, kumtesa.¹² Detyra themelore e profetëve është kumtimi i Fjalës së Zotit. Prandaj ka ndodhur që profetët nuk janë tërhequr kurrë nga kjo detyrë pavarësisht prej pengesave, vuajtjeve e shqetësimeve që u kanë rënë mbi krye. Për shkak të këmbënguljes për ta çuar gjer në fund këtë detyrë, profetët janë kërcënuar edhe me vdekje, kurse profetët Zekerija dhe Jahja janë vrarë. Edhe Profeti ynë ka vuajtur shumë. Ai ka qenë i vendosur gjer në fund në detyrën e vet. Kur kundërshtarët i patën premtuar gjithçka që të dëshironte vetëm të hiqte dorë prej çështjes së tij, u qe përgjigjur: **“Edhe sikur të më vini diellin në një dorë e hënën, në tjetrën, nuk kthehem nga kjo rrugë!”**

E katërta, zgjuarësia.¹³ Të gjithë profetët janë dalluar për zgjuarësi të veçantë. Lidhur me këtë cilësi, po japim dy shembuj nga jeta e Hz. Ibrahimit.

Fisi i Hz. Ibrahimit qenë idhujtarë. Një ditë, ai shkoi në tempullin ku fisi mbante idhujt e vet. I theu të gjithë idhujt veç atij më të madhit, kryeidhullit. Pastaj, e mori sëpatën dhe ia vuri në sup kryeidhullit. Kur e morën vesh ngjarjen dhe e panë me sytë e vet, njerëzit e fisit dyshuan te Ibrahim. E thirrën dhe e pyetën:

“Ti e bërë këtë punë?”

Dhe Ibrahimiu iu përgjigj:

“Siç duket, do ta ketë bërë kryeidhulli! Duhet të jetë zemëruar me ju që i adhuronit edhe idhujt e tjerë veç tij. Fundja, pse më pyesni mua, pyeteni vetë atë!..”

Një tjetër ngjarje është kjo:

Sunduesi i kohës së Ibrahimit, Nemrudi (Nimrodi), pretendonte se ishte zot. Prandaj edhe nuk e pranonte Zotin e Ibrahimit. Një radhë, Ibrahimiu i pati thënë:

“Zoti im e bën diellin të lindë nga ana e lindjes. Në se ti je zot, bëje të lindë nga perëndimi!”

Dhe Nemrudi që s'diti ç't'i thoshte, heshti!

E pesta, pafajësia.¹⁴ Profetët janë të mbrojtur prej mëkateve, ata janë të pafajshëm.

¹¹ Emanet. Në shqip kjo fjalë përdoret në trajtën “amanet”. Njeri i besueshëm quhet ai që e ruan dhe e çon në vend amanetin. (Shën. i përkthyesit)

¹² Teblig. (Shën. i përkthyesit)

¹³ Fetanet. (Shën. i përkthyesit)

Me çdo sjellje të tyre, profetët janë shembull për njerëzit. Kështu që, duhet që profeti të shmanget prej çdo lloj mëkati që e ul njeriun dhe ia pakëson vlerën. Këtë ata e arrijnë me ndihmën e Zotit që i ruan të dërguarit e Tij!

Për këtë do të japim një shembull.

Po meremetohej Qabeja. Atë kohë Muhammedi ishte i ri, ende s'ishte bërë profet. Si të gjithë, edhe ai barte gurë në sup. I ungji i tha:

“O bir, si të tjerët, edhe ti palose fundin e rrobës dhe vëre në sup që mos të të vrasin gurët!”

Sapo e përveshi fundin e rrobës dhe e vuri në sup, i ra të fikët e u rrëzua. Shumë i shqetësuar, i ungji e pruri në vete dhe e pyeti:

“Ti ishe mirë, ç'pate?”

Dhe djaloshi Muhammed iu përgjigj:

“Dikush më tha: “O Muhammed! Mos rri lakuriq! S'të ka hije ty!” Mirëpo unë s'pashë gjë me sy!”

Dhe kjo na tregon se Zoti nuk u jep rast profetëve të bien në mëkat.

4. PROFETET QE KANE LIBRA

Allahu i Lartë disa profetëve u ka dhënë libra. Kurse disa të tjerëve, vetëm disa fletë. Pastaj profetët ua kanë përcjellë ato njerëzve. Njerëzit që u kanë besuar profetëve dhe shkrimeve të kumtuara prej tyre, janë përpjekur të bëjnë sipas urdhrave të Zotit. Kurse profetët të cilëve nuk u është dhënë gjë, e kanë udhëzuar popullin e tyre sipas librave të dërguar profetëve të mëparshëm.

Katër profetëve u janë dërguar libra të vegjël **prej disa fletësh**, kurse katër të tjerëve, **libra të plotë**. Me kohë, fletët kanë humbur, pra, nuk kanë arritur gjer te ne.

Profetët dhe numri i fletëve dërguar secilit:

Hz. Ademi – 10 fletë.

Hz. Shiti – 50 fletë.

Hz. Idrisi – 30 fletë.

Hz. Ibrahim i – 10 fletë.

Profetët dhe librat dërguar secilit:

Hz. Musai – Teurati.

Hz. Daudi – Zeburi.

Hz. Isai – Ungjilli.

¹⁴ Ismet. Latinisht, inocent. (Shën. i përkthyesit)

Hz. Muhammedi – Kur’ani.

a. Profeti Musa (a.s.)

Hz. Musai është dërguar si profet te të bijtë e Izraelit. Kur Musai u ngarkua me detyrën profetike, të bijtë e Izraelit jetonin në Egjipt nën shtypjen e rëndë të Faraonit.

Pasi iu dha detyra profetike, Hz. Musai i ftoi Faraonin dhe egjiptasit për të besuar Zotin. Faraoni e hodhi poshtë ftesën e Musait. Për më tepër, Faraoni pretendonte të ishte vetë zot. Duke iu kundërvënë pretendimit të Faraonit, Musai tregoi shumë mrekulli për t’i bindur egjiptasit se ishte profet dhe për t’i bërë që t’u besonin parimeve fetare të sjella nga Zoti. Megjithatë, as Faraoni, as egjiptasit nuk i besuan. Veç kësaj, Faraoni e shtoi shtypjen mbi izraelitët dhe Musanë.

Atëherë, Hz. Musai vendosi të largohej nga Egjipti bashkë me njerëzit. Faraoni u vu në dijeni shpejt për daljen e izraelitëve nga qyteti dhe u vu në ndjekje të tyre. Kur Musai me popullin e tij u ndodhën në breg të Detit të Kuq, panë pas shpine ushtrinë e Faraonit. Para kishin vdekjen në ujrat e detit, kurse pas, nën shpatat e ushtrisë së Faraonit! Atëherë, profeti Musa, duke thënë **“Me emrin e Zotit!”**, i ra detit me shkop. Deti u nda më dysh duke u hapur udhë të ikurve. Musai me të bijtë e Izraelit u vunë në udhën e hapur mepërmes ujrave. Edhe Faraoni vazhdoi t’i ndiqte po në atë udhë. Kur Musai me njerëzit e tij kishin dalë në bregun tjetër, Faraoni me ushtrinë ndodheshin në mes të udhës. Atëherë ujrat u bashkuan përsëri duke groposur në gjirin e tyre një ushtri të tërë!

Hz. Musa i çoi njerëzit në vendin e quajtur Ken’an (Kanaan). Në malin Sina Musait iu dha Teurati.

Zoti ynë i Lartë u pati dhënë shumë të mira të bijve të Izraelit, i pati favorizuar me shumë dhunti, por ata u treguan mosmirënjohës. Edhe Zoti, pastaj, u dha shumë dënime, fatkeqësi e shqetësime!

b. Hz. Daudi (a.s.)

Është njëri prej profetëve të dërguar të bijve të Izraelit. Në fillim ai qe sundues mbi popullin e vet. Pastaj iu dha edhe profetësia. Ai qe profet dhe sundues shumë i drejtë.

Profeti Daud qe hekurpunues, kovaç. Ai bënte mburoja e përkrenare me duart e veta.

Hz. Daudit iu dha libri i quajtur Zebur. Kur e këndonte librin me zërin e tij të bukur, rrinin dhe e dëgjonin edhe zogjtë!

Hz. Daudi bënte adhurim të vazhdueshëm. Agjëronte një ditë po e një ditë, jo, gjatë gjithë vitit!

c. Hz. Isai (a.s.)

Hzi. Isai jetonte në Palestinë, në fshatin Nazaret. Në moshën tridhjetë vjeçare i erdhi profetësia. Edhe ai nisi t'i ftonte njerëzit të besonin te një Zot i vetëm.

Ai u pajis me disa aftësi të jashtëzakonshme (mrekulli) si shërimi i verbërisë dhe i disa sëmundjeve të tjera dhe ringjallja e të vdekurve.

Profetit Isa i besuan gjithsej 12 vetë që u quajtën **apostuj** (shokë, pasues, ndihmës).

Atij i është dhënë Ungjilli.

ç. Hzi. Muhammedi (a.s.)

Hzi. Muhammedi është i katërti ndër profetët që u është dhënë libër nga Zoti. Ai është i fundit i profetëve. Ai është udhërrëfyes për gjithë njerëzimin. Profetit Muhammedi është dhënë libri i quajtur Kur'an. Në Kur'an, Allahu i Lartë urdhëron:

“Të dërguarit (profetët) kumtojnë urdhrat e Allahut, frikësohen prej Allahut dhe prej askujt tjetër veç Tij!” (Kur'ani, Ahzab: 39)

“(O Muhammedi!) Edhe shumë të dërguarve para teje u thanë “gënjeshtarë”, por ata i përballuan përgënjeshtimet dhe mundimet gjersa u erdhi ndihma jonë!” (Kur'ani, En'am: 34)

5. PROFETI YNE, HZI. MUHAMMEDI (a.s.)

Para se Profetit tonë t'i vinte detyra profetike, njerëzit ishin larguar nga rruga e së vërtetës. Disa adhuronin, u faleshin idhujve, disa të tjerë, zjarrit dhe yjeve! Edhe librat e shenjtë dërguar profetëve të mëparshëm, nuk qenë ruajtur dot siç qenë. Morali i përgjithshëm ishte prishur. Dhuna dhe padrejtësia kishin marrë formë të përhapur. i forti e shtypte të dobëtin. Ishte shtuar shumë dëshira për pijet dhe bixhozin. Vjedhja dhe grabitja ishin bërë ves. Ja, pra, në një kohë të tillë iu dërgua njerëzve si profet Muhammedi (a.s.)!

Hzi. Muhammedi (a.s.) lindi në Mekë në vitin 571. Nënë ia quanin **Amine**, të atin, **Abdullah**. I ati i pati vdekur para se të lindte. Pak pas lindjes iu dha një mëndeshe me emrin **Halime**. Kjo ishte një grua shumë e varfër. Pranë saj Muhammedi kaloi ditë shumë të lumtura dhe, pas katër vjetëve, u kthye te e ëma. Më vonë, bashkë me nënën, shkuan në Medinë për të vizituar të afërmit dhe varrin e të atit. Në kthim, në rrugë, nëna iu sëmur dhe vdiq. Muhammedi ishte gjashtë vjeç. Ai tashmë kishte mbetur edhe pa nënë!

Pas vdekjes së nënës, Muhammedi e mori pranë i gjyshi, **Abdylmuttalibi**. Dhe, pas dy vjetësh, pas vdekjes së tij, për të nisi të kujdesej i ungji, **Ebu Talibi**. Ebu Talibi dhe e shoqja e donin shumë Muhammedi dhe nuk e ndanin prej fëmijëve të tyre!

Fëmijëria e Profetit tonë kaloi pranë të ungjit. Ai e ndihmonte të ungjin dhe shpesh bënte edhe punën e çobanit. Ai ndryshonte shumë prej fëmijëve të tjerë. Nuk

ndahej nga e drejta! Nuk u falej idhujve. U shkante në ndihmë të gjithëve. Ai kishte fituar besimin e popullit. Prandaj mekasit e patën mbiquajtur “**Muhammed Emin**”, “**Muhammedi i Besueshëm**”!

Në të ri, bashkë me të ungjin, Muhammedi bëri edhe tregti. Në moshën njëzetepesëvjeçare u martua me zonjën **Hatixhe**.

Kur hyri në të dyzetat, Muhammedi nisi të shkante shpesh në shpellën **Hira**. Atje e kalonte kohën duke menduar për Allahun. Një ditë ramazani, ndërsa ndodhej përsëri në shpellë, i erdhi engjëlli i zbulesës, Xhebraili (a.s.) dhe i njoftoi se Allahu i kishte ngarkuar detyrën profetike. Këtë Ai ia tregoi, në kthim, Hz. Hatixhesë. Ajo i besoi në çast profetësisë së tij! Pas saj u bënë muslimanë Hz. Aliu, Hz. Zejdi dhe Hz. Ebu Bekri. Këta quhen **Muslimanët e Parë**.

Më pas, Profeti i ftoi mekasit të bëheshin muslimanë. Disa prej tyre iu përgjigjën ftesës, por shumica nuk i besoi. Për më tepër, idhujtarët filluan t’i mundonin muslimanët. Kur mundimet, torturat, vuajtjet dhe shqetësimet u bënë të padurueshme, Profeti bashkë me ata që i kishin besuar, mërguan për në Medine në vitin 622.

Profeti qëndroi në Medine 10 vjet. Gjatë kësaj periudhe, islami u përhap gjithandej. Mes mekasve dhe muslimanëve u zhvilluan luftërat e Bedrit, Uhudit, Hendekut. Në vitin 630 Profeti hyri në Mekë pa luftë dhe e pastroi Qaben nga idhujt. Pastaj u kthye sërish në Medine. Në vitin 632 shkoi në Mekë për të kryer detyrën e haxhit. Ai vdiq në kthim, **në Medine më 632, në moshën 63-vjeçare**.

Lexim letrar

Profeti ynë, shpëtimtari ynë!

Mendoni një nënë tek sheh se si po e përfshijnë flakët foshnjën e saj... Ç’mund të bëjë, në këtë rast, dashuria e nënës për fëmijën? Ja, pra, shumë herë më e madhe është dashuria e Profetit tonë të dashur për ne, që ai na quan “ummeti im”, “bashkësia ime, njerëzit e mi”!

A doni të shihni se si është përpjekur Profeti ynë për të na treguar ne disa të vërteta që na duhet t’i dimë, dhe për të na paralajmëruar? Po ju jap një shembull. Po t’i lexoni hadithet e tij, domethënë fjalët dhe porositë e tij të bukura, mund të gjeni edhe shumë shembuj të tjerë si ky!

“Një natë, një burrë, për t’u ngrohur, kishte ndezur zjarr. Pas pak, disa flutura dhe insekte kishin filluar t’i vinin rrotull zjarrit e të hidheshin në të duke kujtuar se po fluturonin drejt dritës.

Njeriu ishte shqetësuar dhe, duke lëvizur krahët, ishte përpjekur t’i largonte fluturat.

*Edhe unë, krejt si ai burri, përpiqem t'ju kap për dore që të mos bini në zjarr!
Kurse ju përpiqeni të shpëtoni e të hidheni në zjarr!..”*

Le të mendohemi për këto fjalë të Profetit tonë!

Në se duam ta gjejmë xhennetin e të bëhemi të lumtur, duhet ta lemë veten në duart e tij!

6. DETYRAT TONA PARA PROFETIT

a. Ta duam dhe respektojmë Profetin tonë

Allahu i Lartë urdhëron: **“Besimtarët duhet ta duan Profetin më shumë se jetën e tyre...”** (Kur’ani, Ahzab: 6)

Edhe Profeti ynë ka thënë: *“Askush prej jush nuk ka besuar (plotësisht) në se unë nuk bëhem për të më i dashur se fëmija, se i ati, se të gjithë njerëzit e tjerë!..”* (Buhari, İman, 6-7; Müslim, İman, 70)

Pse, vallë, duhet ta duam Profetin kaq shumë? Sepse, me urdhrat e marra prej Allahut, na ka treguar ne rrugën e drejtë! Është përpjekur t'i shpëtojë nga të këqiat gjithë njerëzit. Ka luftuar me mizorët, ka mbrojtur të dobëtit. Ai është rob dhe i dërguari i fundit i Allahut. Ç'mund të jetë më e natyrshme se të duam një njeri që e do Allahu?

Profeti ynë, të gjithë njerëzit i donte. Por në mënyrë të veçantë dhe më shumë donte dhe i mbronte fëmijët. Ai i pati shpëtuar vajzat e vogla prej groposjes përsëgjalli! Ai thoshte se nuk ka dallim mes djemve dhe vajzave dhe këshillonte të njëjtën sjellje ndaj të dyve. Ndodhia e mëposhtme tregon se sa i ndjeshëm ishte në këtë çështje Profeti ynë.

Një njeri po rrinte pranë Profetit. Në këtë mes, i erdhi i biri. Njeriu e përkëdheli të birin, e puthi dhe e përqafoi. E uli në prehër. Pastaj i erdhi e bija. Njeriu nuk u interesua fort për të bijën dhe i tha të ulej aty pranë. Profeti u prek nga sjellja e burrit dhe e qortoi:

“Pse nuk u solle njëlloj me të dy!”

Të gjitha këto na tregojnë se duhet ta duam Profetin. Por jo vetëm me fjalë! Dashurinë për të duhet ta tregojmë edhe me sjelljet tona! Prandaj:

1. T'i bëjmë ato për të cilat ai thotë **“bëjini”** dhe të mos i bëjmë ato për të cilat ai thotë **“mos i bëni”!**

2. Emrin e tij ta kujtojmë me respekt. Kur kujtohet apo lexohet emri i tij, duhet të themi: **“Alejhisselam”, “Sal’lallahu alejhi vesel’lem”** ose **“Allahumme sal’li ala Muhammedin ve ala ali Muhammed!”**

Për të duhet të themi “Hazreti Muhammedi” ose “Profeti ynë”.

b. T’i mbajmë këshillat, t’i marrim si shembull sjelljet dhe veprimet e tij

Allahu i Lartë urdhëron:

“O njerëz! Pa dyshim, Për ata që shpresojnë të takohen me Allahun dhe Ditën e Gjykimit dhe për ata që e përmendin shumë Allahun, i Dërguari (Profeti) është një shembull i bukur!” (Kur’ani, Ahzab: 21)

Ky ajet na tregon se dashuria për Profetin nuk mund të jetë vetëm me fjalë. Dashuria dhe respekti i vërtetë tregohen duke vepruar si ai dhe duke i mbajtur këshillat e tij!

Profeti do që të kemi respekt për prindërit.

Ndodhia e mëposhtme tregon se sa rëndësi i jep Profeti kësaj.

Një ditë, mes Profetit dhe një njeriu u zhvillua kjo bisedë:

- *O i Dërguari i Allahut, kujt t’i shërbej më shumë?*

- *Nënës!*

- *Pastaj, kujt tjetër?*

- *Nënës!*

- *Po tjetër?*

- *Nënës!*

- *Tjetër?*

- *Babait!*

Edhe ne, po t’i duam nënën dhe babanë, po të sillemi me respekt ndaj tyre, kemi mbajtur dhe vënë në vend këshillën e Profetit. Me këtë sjellje ne tregojmë dashurinë për të!

Profeti ynë ka thënë kështu: *“Janë dy të mira që njerëzit i harrojnë (s’ua dinë vlerën): shëndeti dhe koha e lirë!”* (Buhari, Rikak, 1) Me të vërtetë, ai i jepte shumë rëndësi shëndetit dhe kohën e lirë e shfrytëzonte mirë. Dhe, po ashtu, donte që edhe ne ta vlerësojmë shëndetin dhe ta shfrytëzojmë kohën e lirë. Atëherë, edhe ne duhet ta ruajmë me përparësi shëndetin tonë!

Profeti ynë i pastronte rregullisht dhëmbët me furçën që ata i thoshin *misvak*.¹⁵ “Përdorni *misvak* se *misvaku e mban pastër gojën!*” Kështu na ka porositur ai dhe kështu ka dashur të veprojmë. Edhe ne, le t’i pastrojmë rregullisht dhëmbët dhe ta mbajmë pastër gojën!

Profeti ynë i dashur i lante duart edhe para, edhe pas ngrënies. Edhe ne duhet t’i lajmë duart para dhe pas çdo të ngrëne!

Duhet t’i mbajmë këshillat dhe t’i marrim shembull sjelljet e Profetit edhe në sjelljen me respekt ndaj të mëdhenjve dhe me dhembshuri ndaj të vegjëlve. Ai ka thënë: “*Ai që s’tregon dhembshuri për të vegjlit dhe respekt për të mëdhenjtë, s’është prej tanëve!*” (Tirmidhi) Lidhur me këtë, ai thotë kështu në një hadith tjetër: “*Po qe se një i ri tregon respekt ndaj një plaku për shkak të moshës, edhe Allahu ka për të krijuar (për të nxjerrë në shesh) njerëzit që do t’i shërbejnë atij kur të plaket!*” (Tirmidhi)

Lexim letrar

Profeti ynë s’donte të ngacmonte askënd!

Profeti po ndante ushqime.

Të varfërit i ishin vënë përreth.

Dikush pothuajse i kishte hipur sipër.

Profeti deshi të drejtonte trupin, por s’mundi.

Me shkopin në dorë, i bëri shenjë njeriut:

“Hiq, të ngrihem!”

E kishte gërvishtur pa dashje në fytyrë!

Ia zgjati shkopin njeriut duke i thënë:

“Merre hakun!”

Njeriu e kundërshtoi:

“Jo! S’jam zemëruar!”

Profeti ynë s’donte të ngacmonte, të cënonte askënd!

¹⁵ Misvak: mjet për pastrimin e dhëmbëve i bërë prej drurit të quajtur *Salvadora persica*, fibrat e të cilit hapen duke sajuar një lloj furçe shumë të përshtatshme për pastrimin e dhëmbëve. (Shën. i përkthyesit)

Lexim letrar

Profeti ynë nuk e shihte veten të veçantë prej shokëve

Profeti po udhëtonte bashkë me shokët.

Diku u ulën për të pushuar e për të ngrënë.

Secili mori përsipër një detyrë.

Profeti tha:

“Kurse unë po mbledh shkarpa!”

Shokët e kundërshtuan:

“Ti rri! I bëjmë ne ç’duhen!”

Profeti s’e pranoi dallimin:

“Pse, unë s’kam dallim prej jush! Allahu nuk e do atë që ndahet prej shokësh!”

Lexim letrar

Dashuria e Profetit për fëmijët

Profeti ynë i donte shumë fëmijët dhe nipërit e vet. Njëri prej shokëve të tij, Ebu Hurejre, tregon kështu:

“Profeti kishte ardhur tek ne. Në njërin krah kishte nipin Hasan, në krahun tjetër, nipin Hysen. Herë e puthte njërin, herë tjetrin. Njëri prej të pranishmëve e pyeti:

- O i Dërguari i Allahut, a i do shumë ata?

- *Kush i do ata, më do edhe mua; kush nuk i do ata, është njëlloj sikur tregon armiqësi ndaj meje!*

Një ditë tjetër, kur Profeti e puthi të nipin Hasan, Akra bin Habis që ndodhej aty, i tha:

- Unë kam dhjetë fëmijë, por asnjërin s’e kam puthur gjer më sot!

Profeti iu përgjigj:

- *Kujt nuk tregon mëshirë për njerëzit, edhe Allahu nuk i tregon mëshirë!*

Dikush kish shkuar te Profeti së bashku me të birin. Në atë mes, kish nisur ta puthte të birin. Profeti e kish parë me vërejtje dhe e kishte pyetur:

- A të dhimbset?

- Po! - I ishte përgjigjur njeriu.

Atëherë, Profeti i kish thënë:

- *Për shkak të dhembshurisë tënde për fëmijën, edhe ti je i denjë për mëshirën e Allahut, sepse Allahu është më i mëshirshmi i të mëshirshmëve!*

Kur Profeti takohej në rrugë me fëmijët, i përshëndeste, u jepte ndonjë gjë për të ngrënë, i merrte në prehër, i përqafonte, i hipte në deve për t'i kënaqur. Ai u tregonte dashuri jo vetëm fëmijëve muslimanë, por të gjithë fëmijëve!

Gjatë një lufte ishin vrarë edhe fëmijë të ndodhur mes dy anëve. Ata që e panë se sa thellë ishte prekur Profeti, për ta ngushëlluar, i thanë:

- E pse po mërziteni kaq shumë? Fundja, ata s'janë fëmijë muslimanësh!

Profeti kundërveproi ashpër:

- Edhe sikur fëmijë qafirësh (mohuesish) të jenë, janë shumë më të mirë se ju! Kujdes! Të mos i vrisni fëmijët! Fëmijët të mos vriten!"

7. KREU “KAFIRUN” DHE KUPTIMI I TIJ

قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ (۱) لَا أَعْبُدُ مَا تَعْبُدُونَ (۲) وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ (۳)
وَلَا أَنَا عَابِدٌ مَّا عَبَدْتُمْ (۴) وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ (۵) لَكُمْ دِينُكُمْ
وَلِيَ دِينِ (۶)

Kuptimi: “Thuaj: “O ju mohues! Unë nuk adhuroj atë që adhuroni ju. As ju nuk adhuroni atë që adhuroj unë! Por edhe unë kurrë nuk do të adhuroj atë që adhuroni ju! As ju nuk do të adhuroni atë që adhuroj unë! Feja juaj ju përket juve e, feja ime, mua!”

PERMBLEDHJE

1. Ç’është profetësia? Kush quhet profet?
2. Ç’është feja?
3. Përse Allahu i Lartë ka dërguar profetë?
4. Ç’u kanë mësuar profetët njerëzve?
5. Cilëve profetë dhe cilat libra u janë zbritur?
6. Jepni të dhëna mbi Hz. Musanë.
7. Jepni të dhëna mbi Hz. Daudin.
8. Jepni të dhëna mbi Hz. Isanë.
9. Jepni të dhëna mbi profetësinë e Hz. Muhammedit (a.s.).
10. Pse dhe si duhet ta duam dhe respektojmë Profetin tonë?
11. Tregoni rëndësinë e mbajtjes së këshillave të Profetit tonë.
12. Thoni dy nga fjalët ose këshillat e Profetit tonë

PJESA V

I BESOJ DITES SE RINGJALLJES

ÇESHTJET

1. DITA E RINGJALLJES
2. XHENNETI DHE XHEHENNEMI
3. NDIKIMI I BESIMIT NE RINGJALLJEN MBI JETEN TONE TE PERDITSHME
 - a. Në mendimet tona
 - b. Në sjellje dhe veprime
 - c. Në marrëdhëniet me të tjerët
4. KREU “NASR” DHE KUPTIMI I TIJ

PUNE PERGATITORE

1. Ç'mund të jenë ndikimet pozitive të besimit për ringjalljen mbi sjelljet tona?
2. Ç'ju ngjallin në mendje fjalët “xhennet” dhe “xhehennem”?

1. DITA E RINGJALLJES

Një tjetër prej parimeve tona besimore është edhe besimi te dita e ringjalljes. Sipas besimit tonë, me ditën e kiametit, shembjes së plotë të kësaj bote, nis jeta tjetër, e pasosur, që quhet **ahiret**, domethënë, **e pasme**.

Jeta e pasme, pra, nis me shpërthimin e **kiametit**. Shpërthimin e kiametit e lajmëron engjëlli Israfil duke i rënë borisë së quajtur **“sur”**. Me rënien e borisë merr fund jeta e kësaj bote.

Kur të shpërthejë **kiameti**, të gjithë njerëzit do të vdesin. Rregulli i botës e i gjithësisë, që shohim sot, do të ndërrojë. Pas një farë kohe, Israfil do t'i bjerë borisë për të dytën herë. Atëherë, të gjithë njerëzit që kanë jetuar në tokë qysh nga njeriu i parë e gjer në ditën e kiametit, do të ringjallen. Kësaj i thonë, ashtu siç thuhet edhe në lutjen **“Amentu”, “ba’thu ba’de’l-mevt”, “ringjallja pas vdekjes”**.

Njerëzit e ringjallur do të mblidhen në vendin e quajtur **“mahsher”, “grumbullimi”**, ku do t'i japin llogari Zotit për jetën e tyre në këtë botë. Aty, çdo njeriu do t'i jepet në dorë një fletore ku njerëzit do të shohin me habi të shkruara edhe të mirat ose të këqijat më të imta të bëra prej tyre në këtë jetë. Aty do të vihet në vend drejtësia e Allahut dhe, më në fund, të mirët do të hyjnë në xhennet, kurse të këqinjët, në xhehennem. Në xhennet do të ketë bukuri të pasosura, kurse në xhehennem, vuajtje e shqetësime.

“... dhe përgëzoji ata që kanë bërë punë të mira e të dobishme për xhennete me lumenj që rrjedhin poshtë tyre...” (Kur’ani, Bakara: 25)

A ringjallen eshtrat e kalbura?

Pyesin: **“A vërtet do të ringjallemi pas vdekje, pasi të jemi kthyer në një grusht eshtrash, në një grusht dhé?”**

“Thuaj: “Bëhuni, po deshët, gur, bëhuni hekur ose një gjë më e fortë se to, prapëseprapë do të kalbeni dhe, pastaj, do të ngjalleni sërish!” (Kur’ani, Isra: 50-51)

Pyesin: **“Kush ka për të na ringjallur ne?”**

“Thuaj: “Ka për t’ju ringjallur Allahu, ai që ju ka krijuar së pari!” (Kur’ani, Isra: 51)

Pyesin: **“Mirë, po kur do të bëhet kjo?”**

“Thuaj: “Ndoshta së afërmi! Atë ditë kur t’ju thërresë Allahu, do t’i përgjigjeni thirrjes së Tij dhe do të pandehni se keni ndejtur vetëm për pak kohë ndër varre!” (Kur’ani, Isra, 49-52)

Lexim letrar

Jeta e pasosur

Ishte një ditë vjeshte.

Drurët që ua lëshonin gjethet e zverdhura një e nga një erërave të stinës, ishin gjysmë lakuriq.

Duke i vënë veshin kërcitjes së lehtë fëshfëritëse të gjetheve verdhacuke që shtypeshin e ngjisheshin nën këmbët e tij, Mehmeti po çapitej drejt Pesë Pishave.

Mehmeti kujtoi me hidhërim ditët kur kalonin po nëpër këtë rrugë duke luajtur e qeshur me shokun e vet, Samiun, të cilin, një javë më parë ia kishin lënë amanet tokës mëmë! Një dhimbje e thellë iu ngul si thikë në zemër. Sytë iu veshën. Në Pesë Pishat e ndjeu veten krejt të vetmuar!

Shumë herë kishin besiduar me Samiun këtu mbi jetën e re e të pasosur që niste me vdekjen...

Sytë bojqielli të Mehmetit u drejtuan kah qiejt blu dhe nga buzët iu derdhën këto fjalë:

“Zoti im i Lartë! Shoku im, Samiu, i besonte jetës së pasosur!

Ai e besonte se, pas vdekjes, do të niste jeta e varrit ku, së pari, engjëjt **Mynker** dhe **Nekir** do ta pyesin njeriun: “**Cili është Zoti yt? Cila është feja jote? Si e quajnë profetin tënd?**” Bashkë me Samiun, pastaj, përsërisnim: “**Zoti im është Allahu, feja ime është islami, profeti im është Muhammedi** (a.s.)!

Samiu e besonte se kiameti do të nisë me rënien e borisë nga **Israfili**, se çdo gjë do të shkatërrohet, se, pas një kohe, Israfili do t'i bjerë, me lejen Tënde, për herë të dytë borisë dhe të gjithë njerëzit do të ringjallen ashtu siç çelin lulet në pranverë, do të ngrihen nga varret e do të mblidhen në **sheshin e grumbullimit** të quajtur “**mahsher**” për të dhënë para Teje llogari!

Ai e besonte se, gjatë jetës sonë në këtë botë, mirësitë dhe mëkatet tona shkruhen nga **engjëjt shkrues** në **Fletoren e Punëve** që do t'i jepet secilit në vendgrumbullimin e llogarisë. Shumë herë me Samiun të jemi lutur kështu, o Zot: “**Allahu ynë! Bëna ne nga robtë e tu të mirë që u jepet Fletorja e Punëve nga e djathta! Mos na e jep Fletorën e Punëve nga e majta, o Zot!**”

Shoku im besonte se të mirat dhe të këqijat do të peshohen në **peshoren** që vetëm Ti e di se si do të jetë! Pastaj, njerëzit do të kalojnë nëpër **urën** e quajtur “**sirat**”; të mirët do të kalojnë me shpejtësi dhe do të hyjnë në xhennet, kurse të këqinjët nuk do të kalojnë dot e do të rrokullisen në xhehennem. Bashkë me të të jemi lutur Ty: “**Jepna xhennetin, o Zot, bëna prej njerëzve të lumtur që do të të shohin Ty!**”

Shoku im besonte se vdekja është fillimi i jetës së pasosur, prandaj nuk kishte frikë nga vdekja! Ai kishte mall për xhennetin dhe zili për begatitë e Tua atje. **Allahu im! Ki mëshirë për të, bëja varrin si lulishte xhenneti!**

Dhe Mehmeti tha “**amin, ashtu qoftë!**” dhe i fërkoi sytë me duart që ishte lutur!

Atëherë ndjeu se i qenë larguar krejt dhimbja e hidhërimi që ia kishin ndrydhur gjoksin, që ia kishin shpuar zemrën pak më parë!

Duke u kthyer nga erdhi, Mehmeti mendonte: “**Sa bukur është të bashkohesh edhe një herë në xhennet me shokët dhe miqtë e ndarë!**”

2. XHENNETI DHE XHEHENNEMI

Xhenneti

Xhennet quhet vendi ku të vdekurit si besimtarë dhe muslimanë do të qëndrojnë pas ringjalljes përgjithmonë.

Në xhennet nuk ka vdekje. Jeta s’ka mbarim. Atje ndodhen të gjitha të mirat. Atje s’ka mërzitje e hidhërim, urrejtje e neveri, por vetëm gëzim e lumuri!

Të mirat e xhennetit, të ngrënat e të pirat janë të bukura përtej asaj që mund t’u shkojë njerëzve në mend. Ato nuk u ngjasin të mirave të tokës!

Banorët e xhennetit do të jetojnë nëpër pallate, poshtë të cilave rrjedhin lumenj dhe do të hanë prej çdo lloj fruti.

Ata njerëz të lumtur që do të fitojnë të drejtën për të hyrë në xhennet, do të kenë mundësi ta shohin Zotin. Lidhur me këtë, Profeti ynë ka thënë:

“Pa dyshim, ju do ta shihni me sy Zotin tuaj ashtu siç shihni këtë hënë që ndriçon! Për këtë nuk do t’ju bëhet padrejtësi, nuk do të grindeni me kënd!” (Buhari-Myslim)

Shikimi i Allahut do të jetë, për fituesit e xhennetit, dhuntia më e madhe, shpërblimi më i madh!

Xhehennemi

Xhehennemi do të jetë vendi i mohuesve të Allahut dhe i njerëzve të këqinj!

Aty s'ka bukuri si në xhennet. Në vend të ujit të ftohtë ka gjak, ka ujra që vlojnë. Në xhehennem nuk ka freski; edhe hijet do të jenë të nxehta e turbulluese. Njerëzit e atyshëm do të dëshirojnë më shumë ose të vdesin, ose të kthehen sërish në botë. Por as vdekje do të ketë, as lejë për t'u kthyer në botë për të bërë punë të mira! Fituesit e xhehennemit do të heqin vuajtje e mundime, do vuajnë dënimin e të këqijave të bëra në botë! Ata që kanë edhe një thërrime besim në zemër, pas mbarimit të dënimit në xhehennem, do të hyjnë në xhennet.

Askush prej nesh nuk do që të hyjë në xhehennem. Për këtë duhet që njeriu të jetë besimtar dhe të bëjë punë të mira e të dobishme! Vetëm këshku fitohet kënaqësia e Allahut. Mund të kemi bërë gabim, mund të kemi bërë mëkat. Në këto kushte, duhet të pendohemi e të bëjmë pendesë. Allahu i Lartë e pranon pendesën! Ai është mëshirues e bamirës!

Lexim letrar

Endrra e Ahmetit

- Ahmet! Ahmet!

- ... ëëë...

- Ahmet, ngreu, o bir! Ngreu, ngreu! Ke për të mbetur vonë për në shkollë!

E ëma po e vështronte me vëmendje. Ahmeti buzëqeshte... por sytë i kishte ende të mbyllura. S'po ngrihej që s'po ngrihej! E ëma vazhdoi ta vështronte të birin me dhembshuri... Pastaj i foli sërish, por, tashmë, edhe me përkëdhelje, edhe me qortim:

- Ah, ti, mistrec!.. Bën sikur po fle! Prit pa më sheh tani!..

Ahmeti u ngrit ndenjurr:

- Oh, nënë, mos!... Pse ma prishe gjumin?

- Ç' "pse", more? Do të mbetesh vonë për në shkollë! Eja, shpejto! Mëngjesin e ke gati! Eja, bëj "Bismilah" dhe ngreu!

- Eh, sikur të kisha fjetur edhe ca! Ç'ëndërr e bukur që qe!

- Të pastë qenë e mbarë, o bir! Po ç'ëndërr po shihje?

- A s'më pate thënë mbrëmë, para se të bija, që t'i lutesha Zotit?

- Po! Pastaj?

- Edhe unë, ashtu bëra! Pastaj pashë një ëndërr të bukur!

- A do të ma tregosh?

- Do të ta tregoj, po... Po as unë s'e di se si të ta tregoj! Jam aq i lumtur sa... Hiç të mos isha zgjuar, më mirë do të ishte... Të vazhdoja të flija duke parë ëndërr...

- Tani vërtet më bëre kureshtarë! Eja, ma trego!

- Do të ta tregoj, po nuk do të qeshësh me mua, mirë?

- Të jap fjalën, nuk do të qesh!

Ahmeti ende ishte nën ndikimin e ëndrrës. Nga fytyra ende nuk i ishin fshirë shenjat e lumturisë. U përqëndrua dhe nisi të tregonte:

- Hë, në fillim sikur më erdhën dy vetë. Nuk e di si ishin, nuk dukeshin, por unë e ndieja se ishin aty. Më thanë: "Eja, o djalë i mirë, eja se kemi ardhur për të të marrë!..

U ngrita menjëherë nga shtrati. Megjithëse nuk e dija se kush ishin dhe ku do të më çonin, dola nga shtëpia bashkë me ta. Më kishte pushtuar një kënaqësi dhe siguri e madhe! Më kapën për krahësh dhe sikur fluturova drejt qiejve! Pas një farë kohe arritëm në një vend shumë të bukur. "Këtu do të jetosh ti - më thanë - e ke bërë hak të jetosh këtu!"

Pashë djathtas e majtas dhe u habita. Kurrë s'kisha parë një vend të tillë! Pallate e vila dhe poshtë tyre lumenj që rridhnin! Kishte të ngrëna e të pira nga të gjitha llojet. Gjithkush hante ç't'i donrte zemra! Njerëzit dukeshin shumë të lumtur. E përshëndesnin dhe e pyesnin njëri-tjetrin me shumë mirësi. Askush nuk zemërohej me tjetrin, përkundrazi, silleshim me shumë brishtësi dhe hijeshi! Kudo ishte gjelbërim. Zogjtë këndonin pa prà. Ujrat e pastra si kristal rridhnin me një shushërimë shumë të këndshme. Duke parë ujin, ndjeva se më kish marrë etja. Kur ja tek m'u zgjat një gotë ujë! E mora dhe, duke thënë "Bismil'lah!", nisa të pi. Nga brenda ndieva prehje, ndieva qetësi...

"Ç'ishte kjo?" - Pyeta.

"Ishte sherbet", - më thanë - "ta dha Allahu!"

"Mirë, po ç'është ky vend?" - Pyeta.

"Xhenneti!" - Më thanë.

"E pse erdha unë këtu, përse më sollën këtu?" - I pyeta.

“Sepse je djalë i mirë! Sepse i beson Zotit, ua dëgjon fjalën prindërve, u bën të mira të tjerëve... Prandaj të sollën këtu!”

- A e di, nënë? Ç’vend i bukur që ishte! As kopshteve të fshatit tonë u ngjante, as vendeve ku bëjmë piknik, as vilave verore! Eh, sikur të mos më kishe zgjuar e të rrija edhe ca atje!..

Lexim letrar

Fqinji i xhennetit

Një herë e një kohë, një mbret kishte dalë të përsillej nëpër qytet. Kishte ndërruar veshjen që të mos e njihnin si dhe kishte marrë me vete vetëm një shërbëtor. Kishte dashur të dinte se ç’mendonte populli për të!

Ishte dimër. I ftohti të priste.

Rruga i çoi në një faltore.

Dy të varfër po dridheshin në një qoshe. S’kishin se ku të shkonin!

Mbreti u bë kureshtar të dinte se ç’po bisedonin dhe u afrua.

Njëri prej të varfërve, i cili ishte edhe shakaxhi, po ankohej prej të ftohtit:

“Nesër, kur të hyjmë në xhennet, nuk do ta le mbretin të hyjë! Po ta shoh se po afrohet te muri i xhennetit, do t’ia këpus me këpucë kokës!”

Shoku e pyeti:

“E pse s’do ta lësh të hyjë?”

“Kjo s’do shumë mënd! Ndërsa ne dridhemi këtu nga të ftohtit, ai bën qejf në pallat! Dhe nuk pyet fare për ne! E pas kësaj? Të më bëhet fqi në xhennet, ë? Kështu fqinji s’dua unë, o vëlla!”

Që të dy qeshën.

Mbreti e porositi shërbëtorin:

“Mos i harro këtë faltore dhe këta njerëz!”

Dhe u kthyen të dy në pallat.

Pastaj mbreti dërgoi njerëzit e tij e i solli dy shokët e varfër në pallat. Ndërsa këta prisnin me frikë se ç'mund t'u binte kokës, i futën në një dhomë të shtruar për bukuri dhe u thanë:

“Ju do të banoni këtu, do të hani e do të pini, do të luteni për mbretin dhe nuk do të bëheni pengesë që të hyjë në xhennet!”

Ç'njeri zemërmirë që na paskësh qenë mbreti, apo jo!

Profeti ynë i ka lavdëruar kështu ata që u ndihmojnë nevojtarëve:

“Atë që shpëton një besimtar prej halleve të kësaj bote, Allahu e shpëton prej halleve të jetës tjetër!”

Lexim letrar

Xhenneti dhe xhehennemi

Zoti ynë i Lartë i përshkruan kështu kiametin, xhennetin dhe xhehennemin si dhe gjendjen e atyre që do të hyjnë atje:

“Dhe i fryhet Surit dhe bien të vdekur që të gjithë ata që janë në qiej e në tokë veç atyre që i veçon Allahu; pastaj i fryhet përsëdyti dhe ja tek ngrihen që të gjithë në këmbë e presin!

Toka ndriçohet me dritën e Zotit, hapet libri, sillen profetët dhe dëshmitarët dhe gjykohet mbi ta pa iu bërë padrejtësi!

Dhe secili merr përgjegjësen e punës së vet; Allahu e di fare mirë se ç'kanë bërë ata!

Mohuesit sillen grupe-grupe për në xhehennem. Kur arrijnë aty, portat hapen dhe rojat u thonë: “A nuk ju erdhën juve të dërguar që t’ju lexojnë ajetet e Zotit tuaj e t’ju kujtojnë se do të vijë kjo ditë?” “Po!” - thonë ata, por ndëshkimi i mohuesve tashmë ka filluar!

Dhe u thuhet: “Hyni nëpër dyert e xhehennemit ku do të mbeteni përgjithmonë! Ç’vend i keq është për kryeneçët!”

Dhe ata që u treguan të bindur ndaj Zotit të tyre, sillen grupe-grupe për në xhennet dhe, kur arrijnë te portat i gjejnë çelur dhe rojet i mirëseardhin duke u thënë: “Selamu alejkum, paqe juve! Hyni këtu përgjithmonë!”

Dhe ata thonë: “Lavdi Allahut i cili e mbajti fjalën dhe na bëri ne trashëgimtarë të këtij vendi! Ç’i bukur paska qenë shpërblimi i punëmirëve!”

Dhe do t’i shohin engjëjt të vënë rreth Arshit duke e falenderuar e duke i thurur lavdi Zotit! Më së fundi, mbi njerëzit është vendosur me drejtësi dhe ata të gjithë thonë: “Lavdia dhe falenderimi i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve!”

(Kur’ani, Zumer: 68-75)

Lexim letrar

Ilahi¹⁶

Këta lumenjtë e këtij xhenneti
Rrjedhin *Allah! Allah!* duke thërritur;
Bilbilat islamë kanë dalë një nga një,
la thonë *Allah! Allah!* duke thërritur...

Degët e Tubas tunden anëmbanë,
Me gjuhën e vet këndojnë Kur’an;
Trëndafilat e xhennetit të gjithë sa janë,
Aromë përhapin *Allah!* duke thërritur...

Trungjet e pemëve me nur ndriçuar,
Gjethet prej argjendi punuar,
Degët zgjaten me fruta ngarkuar,
Piqen e krenohen *Allah!* duke thërritur...

Fytyrat i kanë si hënë e larë,
Fjalët, të ëmbla i kanë, si sheqer
Vajzat-hyri, të nurshme përherë,
Shëtisin me *Allah!* në gojë duke thërritur...

Kush pas Zotit është dashuruar,
Lotët i shkojnë me mall të trazuar;
Me nur jashtë e brenda veshur e qarkuar,
Me *Allah!* në gojë përherë duke thërritur...

Shko te i Dashuri, Junus Emré,
Punën e sotme për nesër mos e lé;
Kur t’i dal Zotit para atjé,
Me emrin e Tij në gojë, *Allah!* duke thërritur!..

¹⁶ Fragment nga ilahija e poetit kombëtar turk, Junus Emré (shek. XIII-XIV)

3. NDIKIMI I BESIMIT NE RINGJALLJEN MBI JETEN TONE TE PERDITSHME

a. Në mendimet tona

Besimi mbi ringjalljen dhe jetën e pasme i përfton njeriut një mendim të qartë. Edhe zemra i kthjellohet pastaj. Mendja dhe zemra i mbushen me mendime dhe prireje të mira e të bukura. E kështu, njeriu me zemër të pastër në saje të besimit për jetën e pasosur, kudo bën të mira dhe kurdoherë ruhet prej të keqes.

Allahu i Lartë urdhëron:

“Pa dyshim, Allahu di për çdo të mirë që bëni!..” (Kur’ani, Bakara: 215)

**“Kush të ketë bërë një të mirë sa grimca, do ta marrë përgjegjësen e saj!
Edhe kush të ketë bërë një të keqe sa grimca, do ta marrë përgjegjësen e saj!”**
(Kur’ani, Zilzal: 7-8)

Me ç’kuptojmë prej ajeteve dhe haditheve dhe të ngjashmeve me to, ne do të mbajmë përgjegjësi për të gjitha thëniet dhe veprimet tona. Pas ringjalljes do të japim llogari! Një musliman duhet ta besojë këtë pa tjetër. Gjërat e mira ose të këqia i mendojmë një herë, pastaj i bëjmë. Ata që e dinë se në jetën tjetër do të japin llogari, jo që s’bëjnë të këqia, por as që duan të mendojnë për to! Përkundrazi, ata e mbushin mendjen me mendime të bukura dhe zemrën me ndjenja të bukura me qëllimin për të bërë vetëm gjëra të mira e të bukura! Sepse e dinë se nga mendimet dhe ndjenjat e bukura, atyre vetë si dhe njerëzve të tjerë mund t’u vinë vetëm të mira e dobi!

b. Në sjellje dhe veprime

Sipas besimit tonë, çdo njeri do të japë llogari për bëmat e tij në këtë botë. Njerëzit nuk janë qenie të lëshuara në këtë botë pa përgjegjësi. Allahu i Lartë i ka dhënë secilit një detyrë dhe i ka ngarkuar përgjegjësi. Ajo që na bie ne, është ta çojmë në vend detyrën tonë! Duke menduar se jemi përgjegjës para Zotit, t’i mbajmë nën kontroll sjelljet dhe veprimet tona.

Disa njerëz, kur janë pranë të tjerëve, thonë gjëra të mira dhe sillen drejt, por, kur mbeten vetëm, nuk druhen të bëjnë gjëra të gabuara. Ata pandehin se s’i sheh kush. Mirëpo është Allahu që i sheh, ndërkaq që **engjëjt shkrues** mbajnë shënim çdo veprim të hapur a të fshehtë!

Atëherë, njerëzit që u besojnë Allahut dhe ditës së ringjalljes dhe llogarisë, kur flasin, ose të thonë fjalë të mira, ose të heshtin! Edhe në punë dhe sjellje të parapëlqejnë ato të drejtat e të dobishmet!

Ç’është e vërteta, shumica e njerëzve qysh në këtë botë e marrin shpërblimin e fjalëve dhe veprimeve të mira si dhe ndëshkimin e fjalëve dhe veprimeve të këqia. Por, po të mos ndodhë këtu, kjo gjë do t’u ndodhë pa tjetër në jetën tjetër!

Ne, si njerëz që u besojmë Allahut dhe ditës së ringjalljes dhe llogarisë, duhet t’u kushtojmë shumë kujdes fjalëve e shprehjeve tona. Duhet të sillemi kurdoherë drejt e me ndershmëri. Veprat duhet t’i kemi si fjalët!

c. Në marrëdhëniet me të tjerët

Njerëzit janë në marrëdhënie të përhershme me njëri-tjetrin. Ecuria e mirë e këtyre marrëdhënieve është shumë e rëndësishme për formimin e një shoqërie të shëndoshë. Shoqëritë e përbëra prej individësh që shkojnë mirë me njëri-tjetrin, janë të qeta e të lumtura. Ndarja e punës në shoqëri të tilla është e lehtë. Problemet që mund të dalin, zgjidhen shpejt.

Edhe besimi te jeta tjetër na prir ne për të ndërtuar marrëdhënie të mira me mjedisin. Si rrjedhojë e besimit se në jetën tjetër kemi për të dhënë llogari për bëmat tona në këtë jetë, nuk themi fjalë të këqia, nuk bëjmë punë të keqe, ruhem prej gënjeshtërs dhe dredhisë, nuk mbajmë mëri dhe nuk marrim shpagim, nuk mashtrojmë kënd, kalojmë mirë me shokët dhe fqinjët, u ndihmojmë të papasurve, sillemi me drejtësi e ndershmëri kudo!

Lexim letrar

Lutje

Zoti ynë! Mos na i shtrembëro zemrat pasi na drejtove, na dhuro mëshirën tënde! Pa dyshim, Ti je dhurues i madh!

Zoti ynë! Ti je Ai që do t'i mbledhësh njerëzit në një ditë për të cilën s'mund të ketë dyshim! Pa dyshim, Allahu nuk lëviz nga fjala!"
(Kur'ani, Al-i Imran: 8-9)

Lexim letrar

Shqetësimi i Ibrahimit

Duke dalë nga mësimi, Ibrahimit vuri re se nga çanta e Selmës ranë lekë. Por asaj s'i tha gjë dhe priti gjersa dolën jashtë të gjithë. Sapo klasa u zbraz, i mori lekët e rëna për tokë dhe i futi në xhep me nxitim që të mos e shihte kush. Mirëpo qysh në atë çast e zuri një shqetësim.

Pas pak ra zilja. Të gjithë nxënësit hynë brenda. Pastaj erdhi dhe mësuesi dhe mësimi filloi. Por mendja e Ibrahimit punonte vetëm te lekët e Selmës! Nuk po përqëndrohej dot për ta dëgjuar mësimin! Ibrahimit mendonte: "Po sikur ta marrin vesh se i kam marrë unë lekët?" Dhe shqetësimi i shtohet!

Një çast dhe vemendjen ia tërhoqi fjala e mësuesit mbi besimin për ditën e ringjalljes dhe llogarisë. Ai po thoshte se, pa dyshim, njerëzit do të jepnin llogari për bëmat e tyre në këtë botë. Atëherë Ibrahimit u shqetësua me të vërtetë. Nuk po e mbante vendi!

Ibrahimi nisi të mendonte me padurim: “Ah, sikur të mbaronte një çast e më parë ky mësim, t’ia jepja lekët Selmës e të shpëtoja! Më në fund, pas gjithatyre minutave të shqetësuar që dukej sikur s’do të kishin kurrë mbarim, zilja ra. Ibrahimi u emocionua.

Kur të tjerët po dilnin, ai i pëshpëriti me një zë të dridhur vajzës:

- Selma! Këto lekë të patën rënë pushimin e kaluar. Unë i mora, por nuk munda të t’i jepja menjëherë. Më fal!

Selma e falenderoi Ibrahimin. Kurse ai e falenderoi Zotin që shpëtoi nga një ankth i tillë. Njëkohësisht kuptoi se ç’ndikim të madh paska mbi njeriun besimi mbi ringjalljen dhe llogarinë! Ai i dha fjalën vetes se kurrë më s’do t’i ndodhte një gjë e tillë!

4. KREU “NASR” DHE KUPTIMI I TIJ

إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ (١) وَرَأَيْتَ النَّاسَ يَدْخُلُونَ فِي دِينِ اللَّهِ أَفْوَاجًا (٢) فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَاسْتَغْفِرْهُ إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا (٣)

Kuptimi: “Kur erdhi ndihma e Allahut dhe fitorja dhe i pe njerëzit të hyjnë tufa-tufa në fenë e Allahut, falenderoje Zotin tënd dhe kërkoi falje se Ai është falës i madh!”

PERMBLEDHJE

1. Çdo të thotë “ringjallje”?
2. Çdo të thotë “ditë e llogarisë”
3. Ç’vend është xhenneti? Jepni të dhëna.
4. Pse do të ndëshkohen në jetën tjetër ata që bëjnë të këqia në këtë botë?
5. Si ndikon mbi mendimet tona besimi te ringjallja?
6. Si ndikon mbi sjelljet dhe veprimet tona besimi te ringjallja?
7. Si ndikon mbi marrëdhëniet tona me të tjerët besimi te ringjallja?

PJESA VI
I BESOJ KADERIT

ÇESHTJET

1. KADERI
2. Ç'ESHTË KAZAJA
3. RENDESIA QE I JEPET PUNES NE ISLAM
 - a. Puna është adhurim
 - b. Allahu i do ata që punojnë
 - c. Kush i ka dy ditë një lloj, është në humbje
4. KREU "LEHEB" DHE KUPTIMI I TIJ

PUNE PERGATITORE

1. Keni dëgjuar për fjalët "kader", "fat", "e shkruar në ballë". Pyetni më të mëdhenjtë për kuptimin e tyre dhe mësojini.
2. Profeti ynë i dashur ka thënë: "*Kush i ka dy ditë një lloj, është në humbje!*" Ç'kuptoni me këtë fjalë? Shkruajeni në fletore.
3. Kërkoni të dini për rëndësinë që i jep feja jonë punës. Ajetet dhe fjalët e Profetit që mund të gjeni mbi këtë çështje, i shkruani në fletore.

1. KADERI

Njohja dhe caktimi nga ana e Allahut qysh më parë i çdo gjëje që ka ndodhur dhe do të ndodhë në botë, quhet **kader**.

Allahu i Lartë i di ato që kanë ndodhur në të shkuarën, që ndodhin sot dhe që do të ndodhin në të ardhmen. Dituria e Tij ka mbështjellë gjithçka. Asgjë s'mund të ndodhë jashtë dijes së Tij. Allahu i Lartë di për një njeri se nga ç'prindër dhe në ç'vend të botës do të lindë. Po ashtu edhe se ku do të jetojë dhe kur do të vdesë. Këto çështje të posaçme të paracaktuara me anë të dijes së pafundme të Allahut të Lartë përbëjnë kaderin e atij njeriu.

Në këtë kuptim, të gjithë njerëzit dhe çdo gjë në gjithësi ka kaderin e vet.

Për shembull, le të mendojmë një farë molle. Një ditë, kjo farë bie në tokë. Atje mbin, nxjerr filiz, rritet dhe bëhet një dru i madh. Pastaj fillon të japë fruta. Me diturinë e Tij të pafundme, Allahu i Lartë të gjitha këto i di. Me këtë dituri Ai e cakton qysh më parë se ç'dru do të dalë nga ajo farë dhe ku. Ja, pra, ky caktim qysh më parë ose *paracaktim*, është *kaderi* i asaj peme molle. Në këtë kuptim, të gjitha pemët, bimët, kafshët, njerëzit, etj. që ndodhen në gjithësi, kanë secili kaderin e vet!

Lexim letrar

Kaderi i Enisit

Një ditë, Enisi po bënte detyrat në shtëpi. E ëma e i ati po bisedonin mes tyre. Enisi s'e kishte mendjen aty. Një çast dhe dëgjoji të atin të thoshte:

- Kaderi i Zotit, grua, kaderi i Zotit... Ç'të bësh, kështu paska qenë e shkruar!

Vëmendja e Enisit u përqëndrua menjëherë në këto fjalë. U kthye nga i ati dhe e pyeti:

- Baba, ç'the ashtu?

- Ç'të tërhoqi vëmendjen, "e shkruara" apo "kaderi"?

- Të dyja!

- Ç'të duhen? E ke të vështirë për t'i kuptuar!

- O baba, po unë ka kohë që po merrem me këto, ky është mësimi që kemi për nesër, po s'po e kuptoj dot!

- Ma jep librin ta shoh edhe unë, - i tha i ati.

Enisi ia dha librin të atit. Ai e lexoi me kujdes shpjegimin e këtyre fjalëve. U mendua pak, pastaj i tha të birit:

- Po, o bir, shpjegim më të qartë se ky për kaderin dhe kazanë, s'ka. Vështirësia jote për t'i kuptuar këto fjalë, nuk vjen nga që i ngatërron me njëra-tjetrën, por nga që janë abstrakte e të vështira për t'i kuptuar.

- Mirë, po si do ta mësoj këtë mësim? Në punën përgatitore të këtij kapitulli na kërkohet të pyesim të mëdhenjtë mbi kuptimin e fjalëve "kader" dhe "e shkruar". Mësuesi na porositi t'i mësojmë këto dhe të shkojmë në mësim të përgatitur. Unë në fillim pashë në libër se ç'është shkruar për to, por s'munda të kuptoja sa duhet.

I ati i Enisit mendoi pak, pastaj i tha:

- Enis, në fillim na e sill kalendarin e murit ta shohim. Ja, më thuaj, ç'ditë është sot?

- E diel.

- Mirë, po pse s'shkove sot në shkollë?

- Pse është e diel! A s'janë të dielat pushim?

- Po nesër, ç'ditë do të jetë?

- E hënë. Nesër unë do të shkoj në shkollë. Kurse ti, në punë.

- Mirë, po pse nuk shkuam ne sot, ti në shkollë e unë në punë, po nesër?

Enisi po dukej si i hutuar. Pa nga i ati sikur do t'i thoshte: "Pyetje është kjo?" Por vetëm sa e kundërshtoi:

- O baba, po...

- Enis! Do të të pyes diçka tjetër. Ti nuk shkove sot në shkollë pse shkruhet në kalendar "e diel"?

- Po!

- Mirë, po ata që e kanë përgatitur kalendarin, ku e kanë ditur se sot do të ishte e diel?

- Siç duket, e kanë llogaritur që më parë, e kanë gjetur se sot do të ishte e diel dhe pastaj e kanë shkruar.

- Mirë, po si e kanë llogaritur dhe gjetur, me anë të njohurive, apo si?

- Sigurisht, baba, pa njohuri a bëhet gjë?

- Tani edhe një pyetje: Sikur në kalendar t'i kishin shkruar të gjitha ditët "e diel", ç'do të ndodhte? A do të bënim pushim gjithë javën ne?

- Sigurisht që jo!

- Pse?

- Sepse s'ka si të ketë të diela njëra pas tjetrës! A nuk e dinë këtë ata që përgatisin kalendarin?

- Të lumtë, Enis! Drejt e the! Ata e dinë fort mirë që nuk mund të ketë të diela njëra pas tjetrës. Dhe, tani, dëgjomë me vëmendje! Ne nuk e bëjmë pushim të dielën pse është shkruar në kalendar "e diel". Ata që e kanë përgatitur kalendarin, e kanë llogaritur qysh një vit më parë se sot do të binte e diel dhe e kanë shkruar. Ja ku erdhi kjo ditë dhe ti nuk shkove në shkollë! Ata llogaritën, gjithashtu, se nesër do të jetë e hënë dhe ti do të shkosh në shkollë!

Shkurt, njohja, ditja nga Zoti e gjërave që do të na ndodhin neve në këtë botë dhe shkrimi i tyre si shkrimi në kalendar, është *kader*. Kurse ndodhja ose kryerja e atyre gjërave të paracaktuara kur t'u vijë dita dhe ora, është *kaza*.¹⁷ Po të duash, po të jap edhe një shembull tjetër!

- Mirë, baba!

- Në kalendarë shkruhet edhe çasti kur do të lindë dielli. Me të vërtetë, dielli lind po në kohën e përcaktuar në kalendar! Megjithatë, dielli lind në atë kohë jo sepse është shkruar në kalendar, por sepse ashtu duhet të ndodhë! Edhe jeta e njeriut kësaj i përngjet. Duke jetuar, njerëzit luajnë rol aktiv në formësimin e kaderit të tyre. U ngatërrua pak, po do Zoti e ke kuptuar!..

- Tani me të vërtetë që m'u trazua koka! Megjithatë, më duket se e kuptova! Të falemnderit, baba!

- Zoti ta ndriçoftë mendjen, o bir!

Enisi u kthye sërish te mësimi. E ëma dhe i ati u krodhën sërish në bisedën e tyre.

¹⁷ Arabisht, "kadha". (Shën. i përkthyesit)

2. Ç'ESHTË KAZA-ja?

Kaza-ja është dalja në shesh, kryerja e gjërave të njohura dhe të përcaktuara nga Zoti qysh më parë.¹⁸ Bashkë me këtë, të njohura dhe të paracaktuara janë edhe koha, vendi dhe rrethanat apo kushtet përkatëse. Për shembull, si njohja nga ana e Zotit e çastit dhe vendit të rënies së shiut.

Allahu i Lartë urdhëron: **“Ne e krijuam çdo gjë sipas përmasave të caktuara!”** (Kur’ani, Kamer: 49)

Për ta kuptuar më mirë kaderin dhe kazanë, le të mendojmë mbi rënien e shiut. Paracaktimi nga ana e Zotit i të gjitha rrethanave përkatëse të rënies së një shiu, është kaderi i atij shiu, kurse rënia e shiut kur të jenë krijuar të gjitha ato rrethanat përkatëse të përcaktuara qysh më parë nga Zoti, pra, të paracaktuara, është kazaja e shiut ose vetë shiu.

Po kështu, njohja dhe përcaktimi nga Allahu se ne do të mësojmë në këtë shkollë, është kader, kurse qenia jonë sot si nxënës dhe ndjekja e mësimëve në këtë shkollë, është kaza.

3. RENDESIA QE I JEPET PUNES NE ISLAM

a. Puna është adhurim

Punë quhet veprimtaria e kryer për diçka, është munda i shpenzuar për të. Suksesi i njeriut në një punë varet nga veprimtaria e kryer për atë punë. Njeriu që punon, largohet nga mendimet dhe ndjenjat e këqia, arrin kënaqësinë dhe lumturinë e kryerjes së diçkaje të mirë e të dobishme.

Për të përballuar nevojat e njerëzve, duhet punë e përpjekje. Edhe kafshët, madje, me instinktin e tyre, përpiqen për të kryer ndonjë punë e për të siguruar ushqimin e vet. Puna dhe veprimtaria e bletëve dhe milingonave është një shembull i bukur për njerëzit!

Zoti ynë i Lartë urdhëron: **“Dhe njeriut do t’i takojë vetëm ajo që ka punuar. Dhe, pa dyshim, munda i tij do të gjykohet dhe do t’i jepet pa të metë përgjegjësja e veprës së vet!”** (Kur’ani, Nexhm: 39-41)

Kurse Profeti ynë i dashur ka thënë: *“Askush s’ka ngrënë kafshatë më të bekuar se ajo e fituar me mundin e vet!”* (Buhari)

Sipas kësaj, çdo musliman duhet të punojë seriozisht dhe të fitojë me mundin dhe djersën e vet! Për të patur sukses, u duhet vënë gjoksi vështirësive. Ja, pra, kjo lloj pune dhe veprimtarie me të cilën muslimani do t’i sigurojë dobi vetes, familjes dhe shoqërisë, është ngritur në nivel adhurimi në fenë tonë. Në anën tjetër, feja jonë i ka

¹⁸ Kaderi përbëhet prej elementësh që quhen kadha. “Kadha” do të thotë “rastësi”, “aksident”, (në filozofi, “akcidencë”) veçse, sipas besimit tonë, jo spontan, i vetvetishëm, por si pjesë përbërëse e paracaktuar e një të tërë të paracaktuar. (Shën. i përkthyesit)

ndaluar punët e dëmshme që nuk plotësojnë cilësitë për t'u quajtur "hallall". Në këtë mes, duke urdhëruar punën, islami ka shprehur mospëlqimin për dembelizmin dhe lipësinë.

Është shumë me kuptim vlerësimi që i bën Profeti ynë punës së një njeriu.

Një ditë, kur Profeti po rrinte së bashku me shokët, panë t'u kalonte pranë një burrë i fuqishëm. Shokët i thanë kështu Profetit:

"O i Dërguari i Allahut, sikur ku burrë të përpiqej në rrugë të Allahut!"

Dhe Profeti u shpreh kështu:

"Po qe se ky burrë ka dalë për të fituar bukën e fëmijëve të vet, në rrugën e Allahut është! Po qe se ka dalë për të fituar bukën e prindërve pleq, prapë në rrugë të Allahut është! Edhe në se ka dalë për të fituar bukën e vet, në rrugë të Allahut është!"

Puna dhe përpjekja për të fituar hallall, është e shenjtë. I përfton njeriut të mirë si për adhurim. Megjithatë, nuk mund ta zerë vendin e adhurimeve themelore si namazi, agjërimi, zeqati, haxhi. Prandaj, të punosh, nuk do të thotë t'i lësh mënjanë adhurimet. Çdo musliman e ka për detyrë t'i kryejë adhurimet që ka urdhëruar Allahu. Muslimani duhet edhe t'i çojë në vend këto detyra fetare, edhe duhet të punojë e të përpiqet për të fituar kënaqësinë e Allahut! Çka na takon ne, është t'i bëjmë që të dyja. Dhe kjo është e drejta!

b. Allahu i do ata që punojnë

Robtë më të dashur për Allahun janë ata që i besojnë, që bëjnë adhurim dhe që përpiqen e punojnë.

Të gjithë profetët, duke filluar me Hz. Ademin, njeriun dhe profetin e parë, janë bërë shembull në punë për njerëzit. Për shembull, Hz. Ademi merrej me bujqësi. Hz. Nuhu ishte marangoz. Hz. Daudi, hekurpunues. Hz. Idrisi ishte rrobaqepës. Hz. Musai pati punuar si çoban. Kurse Profeti ynë i dashur, në fëmëni pati shërbyer si çoban, kurse, qysh në rini qe marrë me tregti. Ai qe marrë edhe me punë shtëpie.

Allahu nuk e do atë që rri kot. Atëherë, edhe ne na duhet të punojmë me plan. Tani që jemi nxënës, duhet të merremi me mësimet. Pas tyre duhet t'u ndihmojmë prindërve. Kurse në pushimet e verës duhet të lexojmë shumë libra për t'i shtuar njohuritë. Duhet ta njohim si detyrën tonë t'u ndihmojmë prindërve në shtëpi, në punë, në kopësht e në arë.

Profeti ynë i dashur ka thënë: "Dora që jep është më e mirë se dora që merr!" (Myslim) Me këtë ka dashur të thotë se, në vend që të lipë, njeriu duhet të punojë e ta fitojë bukën me mundin e vet!. Muslimanit i ka hije që, në vend që të shtrihet si dembel e ta vrasë kohën duke shëtitur më kot, të punojë e të fitojë me mundin e tij!

c. Kush i ka dy ditë njëlloj, është në humbje

Profeti ynë i dashur ka urdhëruar: “*Kush i ka dy ditë njëlloj, është në humbje!*” (Buhari) Kjo do të thotë se njeriu duhet të punojë për çdo ditë më shumë e më mirë se një ditë më parë!

Çdo ditë, nxënësit u shtojnë njohurive të mëparshme njohuri të reja. Shtimi i njohurive tona varet prej vetë neve. Më shumë njohuri duan më shumë punë. Kjo është edhe rruga për t’u bërë të dobishëm për vendin.

Zhvillimet në këtë botë qysh nga dita e krijimit të saj, janë rezultate të punës. Po qe se s’do të ishin zbulimet e bëra si rezultat i punës dhe përpjekjeve të vazhduara në të gjitha fushat, sot do të bënim ende një jetë primitive. Për shembull, po të mos ishte shpikur shtypja dhe shtypshkronja, a do të mund të përgatiteshin me dorë libra për miliona e miliona nxënës? Po të mos ishin ndërtuar automobilët, trenat, anijet, aeroplanët, si do të mund të shkonim nga një vend në një tjetër? Po të mos ishte drita elektrike, si do të mund të studionim ende nën dritën e kandilëve apo llambave me gaz?

Kjo do të thotë se të gjitha këto zhvillime janë rezultat dhe përfundim i punës, veprimtarisë dhe përpjekjeve të bëra duke përdorur mendjen që na ka dhënë Zoti. Prandaj duhet të kryejmë me korrektesë punët që u përkasin si kësaj bote, ashtu edhe tjetrës. Këtë kërkon edhe Profeti ynë prej nesh!

Lexim letrar

Më mirë luan apo dhelpër e drobitur?

Një ditë, një burrë shkon në pyll për të gjuajtur dhe vendos që natën ta kalojë atje. Por, nga frika e kafshëve të egra, hipi në një pemë. Ndërsa po rrinte, dëgjoji një rënkim. Vështroi përreth dhe pa poshtë një dhelpër të drobitur. Burri mendoi: “Me ç’ushqehet, vallë, kjo dhelpër?”

Pas pak, sheh një luan që po vinte nga larg. Luani mbante në gojë një drenushë.

Luani erdhi në rrëzë të pemës dhe nisi ta hante prenë e vet. Pasi u ngop mirë e mirë, u hoq e shkoi. Kur luani ishte humbur nga sytë, dhelpëra zbriti ngadalë e me mundim nga pema dhe u ul të hante nga mbeturinat e luanit. Edhe dhelpëra u ngop e hipi sërish në pemë.

Kjo ndodhi e vuri burrin në mendime.

“Domethënë se Allahu kujdeset edhe për një kafshë të plakur e të drobitur dhe ia çon ushqimin te këmbët! Atëherë, unë pse punoj e përpiqem më kot? Këtej e tutje edhe unë po tërhiqem në një qoshe e po pres...”

Me këtë mendim, burri u fut në një shpellë buzë rrugës dhe u vu të presë. Priti një ditë, dy e tri, por asgjë! Asnjë ushqim s'i erdhi te hyrja e shpellës! Më në fund, burri ra i sëmurë nga të pangrënët. Dhe, ndërsa ishte ashtu, as fjetur, as zgjuar, dëgjoji t'i fliste një zë:

“Ngreu, o budalla! Ç'rri akoma shtrirë? Ç'është ky dembelizëm kur të punon këmba e dora? Pse e bën veten si dhelpra e drobitur dhe e çalë? Shko e gjuaj si luani! Edhe veten e ushqen, edhe për të tjerët mbetet!..”

Pas këtyre fjalëve, burri e kupton të vërtetën, del nga shpella dhe zë rrugën e fshatit i vendosur që të punojë e ta fitojë bukën me mundin e vet!..

4. KREU “LEHEB” DHE KUPTIMI I TIJ

تَبَّتْ يَدَا أَبِي لَهَبٍ وَتَبَّ (١) مَا أَغْنَىٰ عَنْهُ مَالُهُ وَمَا كَسَبَ (٢) سَيَصْلَىٰ نَارًا ذَاتَ
لَهَبٍ (٣) وَأَمْرَأَتُهُ حَمَّالَةَ الْحَطَبِ (٤) فِي جِيدِهَا حَبْلٌ مِّن مَّسَدٍ (٥)

Kuptimi: “Iu thafshin të dy duart Ebu Lehebit! Dhe i janë tharë! S'i sollën dobi pasuria dhe fitimet. Do të digjet ai në një zjarr që përvëlon. Po ashtu edhe gruaja e tij si drubartëse me një litar të përdredhur për qafe!”

PERMBLEDHJE

1. Jepni të dhëna mbi kaderin dhe kazanë.
2. A quhet puna adhurim në fenë tonë? Pse? Shpjegojeni.
3. Ç'ka dashur të thotë Profeti ynë me fjalët “Dora që jep është më e dobishme se dora që merr?”
4. Pse i do Allahu ata që punojnë?
5. Shpjegojeni fjalën e Profetit tonë, “Ai që i ka dy ditë njëlloj, është në humbje!”

PJESA VII
DETYRAT TONA MORALE

ÇESHTJET

1. E MIRA. TE JEMI BAMIRES
2. TE KRIJOJME MARREDHENIE TE MIRA ME TE TJERET
3. TE RUHEMI PREJ LUKSIT DHE SHPENZIMIT TE TEPERT
4. KREU “FELAK” DHE KUPTIMI I TIJ

PUNE PERGATITORE

1. Si sillet në shkollë dhe në shtëpi një nxënës që e ka bërë shprehi jetesën e rregullt?
2. Ç’lidhje ka proverba “Fjala e ëmbël e nxjerr gjarpërin prej vrime” me çështjen e krijimit të marrëdhënieve të mira me të tjerët?
3. Ç’do të thotë “shoqatë”? A ka në mjedisin tuaj shoqata dhe institucione mirëbërësie?

1. E MIRA. TE JEMI BAMIRES

“E mirë” quhet çdo punë dhe sjellje e bukur që do të bëhej shkak për të fituar pëlqimin e Allahut. Çdo musliman duhet të jetë i mirë, të bëjë mirë dhe të dojë të mirën e të tjerëve.

Ka shumë rrugë për të bërë mirë. Njeriu, po të dojë, mund të bëjë të mirë dhe të japë ndihmë me dorë, me fjalë dhe me pasuri.

Nuk duhet parë në se e mira apo ndihma janë të mëdha apo të vogla. Allahu i Lartë urdhëron: **“Një njeri, edhe në se bën një të mirë sa grimca, do ta marrë përgjegjësen e saj!”** (Kur’ani, Zilzal: 7)

Profeti ynë e ka shprehur kështu idenë se edhe e mira e vogël i sjell njeriut fitime të mëdha:

“Një herë e një kohë, ishte një grua mëkatare. Duke shkuar rrugës, hasi në një pus. Përreth pusit vërtitej vazhdimisht një qen. Ai ishte etur shumë. Po vdiste nga etja! Sapo e kuptoi këtë, gruaja nxori menjëherë këpucën, mori ujë nga pusi dhe i dha qenit të pinte. Atëherë, edhe Allahu e fali gruan se i bëri qenit një të mirë!” (R. Salihin)

Kur edhe mirësia e bërë për kafshët bëhet shkak për falje, mendoni se ç’gjëra mund të fitojmë nga mirësia e bërë njerëzve!

Llojet e ndihmës

Ka rrugë të ndryshme për të ndihmuar e për të bërë mirë. Profeti ynë ka porositur:

“Asnjë lloj mirësie mos e nënvleftëso edhe sikur të bëhet fjalë vetëm për ta pritur vëllanë me fytyrë të qeshur!” (R. Salihin)

Pra, gjithmonë kemi rast për të ndihmuar, për të bërë mirë! Këto mund t’i radhisim kështu:

1. Të tregohemi fytyrëqeshur dhe fjalëmirë me të tjerët.
2. Ta ngushëllojmë dhe qetësojmë njeriun e dëshpëruar.
3. T’u bëjmë vizitë të moshuarve dhe të sëmurëve. T’u ndihmojmë në se kanë ndonjë punë për të bërë.
4. Të shkëmbejmë përshëndetje me njerëzit e mjedisit tonë.
5. Ato që dimë, t’ua mësojmë të tjerëve. T’i këshillojmë për mirë, të përiqemi për t’i larguar prej të këqijave.
6. Në automjetet urbane, t’u lëshojmë vendin të moshuarve dhe të sëmurëve.

7. Të ruhemi prej sjelljeve shqetësuese për të tjerët; për shembull, të mos hedhim mbeturina për tokë. T'i mbajmë pastër parqet, lulishtet, vendet e piknikut, rrugët dhe rrugicat.

8. T'i mbrojmë kafshët, t'ua tërheqim vëmendjen njerëzve që sillen keq me to.

Të gjitha këto janë të mira me fjalë, sjellje e veprime. Kurse duke dhënë zeqat dhe sadaka, japim edhe ndihmë materiale.

Lexim letrar

E mira

Poeti i shquar *Saadi* e tregon kështu një ngjarje të jetuar nga ai vetë:

Një herë e një kohë, po udhëtoja me gjemi. Pranë kisha njerëz të shquar. Bisedoja me ta dhe përpiqesha të përfitoja prej njohurive të tyre. Në jetën time s'kisha bërë udhëtim më të bukur e më të dobishëm se ai!

Koha ishte e bukur. Ujrat e lumit Tigër, nëpër të cilin po lundronim, ishin të qeta. Kohë më kohë, në të dyja brigjet e lumit na shfaqeshin pamje të bukura, bujqit që punonin nëpër ara, na tundnin me përshëndetje dorën. Një çast, më ra në sy se larg, një varkë po përpiqej të merrte udhë. Në të ishin dy peshkatarë. Ndërkaq, koha u prish. Varka nisi të rrëshqiste drejt një vorbule në mes të lumit. Pastaj, menjëherë u përmbys dhe u fundos. Pa e marrë vesh se ç'po ndodhte, peshkatarët e panë veten mes ujrave të Tigrit.

Ne po e vështronim këtë fatkeqësi nga gjemia. Burrat e shkretë rropateshin të shpëtonin. Një njeri mirëbërës që ndodhej me ne në gjemi, iu kthye gjemixhiut:

- Shpëtoji këta dy njerëz dhe do të të jap pesëdhjetë florinj për secilin! Gjemixhiu u hodh menjëherë në ujë. Njërin e shpëtoi, kurse tjetri humbi në vorbull. I gjori u mbyt.

Unë i thashë gjemixhiut:

- Aq jetë paska pasur i shkreti! Njërin e shpëtova, po për tjetrin s'pate kohë!

Gjemixhiu qeshi dhe ma ktheu:

- Ç'është e drejta, zemra këtë të ri ma donte ta shpëtoja, sepse dikur, kur pata mbetur i vetëm në shkretëtirë, pata takuar ja, këta dy vëllezërit! Ky që shpëtova, më

hipi në devenë e vet duke më shpëtuar nga etja, uria dhe kafshët e egra! Kurse nga tjetri pata ngrënë një kamxhik!

Fjalët e gjemixhiut më futën në mendime dhe thashë me vete:

“Sa të kesh mundësi, mos ia thyej zemrën kujt! Ndhimoji që të gjithë! Kryeju punë të mjerëve! Kuptoje hallin e atyre që kanë mbetur ngushtë dhe bëju mirë, se vjen dita që edhe ti të kesh nevojë! Kryeju punë të tjerëve që edhe ata të të kryejnë punë ty! Si ka urdhëruar Zoti:

“Edhe ai që bën mirë, edhe ai që bën keq, vetes ia bën!”

2. TE KRIJOJME MARRËDHËNIE TE MIRA ME TE TJERET

Njerëzit që jetojnë në shoqëri, duhet të krijojnë marrëdhënie të mira me njëri-tjetrin në mënyrë që të mund të jetojnë të kënaqur e të lumtur. Feja jonë i jep kësaj shumë rëndësi.

Një ditë, Profeti po rrinte bashkë me shokët. Ndërkaq, erdhi një njeri dhe e pyeti:

- O i Dërguari i Allahut! “Islam” ç’do të thotë?

Profeti iu përgjeggj:

- *Islami është moral i bukur!*

- O i Dërguari i Allahut! Po “moral i bukur”, ç’do të thotë?

- *Të pajtohesh me njeriun që zemërohet me ty, që i pret marrëdhëniet me ty, t’i japësh atij që s’të jep ty, ta falësh atë që të ka bërë keq ty!*

Këto fjalë të Profetit e parashtrajnë shumë bukur se si duhet vepruar për të krijuar marrëdhënie të mira me të tjerët!

Edhe në një hadith tjetër, Profeti ynë i dashur ka treguar se muslimani duhet të krijojë marrëdhënie të mira me të tjerët.

Ai ka thënë: “... Mos prit të mirë prej njeriut të pashkuar!” Dhe me këtë ai ka theksuar rëndësinë e shkuarjes mirë me të tjerët, e marrëdhënieve të mira me të tjerët.

Për t'i zbatuar këto këshilla të Profetit tonë të dashur, para së gjithash duhet ta duam njëri-tjetrin.

Mësimet që duhen nxjerrë nga këshillat e tij, janë këto:

a. Dashuria që ushqejmë për të tjerët, s'duhet të mbetet vetëm me fjalë, ajo duhet të shfaqet edhe në sjelljet dhe veprimet tona. Bie fjala, s'mjafton vetëm t'i themi shokut "të dua!", por edhe të shkojmë mirë me të, të mos e dëshpërojmë, të ruhemi nga fjalët dhe qëndrimet fyese ndaj tij.

b. S'duhet të zemërohemi me asnjëri, duhet t'i pajtojmë të zemëruarit.

c. Njerëzit me të cilët takohemi, t'i përshëndesim me fjalë e shprehje si "selamu alejkum!", me fjalë që shprehin ndaj tjetrit urim për shëndet, etj. Përshëndetja fuqizon lidhjen dhe ndihmon për formimin e marrëdhënieve të mira. Për këtë arsye, Profeti ynë ka porositur: "*Përhapeni përshëndetjen mes jush!*" (Müslim, Iman, 9)

ç. Për krijimin e marrëdhënieve të mira ka shumë rëndësi edhe vizita e herëpashërshme të shokët dhe miqtë. Profeti ynë u bënte vazhdimisht vizita njerëzve të mjedisit të tij dhe këtë ua këshillonte edhe muslimanëve.

d. Nuk duhet të harrojmë edhe se, për të patur marrëdhënie të mira me të tjerët, duhet të jemi fytyrëqeshur dhe fjalëmbël.

e. Gjithashtu ka rëndësi edhe ndarja me të tjerët e gëzimeve dhe hidhërimeve. Ne i duam ata që na ndodhen pranë në gëzime duke gëzuar bashkë me ne, si dhe në hidhërime duke na gushëlluar e qetësuar.

f. Edhe dhënia dhe marrja e dhuratave ka shumë rëndësi. Profeti ynë ka theksuar se kjo e shton dashurinë mes njerëzve.

Ndihma shoqërore, gjithashtu, ka rëndësi të madhe për jetën në shoqëri. Individët që munden të krijojnë marrëdhënie të mira mes tyre, munden edhe të zbatojnë një ndihmë shoqërore të përgjithshme.

Në themel të ndihmës shoqërore është dashuria mes njerëzve dhe mirëkuptimi mes tyre. Por kjo ndihmë dhe mbështetje shoqërore nuk mund të arrihet në qoftë se nuk duam edhe për tjetrin atë që duam për vete, bashkimi dhe uniteti nuk mund të krijohen. Profeti ynë na ka porositur: "*Ju këshilloj të jeni të bashkuar! Ai që ka dëshirë të ndodhet në mes të xhennetit, të përpiqet për ta arritur këtë së bashku me të tjerët!*" (Tirmidhi, Fiten, 7) Kurse në një hadith tjetër ka thënë: "*Mos u ndani nga bashkësia! Dijeni se atë që ndahet nga tufa, e ha ujku!*" (E. Davut, Salat, 46)

Ndarja e gëzimeve dhe hidhërimeve ka një rëndësi shumë të madhe në arritjen e bashkimit dhe ndihmës shoqërore. Profeti ynë i dashur na ka porositur: "*Besimtarët janë si një trup i vetëm në dashurinë ndaj njëri-tjetrit, në dhembshurinë për njëri-tjetrin, në mbrojtjen e njëri-tjetrit. Në se një organ sëmuret, edhe organet e tjera të trupit shqetësohen e mbeten pa gjumë!*" (Buhari, Edeb, 19)

Lexim letrar

Profeti ynë e pëlqente dhënien e dhuratave

Një grua i dhuroi Profetit një copë stofë. Ai kishte nevojë për një copë të tillë. Mirëpo, dikush prej shokëve që ndodheshin aty, tha:

- Sa e bukur!

Dhe Profeti ia dha copën atij!

Profeti ua dhuronte shokëve gjërat që u pëlqenin atyre!

Lexim letrar

Fjalët e Profetit tonë për moralin e bukur

Profeti ynë i dashur ka shumë fjalë të bukura dhe këshilla për moralin. Ja disa prej tyre:

“Muslimani është personi tek gjuha dhe dora e të cilit muslimanët e tjerë kanë siguri!” (Buhari, İman, 3-4; Müslim, İman, 64-66)

“Askush nuk ka besuar plotësisht në se nuk do për fqinjin (ose të vëllanë) atë që do për veten!” (Buhari, İman, 5; Müslim, İman, 71)

Profeti i ka thënë kështu një muslimani që e ka pyetur se ç'të drejta ka fqinji tek ai:

“Po të sëmuret, t'i shkosh për vizitë. Po të vdesë, t'ia falësh namazin. Po të të kërkojë hua, t'i japësh. Po të mbetet ngushtë, ta ndihmosh. Po t'i ndodhë një e mirë, ta urosh. Po t'i ndodhë ndonjë fatkeqësi, ta ngushëllosh. Mos e ngre çatinë aq sa t'ia presësh erën. Ose s'duhet ta dijë se ç'je duke ngrënë, ose jepi edhe atij nga ajo që ke gatuar!” (Y. Kandehlevi, Hadislerle Müslümanlık, III, 1085)

“Fjalëdrejtësia të çon në mirësi, kurse mirësia, në xhennet. Duke folur e duke folur drejt, njeriu ngjitet në nivelin e njerëzve të urtë pranë Allahut. Gënjeshtria të çon në të keqe dhe e keqja, në xhehennem. Duke gënjyer e duke gënjyer, njeriu arrin te Allahu si “gënjeshtar”. (Riyazü's-Salihin Tercümesi)

Njëri prej shokëve e pyeti Profetin: “Cila është gjëja që bëhet më tepër shkak që njerëzit të hyjnë në xhennet, o i Dërguari i Allahut?” Dhe ai i dha këtë përgjigje: *“Frika nga Allahu dhe morali i bukur!”* (Riyazü's-Salihin)

“Të kesh moral të bukur, do të thotë të jesh fytyrëqeshur, të jesh dorëlirë në punë të dobishme si dhe të mos mundosh kënd!” (Riyazü's-Salihin)

“Në Ditën e Llogarisë, në peshoren e besimtarit asgjë s'është më shumë se morali i bukur. Allahu i Lartë nuk do askënd që është fjalëkeq!” (Riyazü's-Salihin)

3. TE RUHEMI PREJ LUKSIT DHE SHPENZIMIT TE TEPERT

Një prej sjelljeve të ndaluara prej fesë sonë është edhe shpenzimi i tepërt. Shpenzim i tepërt quhet ai i bërë në mënyrë të skajshme, jashtë kufijve normalë të personit.

Edhe luksi që është marrja me tepricë e gjërave për të cilat ndiejmë nevojë ose e gjërave shumë të shtrenjta të panevojshme, është një lloj shpenzimi i tepërt.

Kur flitet për shpenzim të tepërt, gjithmonë na shkojnë në mendje shpenzimet e panevojshme të të tjerëve, kurse ne vetë kush e di se sa shpenzime të tilla bëjmë! Për shembull, le të mendojmë se çdo ditë këpusim ose zhgarravisim një fletë fletoreje. Dhe po të mendojmë se këtë mund ta bëjnë të gjithë nxënësit, na del parasysh një shpenzim tepër i madh!

Le të shohim edhe shpenzimin në të ngrënë. Nga shtypi dhe televizioni marrim vesh se çdo ditë hidhen në plehra me mijra ton bukë dhe ushqime të mbetura.

Por me shpenzimin e tepërt nuk duhet të na shkojnë në mend vetëm gjëra materiale. Për shembull, le të mendojmë një punëtor. Në qoftë se ai, kohën e duhur për të fituar me djersë ushqim për fëmijët e tij, e kalon në lojë e në dëfrim, ky është një shpenzim i kotë i kohës. Është e njëjta gjë me shpenzimin e kotë të kohës nga një nxënës i cili, në orarin e studimit e të përgatitjes së mësimëve, sheh televizor!

Më e drejta është që çdo gjë të bëhet në kohën e vet. Për të patur sukses, duhet shfrytëzuar mirë koha. Kështu, Profeti ynë urdhëron:

“Dijeni vlerën e pesë gjërave para pesë gjërave të tjera (para se t'u ketë kaluar koha): vlerën e jetës para vdekjes, të shëndetit para sëmurjes, të kohës së lirë para mungesës së kohës, të rinisë para pleqërisë, të pasurisë para varfërisë!” (Feyzü'l-Kadir)

Si përfundim, mund të themi se çdo njeri duhet të ruhet nga luksi dhe shpenzimi i tepërt. Kjo vlen si për të pasurit, ashtu edhe për të papasurit. Por luksi dhe shpenzimi i tepërt është veçanërisht i keq e me pasoja të rënda për të papasurit ose për ata me fuqi ekonomike të dobët. Duke bërë luks dhe duke shpenzuar, siç thuhet, me të dy duart, të pasurit e derdhin më kot pasurinë duke u bërë dëm vetes dhe vendit. Kurse të dobëtit ekonomikisht bien në gjendje të vështirë. Po qe se s'gjejnë para për të përballuar shpenzimet e tepërta dhe luksin, mund t'u drejtohen veseve të këqia. Vjedhja dhe rushfeti janë dy prej tyre.

Kur shpenzojmë, gjithmonë duhet të mbajmë parasysh fjalët e Allahut të Lartë: **“O njerëz! Hani, pini por mos e teproni, sepse Allahu nuk i do ata që e teprojnë!”** (Kur'ani, A'raf: 31)

Lexim letrar

Vedati dhe Sedati

Vedati me Sedatin po rrinin në dhomën e tyre të studimit. Hyri i ati dhe i pyeti se ç'kishin mësuar në shkollë atë ditë. Vedati nisi të përgjigjej. Por i ati deshi edhe t'i kontrollonte prandaj u kërkoi të hapnin librat. Vedati e nxori nga çanta librin menjëherë, kurse Sedati vinte rrotull, e trazonte çantën me duar, nxirrte e fuste libra dhe, në rrëmujën e çantës nuk po e gjente dot librin që i duhej. Më në fund, duke e vështruar të atin me sytë e hutuar, i tha:

- S'e paskam futur librin në çantë!
- Po pse s'e the qysh në fillim?
- Kujtoja se e kisha. I kisha futur librat pa rregull, prandaj u ngatërrova.

Babai e ktheu fytyrën nga Vedati dhe i bëri shenjë për të lexuar. E pëlqeu shumë leximin e tij. Pasi i bëri disa pyetje dhe mori përgjigje të mira, i tha se do ta shpërblente me që ishte i rregullt dhe i kryente me zell mësimet. Një ditë më pas i solli Vedatit një orë të bukur.

Fëmijë! Merrni edhe ju pjesën që ju takon nga ky tregim. Kujdesuni që në çdo punë të jeni të rregullt e sistematikë. Dhomën e studimit mbajeni në rregull. Librat të mos ju rrinë rrëmujë. Çrregullimi ia ul njeriut kohën përgjysmë. Librat vendosini në atë mënyrë që ta gjeni menjëherë atë që kërkoni. Ashtu t'i keni edhe veshjet dhe gjërat e tjera. Kur të zhvisheni për të fjetur, rrobat i veni në rregull që, kur të ngriheni në mëngjes, t'i gjeni e të visheni shpejt, të merrni abdest, të falni

namazin, të hani bukë e të niseni në shkollë pa humbur kohë. Po të mos veproni kështu, as librat do të mund t'i gjeni, as bukë do të mund të hani, po do të detyroheni të shkoni në shkollë duke vrapuar për të kapur kohën e humbur, por prapë pa fituar gjë se në mësim asgjë s'do ta keni të plotë e të rregullt.

Koha është flori! Dijani vlerën kohës!

Mos harroni kurrë se rregulli jua lehtëson të gjitha punët!

4. KREU “FELAK” DHE KUPTIMI I TIJ

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ (١) مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ (٢) وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ (٣) وَمِنْ
شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ (٤) وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ (٥)

Kuptimi: “Thuaj: “Mbështetem te Zoti i agimit nga sherri i natës kur bie, nga sherri i magjistarit kur lidh magji dhe nga sherri i ziliqarit kur bën zili!”

PERMBLEDHJE

1. Pse është i rëndësishëm krijimi i marrëdhënieve me të tjerët?
2. Ç'duhet të bëjmë për të krijuar marrëdhënie të mira me të tjerët?
3. Cilat janë këshillat e Profetit tonë mbi krijimin e marrëdhënieve të mira me të tjerët?
4. Ç'do me thënë “e mirë”?
5. Cilat janë rrugët për të bërë mirë?
6. Cilat janë të mirat kryesore që bëjmë në jetën tonë të përditshme?
7. Cilat janë dëmet e shpenzimeve të tepërta?

PJESA VIII

PASTERTIA DHE NDERSHMERIA

ÇESHTJET

1. PASTERTIA
 - a. Pastërtia e brendshme
 - b. Pastërtia e jashtme
2. NDERSHMERIA
 - a. Në mendim
 - b. Në bisedë
 - c. Në sjellje, në marrëdhëniet tregtare, në matje e peshim
3. KREU "NAS" DHE KUPTIMI I TIJ

PUNE PERGATITORE

1. Në gjuhën tonë ka shumë fjalë të urta e proverba mbi pastërtinë. Gjeni dhe shkruani në fletore dy prej tyre.
2. Ç'do të thotë t'i kesh punët siç ke fjalët? Pyetni më të mëdhenjtë dhe shkruajeni shpjegimin në fletore.

1. PASTERTIA

Njëra prej detyrave të rëndësishme të muslimanit është edhe mbrojtja e shëndetit. Kurse kushti i parë i ruajtjes së shëndetit është pastërtia.

Feja jonë i jep shumë rëndësi pastërtisë. Në Kur'an urdhërohet: “... **Allahu i do të pastërtit!**” (Kur'ani, Bakara: 222) Edhe thënia e Profetit tonë, “*Pastërtia është gjysma e besimit*” është tregues i kësaj rëndësie.

a. Pastërtia e brendshme (pastërtia moralo-shpirtërore)

Pastërti e brendshme do të thotë, për personin, moral i bukur. Kjo quhet, e shprehur më gjatë e më plotë, “*pastërti moralo-shpirtërore*”. Edhe shprehja “*zemërpastër*” që themi për dikë, po këtë gjë shpreh. Njeriu zemërpastër ruhet prej të këqijave, bën punë të mira, ka shprehi të bukura.

Shkurtimisht:

1. Një musliman duhet të jetë i pastër brenda po aq sa jashtë.
2. Ai duhet ta pastrojë zemrën nga ndjenjat e këqia si mashtrimi, egoizmi, smira, etj.
3. Dhe duhet ta mbushë me ndjenja të bukura si dashuria, mëshira, dhembshuria, bujaria.
4. Duhet t'i kryejmë adhurimet pa të meta, sepse ato, duke na e zbukuruar moralin, na ruajnë prej të këqijave. Allahu i Lartë urdhëron: “**Namazi e largon njeriun prej të këqijave e paturpësive...**” (Kur'ani, Ankebut: 45) Kurse Profeti ka thënë: “*Agjërimi është një mburojë që e ruan njeriun prej të këqijave!*” (Buhari)
5. Duhet marrë njohuri të sakta, sepse njohuritë e gabuara dhe besimet e kota, bestytnitë, gjithmonë mund ta gënjejnë njeriun.

Pastërtia e brendshme reflektohet në anën e jashtme të njeriut. Fundja, kjo është e rëndësishme. Janë krejtësisht pa vend fjalët e atyre që, pasi kanë bërë të gjitha të këqijat, thonë se u duhet parë zemra, se zemrën e kanë të pastër, etj.

b. Pastërtia e trupit dhe mjedisit

Pastërtisë së trupit dhe mjedisit i thuhet edhe “pastërti e jashtme, materiale”. Muslimani duhet t'i japë rëndësi pastërtisë së trupit dhe mjedisit po aq sa edhe pastërtisë moralo-shpirtërore!

Pastërtia e trupit

Një ditë Profeti po rrinte bashkë me shokët. Bisedonte me ta dhe përpiquej t'i ndriçonte. Në këtë mes, erdhi dikush e u ul pranë tyre. Pamjen e kishte krejt të

çrregullt. Rrobat i ishin fëlliqur. Pamja e tij e shqetësoi Profetin. Por nuk deshte ta qortonte dhe mërziste në prani të të tjerëve.

Pas një copë herë, burri u ngrit. Profeti dërgoi një nga shokët menjëherë pas tij. Pasi e takoi, shoku i Profetit i tha:

“Ke të fala nga Profeti: “Allahu i do njerëzit e pastër. Prandaj të pastrohet menjëherë, të lajë trupin, të pastrohet prej zhulit dhe erërave të këqia. Pastaj të veshë rroba të pastra e të mos dalë mes njerëzve me një pamje që t’i shqetësojë të tjerët. Muslimanit i ka hije të jetë i pastër!” (Myslim)

Njeriu e kuptoi gabimin, falenderoi dhe, pas asaj dite, sa qe gjallë, i kushtoi kujdes pastërtisë!

Kjo ngjarje tregon se sa rëndësi i jep feja jonë pastërtisë. Prandaj muslimani duhet t’i japë përparësi pastrimit.

Gjërat më të rëndësishme që duhen bërë për pastrimin e trupit, janë këto:

1. Duhet ta lajmë shpesh trupin me ujë të bollshëm.
2. Duhet t’i japim rëndësi pastrimit të duarve, fytyrës e këmbëve.
3. Thonjtë duhet t’i mbajmë të prera e të pastra.
4. Duhet t’i kushtojmë kujdes pastërtisë së gojës dhe duhet t’i pastrojmë dhëmbët rregullisht pas ngrënies.
5. Duhet t’i kushtojmë vëmendje pastërtisë dhe rregullit të veshjes.
6. Po aq sa për trupin, duhet të tregojmë kujdes edhe për pastërtinë e ushqimeve. Frutat dhe perimet s’duhet t’i hamë pa i larë, sidomos duhet të ruhemi nga ushqimet që shiten hapur.
7. Edhe adhurimet na e sigurojnë pastërtinë. Për shembull, për të falur namaz, marrim abdest dhe pastrohemi. Gjithashtu, falja e namazit kërkon t’i kemi të pastra si trupin, ashtu edhe vendin ku do të falemi.

Lexim letrar

Kur shkoj në shkollë

Me puthjen e nënës
I hap sytë e mpirë;
Faqe e duar
I laj mirë e mirë!

E filloj mëngjesin
Me Bismil'lah!
I shtoj bukës sonë
Begati pa prá!

Tryezën s'e trazoj,
Me ç'kam përpara ha;
Allahun falenderoj:
Elhamdulillah'lah!

Pastaj laj duart,
Dhëmbët i pastroj;
Zogjtë më vështrojnë
Në shkollë tek shkoj...

Te derë e shkollës
Syqeshur më pret
Mësuesi m'i mirë i botës,
Me gaz më përshëndet!

Pastërtia e mjedisit

Të gjithë kemi nga një shtëpi ku jetojmë e një vend pune ku punojmë. Jetojmë në fshat apo në qytet. Shëtisim në park, në lulishte ose në livadhe. Të gjitha këto përbëjnë atë që e quajmë *mjedis*.

Çdo musliman duhet t'i kushtojë rëndësi pastërtisë së mjedisit po aq sa edhe të trupit. Një mjedis i pastër i jep njeriut kënaqësi e lumturi. Kurse një mjedis i fëlliqur është burim shqetësimi dhe sëmundjesh.

Pastërtia e mjedisit ka rëndësi edhe përsa u përket adhurimeve. Për shembull, është kusht që vendi ku do të falet namaz, të jetë i pastër. Prandaj, ashtu siç

kujdesemi në shtëpi që vendi ku falemi të jetë i pastër, ashtu edhe xhamitë duhet t'i mbajmë të pastra.

Në kohën e Profetit, në Medine jetonte një grua që e quanin Ummu Mihxhen. Kjo zezake etiopiane muslimane çdo ditë shkonte në xhaminë e ndërtuar prej Profetit dhe e pastronte.

Një ditë Profetit i ra në sy se gruaja nuk kishte ardhur si për herë. Dhe i pyeti ata që kishte përreth:

“Ç’i ka ndodhur Ummu Mihxhenit? Ka ditë që s’e shoh!”

Shokët i thanë:

“O i Dërguari i Allahut, Ummu Mihxheni vdiq!”

Profetin e hidhëroi shumë ky lajm.

“Pse nuk më keni lajmëruar? Ummu Mihxheni ishte një muslimane e pastër. Ishte një rob i dashur i Allahut! Po ta dija, do t’ia falja namazin dhe do t’i rrija te kryet e varrit!”

Pastaj shtoi:

“Më çoni te varri i saj!”

Profeti i bëri vizitë varrit të saj dhe iu lut Zotit për këtë grua të pastër!

Kjo ngjarje tregon se vendet ku kryhet adhurim duhet të mbahen shumë të pastra, se Allahu mbetet shumë i kënaqur nga ata që e kryejnë këtë pastrim.

Në të vërtetë, mjedisin tonë e përbën e gjithë bota me detrat, malet, fushat, ajrin, ujrat, prandaj duhet t'i mbajmë të pastër, ashtu si shtëpinë dhe xhaminë, edhe rrugët dhe rrugicat, parqet dhe lulishtet, çdo vend ku kalojmë. Prandaj:

1. Nuk duhet t'i hedhim plehrat për tokë.
2. Nuk duhet t'i gërvishim muret, nuk duhet të shkruajmë e të zhgarravisim mbi to.
3. Copat e letrave, mbeturinat e ushqimeve dhe çdo gjë që duhet hedhur, t'i hedhim në koshat e plehrave.
4. Shkollën dhe klasën duhet t'i mbajmë pastër ashtu si shtëpinë. Nuk duhet të harrojmë se një mjedis i pastër do të thotë, në të njëjtën kohë, mjedis i shëndetshëm!

2. NDERSHMERIA

Ndershmëria është qëndrimi i drejtë i njeriut në të gjitha veprimet dhe sjelljet e tij, ndaj të gjitha dukurive që e rrethojnë. E kundërta e ndershmërisë është gënjeshtria, mashtrimi dhe dyfytyrësia. Feja jonë, gënjeshtren, mashtrimin dhe dyfytyrësinë i ka ndaluar.

Një ditë, një njeri shkoi te Profeti dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Më thuaj për fenë islame një fjalë të tillë që pas saj të mos kem më nevojë të pyes kënd!”

Dhe Profeti i tha:

“Thuaj: “I besova Allahut!” Dhe pastaj bëhu i ndershëm, krejt i ndershëm!”

Me këtë fjalë, Profeti ynë i dashur deshte të tregonte se ç’rëndësi të madhe i jepte feja jonë ndershmërisë!

Për ndershmërinë, Allahu i Lartë urdhëron:

“Nuk ka frikë për ata që, pasi thanë *Allahu është Zoti ynë*, u treguan të ndershëm, ata nuk do të pikëllohen. Ata janë banorët e xhennetit dhe, si shpërblim për punën e tyre, aty do të mbeten përgjithmonë!” (Kur’ani, Ahkaf: 13-14)

Në se duam që në jetën tjetër të meritojmë këtë dhuratë të madhe të Zotit, duhet të jemi të ndershëm. Dhe kjo arrihet në se i dëgjojmë urdhrat e fesë dhe zërin e ndërgjegjes sonë! Ndershmërinë ta kemi jo vetëm në fjalët, por edhe në mendimet, në bisedat dhe në sjelljet e qëndrimet tona!

a. Në mendim

Që të jemi të ndershëm në fjalë e sjellje, duhet, së pari, ta kemi mendimin të ndershëm, pra, të jemi të ndershëm e të drejtë në mendim! Njeriu në fillim e mendon një punë, e planifikon, pastaj përpiqet ta zbatojë. Po që se njeriu nuk mendon drejt, edhe punët që do të bëjë, do të jenë të shtrembra, të gabuara! Prandaj, për të qenë të drejtë në mendim, duhet:

1. Të jemi besimtarë dhe të mësuar.
2. Të kemi zemër të pastër. Për askënd të mos mendojmë gjëra të këqia.
3. Të përpiqemi për të menduar drejt, për të ushqyer ndaj të tjerëve ndjenja të mira.

4. Të përpiqemi gjithmonë për t'i shtuar njohuritë tona, sepse njerëzit e pamësuar e të paditur zvarriten për në mendime të këqia.

Lexim letrar

Këshillat e gjyshit

Asimi po luante futboll me shokët. Kur pa se skuadra e tyre që mundur, filloi të grindej. Dhe, kështu, loja u kthye në thirrje e bërtitje të dyanshme, në grindje e gjer në sharje. E gjithë kënaqësia e lojës që kishin ndjerë gjer pak më parë, kishte marrë fund. Fëmijët qenë kthyer në armiq të njëri-tjetrit. Ishin gati të përfyteshin!

Në këtë mes, një plak që e kishte ndjekur lojën bashkë me të tjerë, hyri në fushë, u fut mes fëmijëve dhe u foli:

“Ç’po bëni, o bij! Ju jeni vëllezër! A kështu duhet sjellë ndaj vëllait? Përse ju ka dhënë Zoti gjuhë, sy e veshë, për të kërkuar të metat e njëri-tjetrit e për t’u sharë? Ashtu siç përpiqemi t’i mbajmë pastër trupin dhe rrobat, ashtu duhet të përpiqemi t’i kemi të pastra edhe zemrën dhe gojën! Në se papastërtia për trupin është një gjë e shëmtuar, më e shëmtuar është për zemrën dhe fjalën! Fjalët e këqia e fëlliqin gjuhën, kurse sjelljet e këqia, zemrën! Papastërtia e rrobave dhe e trupit hiqet me ujë, kurse e gjuhës është shumë e vështirë për t’u hequr, se gjuha le njolla dhe vraga të tilla që shpesh s’ka gjë që t’i pastrojë!”

b. Në fjalë

Kur themi ndershmëri, na vjen ndërmend, në përgjithësi, të folurit drejt, me zemërçiltërsi, pa gënjyer.

Në fenë tonë, fjala e drejtë është urdhër, kurse gënjeshtre është ndalim. Në Kur’an, Allahu urdhëron:

“O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe flisni drejt që Allahu t’jua mbarësojë punët e t’jua falë mëkatet!” (Kur’ani, Ahzab: 70-71)

Muslimanit i ka hije që, duke bërë siç thotë Allahu, të përpiqet për t’u bërë fjalëdrejtë. Ata që flasin gjithmonë drejt, arrijnë të fitojnë pëlqimin e Allahut. Njerëz të tillë duhen dhe respektohen edhe nga njerëzit. Ata fitojnë besimin dhe miqësinë e të gjithëve.

Në fenë tonë është ndaluar çdo lloj gënjeshtre. Nuk ka gënjeshtër të madhe e të vogël. Gënjeshtre nuk përdoret as për shaka. Mjafton një herë të gënjejë njeriu, pastaj i bëhet rrugë ose detyrohet të gënjejë. Më e mira është të bëjmë si urdhëron Allahu dhe të mos gënjejmë asnjëherë. Duhet jo vetëm gënjeshtre të mos nxjerrim prej goje, por as fjalë të pahijshme e zemërthyesë.

Megjithatë, mund të gënjehet vetëm në luftë për ta hutuar armikun dhe për t'u dhënë zemër tanëve, për t'i ngushëlluar të sëmurët si dhe për të mbrojtur jetën, nderin dhe pasurinë e njeriut. Feja jonë nuk quan gënjeshtër as fjalët e pavërteta të thëna me qëllim për të pajtuar dy vetë.

Në mënyrë të veçantë, e keqe është dëshmia e rreme, sepse ajo bëhet shkak për asgjësimin e drejtësisë dhe për shtimin e padrejtësive!

Gënjeshtria është kreu i të gjitha të këqia. Gënjeshtari e ka krejt të lehtë të bëjë edhe të këqia të tjera. Prandaj duhet t'u kushtojmë kujdes fjalëve tona dhe asnjëherë nuk duhet të shmangemi nga fjala e drejtë!

Lexim letrar

Ndershmëria çon në mirësi

Na ishte dikur një njeri që e kishte ngatërruar rrugën nën ndikimin e shokëve të këqinj. Luante kumar, grabiste, me një fjalë, bënte çdo lloj të keqe. Ato që fitonte, i shpenzonte po prapë në rrugë të këqia dhe nuk kujdesej aspak për familjen.

I ati plak ishte shumë i dëshpëruar për të birin. Mjerimi i të nipërve ia copëtonte zemrën plakut. Më në fund, nuk duroi dhe vendosi të bisedonte me të birin për ta shpëtuar nga kjo rrugë.

U takuan dhe plaku i foli kështu:

- O bir, dua të bisedoj ca gjëra me ty!

- Çfarë? - E pyeti shkurt i biri.

- Puna jote po më hidhëron shumë. Ke shokë shumë të këqinj. Veç me punë të këqia merresh dhe këtë të gjithë e dinë. Të lutem, hiq dorë nga kjo rrugë! Bëhu njeri i mirë! Kujdesu për fëmijët dhe bëhu shembull i mirë për ta! E keqja s'ka fund. Kush bën keq, një ditë prej ditësh edhe ai do të gjejë keq!

I biri i dha të drejtë të atit. Pasi u mendua ca, e pyeti:

- Mirë, po ç'kërkon prej meje, ç'duhet të bëj? Si mund të kthehem në rrugë të drejtë?

- Vetëm një gjë kërkoj prej teje, o bir, - i tha i ati. - Ji i ndershëm dhe më jep fjalën se nuk do të gënjesh!

- S'ka më të lehtë se kjo! - Iu përgjegj i biri. - Unë kujtova se diç do të më kërkoje! Kurrë s'kam për të gënjer! Këtej e tutje vetëm fjalë të drejta do të dalin prej gojës sime!

Me të vërtetë, njeriu nisi të fliste drejt. Dhe, ç'të shohësh? Menjëherë gjithçka ndryshoi tek ai! Nuk po grabiste më, nuk po luante më kumar! Fjala e drejtë e largoi atë nga të këqiat dhe, më në fund, u bë njeri i mirë! U pendua për gjithë ç'kishte bërë dhe e falenderoi Zotin për një baba të tillë. Dhe e kuptoi më mirë fjalën e Profetit:

"Duke folur e duke folur drejt, njeriu lartësohet te Allahu si njeri i drejtë!" (Buhari)

c. Në sjellje, në tregti, në matje e peshim

Ndershmëria dhe drejtësia në mendim marrin kuptim në se reflektohen në sjellje. Për shembull, personi që mendon dhe beson në domosdoshmërinë e mëshirës, edhe duhet ta shfaqë këtë ndaj të tjerëve. Në se dikush që thotë me fjalë se puna është e mirë, kurse vetë shtrihet si dembel e s'punon, fjalët e tij s'kanë asnjë vlerë!

Te njeriu, nuk duhet të ketë ndryshim mes fjalëve e veprave. Ai që sillet me respekt ndaj të tjerëve ndër sy, kurse pas shpine i përgojon ata, nuk është i ndershëm. I tillë është, bie fjala, edhe babai i cili, kur bie zilja e derës, e porositi të birin të dalë e të thotë se i ati nuk ndodhet në shtëpi.

Njeriu duhet ta ketë zemrën si pamjen, fjalët, si zemrën! Ndershmëria dhe drejtësia këtë kërkojnë. Poeti i shquar Xhelaledin Rumi e ka shprehur këtë të vërtetë kështu:

"O duku siç je në të vërtetë, o bëhu siç kërkon të dukesh!"

Edhe në tregti, edhe në matje e peshim duhet sjellë me ndershmëri e drejtësi.

Një ditë, Profeti po shëtiste nëpër tregun e Medines. Atje u ndal te një shitës. Para shitësit qëndronte një thes me tërshërë që dukej e thatë dhe e mirë. Profeti futi dorën dhe nxori një dorë tërshërë nga thellësia e thesit. Tërshëra ishte e lagur.

- Pse është e lagur brenda kjo? - E pyeti Profeti.

- Ra shi e ma lagu, - gënjeu burri.

Atëherë, Profeti i tha burrit:

“Pse e nxore pjesën e thatë sipër dhe jo të njomën që ta shihnin blerësit? Ai që bën hile e kërkon të na mashtrrojë ne, s’është i yni!”

Me këto fjalë, Profeti ka treguar se shitja me mashtrim e mallrave të dobëta, të prishura e të kalbura nuk është e drejtë. Muslimani nuk duhet të përpiqet për të fituar me rrugë të tilla të shtrembra dhe se një gjë e tillë është haram. Fitimi i arritur me mashtrim nuk ka dallim prej vjedhjes. Edhe Allahu i Lartë i paralajmëron kështu ata që bëjnë tregti të pandershme e që matin dhe peshojnë mangut:

“Mjerë ata që matin e peshojnë mangut, që, kur marrin, peshojnë e matin me të tepërt, kurse, kur japin, peshojnë e matin me mangësi! A s’e dinë ata se do të ringjallen një ditë, në një ditë të madhe kur njerëzit, duke u ngritur nga varret, do të dalin para Zotit?..” (Kur’ani, Mutaffifin: 1-5)

Muslimani nuk i gënjen të tjerët për asnjë çështje, edhe vetë përpiqet të mos gënjetet. Nuk ka dukë pasuria e fituar me rrugë mashtrimi. Nga një mall e pasuri e tillë nuk vjen asnjë e mirë, nuk ka dobi.

Feja jonë kërkon të jemi të ndershëm edhe në matje e peshim. Allahu i Lartë ka bërë të ditur se ata që matin e peshojnë mangut, do të ndëshkohen.

Nuk ka kënaqësi e lumturi në shoqëritë ku mungojnë drejtësia e ndershmëria. Njerëzit e vështrojnë njëri-tjetrin veç me dyshim!

Lexim letrar

Djali dhe hajdutët

Islami na thotë: “Mos u ndani prej të drejtës!”

Na ishte dikur një djalë. Ai kishte pasur shumë dëshirë të shkonte e mësonte në Bagdat që ishte, ato kohë, qendra arsimore, kulturore e shkencore e botës islame. Ai kishte pasur vetëm një nënë. Pasi ishte menduar mirë e mirë, fëmija kishte kuptuar se, për të shkuar atje, i duheshin dy gjëra të domosdoshme: pëlqimi i nënës dhe paratë. Dhe djali ia kishte rrëfyer dëshirën nënës. Ajo e kishte miratuar, pastaj i kishte qepur nën astarin e hirkës dyzet florinj që të mos i humbnin ose t’ia vidhnin, veçanërisht e kishte porositur që kurrë të mos gënjente!

Pastaj djali kish marrë bekimin e nënës, ish përshëndetur me të dhe ishte vënë në udhë duke u bashkuar me një karvan.

Kur karvani ishte afruar pranë qytetit Hemedan, ishte sulmuar nga një çetë hajdutësh. Njëri prej tyre e kishte pyetur djalin: “A ke para?” Djalit i ishte kujtuar se i kishte dhënë fjalën nënës se kurrë s’do të gënjente. Prandaj i tha hajdutit: “Po, kam

dyzet florinj të qepura brenda hirkës!” Hajduti kishte qeshur duke menduar me vete: “Ç’djalë shakaxhi që qënka!”

Pastaj, po kështu i kish ndodhur edhe me një hajdut tjetër. Më në fund, pasi kishin mbaruar punë me karvanin, hajdutët i ishin kthyer djalit. Kryehajduti e kishte pyetur po ashtu: “A ke para, o djalë?” Dhe djali i ishte përgjegjur: “U thashë edhe dy prej juve pak më parë: brenda hirkës kam të qepura dyzet florinj!” Kryehajduti kishte urdhëruar t’ia shqepnin astarin e hirkës dhe t’ia nxirrnin paratë në se me të vërtetë kishte. Me gjithë mend, nga hirka kishin dalë dyzet florinj! Hajdutët ishin shtangur. Kryehajduti e kishte pyetur djalin: “Florinj të i paske siguruar mirë, po pse tregove?”

“Sepse i kam dhënë fjalën nënës se kurrë s’kam për të gënjyer!”

Atëherë edhe kryehajduti ishte shtangur nga habia. Ç’djalë i drejtë, i guximshëm e besnik ndaj fjalës së dhënë, ç’dashuri dhe respekt për nënën!

Sjellja e djalit i kishte bërë hajdutët të vinin në vete, të pendoheshin për ç’kishin bërë gjer atëherë dhe ta ndryshonin jetën. U kishin kthyer pjesëtarëve të tjerë të karvanit gjërat e grabitura dhe i kishin thënë djalit:

“Na ktheve nga rruga e shtrembër! Tani na pri në rrugën e drejtë!”

Ja, pra, fëmijë të dashur! Fjala e drejtë, mbajtja e fjalës së dhënë, bindja, respekti dhe dashuria ndaj prindërve i sjellin njeriut veç të mira! Shpëtimi dhe lumturia janë te drejtësia dhe ndershmëria, te bindja ndaj prindërve!

3. DHEMBSHURIA DHE MESHIRA

Dhembshuria dhe mëshira janë ndjenja me burim hyjnor. Allahu i Lartë është Rahman dhe Rahim, mëshirues e bamirës. Mëshira e Tij rrethon gjithçka.

Profeti ynë i dashur ka thënë: *“Zoti e ndau mëshirën e Tij në njëqind pjesë. Nëntëdhjetë pjesë i mbajti pranë, një pjesë e zbriti në tokë. Ja, pra, në saje të kësaj pjese, krijesat tregojnë mëshirë ndaj njëra-tjetrës. Madje kafsha-nënë as këmbën s’e lëviz se mos e dëmtojë të voglin e saj!”* (Buhari-Myslim) Me këtë, Profeti ka dashur të thotë se ndjenja e mëshirës nuk u është dhënë vetëm njerëzve, por edhe kafshëve! Mëshira është një ndjenjë e lartë pikërisht sepse është pjesë e mëshirës hyjnore!

Allahu është më i mëshirshmi i të mëshirshmëve! (Kur’ani, Araf: 51) **Allahu është më i dobishmi i të mëshirshmëve!** (Kur’ani, Mu’minun: 118)

Edhe njerëzit duhet të kenë mëshirë për njëri-tjetrin, duhet të tregojnë dhembshuri për njëri-tjetrin! Kjo është një detyrë morale e dhënë njerëzve. Allahu nuk i mëshiron ata që nuk e çojnë në vend këtë detyrë, që nuk kanë ndjenjën e dhimbjes për të tjerët. Ndaj njerëzve të tillë zemërgurë as njerëzit vetë nuk tregojnë dhembshuri.

Profeti ynë ushqente mëshirë dhe dhembshuri të thellë për fëmijët, pleqtë, të sëmurët, bonjakët, të varfërit dhe të vetmuarit, madje edhe për kafshët.

Një ditë, te Profeti shkoi një njeri. Me vete kishte edhe një fëmijë. Sapo njeriu nisi ta puthte fëmijën, Profeti e pyeti: *“A të vjen keq për të?”* Njeriu iu përgjegj: *“Po!”* Atëherë, Profeti tha: *“Me dhembshurinë për fëmijën edhe ti je i denjë për mëshirën e Allahut! Sepse Allahu është më i mëshirshmi i të mëshirshmëve!”*

Një ditë tjetër, kur Profeti puthi nipin e vet, Hasanin, një njeri që i ndodhej pranë, i tha: *“Unë kam dhjetë fëmijë, por gjer më sot nuk kam puthur asnjërin prej tyre!”* Atëherë, Profeti tha: *“Ata që s’tregojnë mëshirë për njerëzit, as Allahu s’i mëshiron!”* (Myslim)

Ngjarjet e rrëfyera më lart na tregojnë ne se Profeti i donte shumë fëmijët dhe i këshillonte muslimanët që edhe ata të tregoheshin të dhembshur e të mëshirshëm ndaj fëmijëve.

Duhet të sillemi të mëshirshëm jo vetëm ndaj njerëzve, por edhe ndaj kafshëve. Nuk duhet të harrojmë se edhe ata kanë shpirt. Në të kaluarën muslimanët kanë pasë ndërtuar spitale për mjekimin dhe strehimin e shpendve dhe zogjve shtegtarë të sëmurë a të plagosur. Kanë pasë formuar fonde për ushqimin e kafshëve pa zot, veçanërisht qenve e maceve. Të gjitha këto tregojnë se sa e zhvilluar ka qenë te ata ndjenja e mëshirës dhe dhembshurisë!

Vajza e qumështshitësit

Kur Hz. Osmani ishte kalif, një herë, po shëtiste natën nëpër rrugicat e Medines për të bërë një kontroll. Një çast dhe, nga shtëpia afër së cilës po kalonte, i zunë veshët një bisedë. Një grua i thoshte të bijës:

“Moj bijë, na sill ca ujë t’ia hedhim qumështit!”

Kurse vajza e kundërshtonte:

“Aman, moj nënë, a s’ka nxjerrë lajmërim kalifi që të mos i hedhim qumështit ujë?”

Kurse e ëma ngulte këmbë në të sajën:

“Moj bijë, e ku do ta marrë vesh kalifi në këtë orë të natës se ne po i shtiem ujë qumështit?”

Megjithatë, vajza donte që pa e thyer nënën, ta bënte të hiqte dorë nga ajo punë:

“Ç’po ndodh kështu me ty, moj nënë? Pse mendon kështu? Po s’na pa kalifi, mos vallë edhe Zoti s’do na shohë? Eshtë gjynah, moj nënë, mos!”

Kalifi Omer u largua pa zë, siç kishte ardhur. Të nesërmen, sapo u gdhi, dërgoi shkesë dhe e fejoj atë vajzën me të birin. Pastaj, njërin nga vajzat e lindura nga kjo martesë, kalifi emevit, Mervan, e mori për të birin, Abdylaziz. Nga kjo martesë, Abdylazizit i lindi një djalë i cili njihet në historinë islame si “Omeri i Dytë” dhe është Omer b. Abdylazizi i njohur për drejtësi ashtu si edhe vetë Hz. Omeri i famshëm.

Omer b. Abdylazizi qe martuar me të bijën e të ungjit kalif. Kur u bë vetë kalif, një ditë, bëri këtë bisedë me të shoqen:

“Grua! Ti e di se njeriu s’është as flori e as diamant. Njeriu është njeri në atë masë sa ç’rri larg prej gjërave të ndaluara prej Allahut. Tani unë dua që flarinjtë e tu t’i marr e t’i fus në thesarin e shtetit. Fundja, yt atë i pati bërë këta flarinj me shpenzimet e thesarit!”

E shoqja pranoi menjëherë!

Në këtë mes, kalojnë kohë dhe Omeri vdes. Vëllai i të shoqes bëhet kalif. Dhe ai e thërret një ditë të motrën dhe i thotë:

“Motër, flarinjtë e tu vazhdojnë të qëndrojnë në thesarin e shtetit. Po të duash, mund t’i marrësh prapë!”

Duke hequr me shpirt një “oh!”, e motra e kundërshtoi:

“Jo, o vëlla! E pse duhej të tregohesha unë e bindur ndaj tim shoqi kur qe gjallë e, tani që s’është, jo?”

4. KREU “NAS” DHE KUPTIMI I TIJ

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ (١) مَلِكِ النَّاسِ (٢) إِلَهِ النَّاسِ (٣) مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ
الْخَنَّاسِ (٤) الَّذِي يُوَسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ (٥) مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ (٦)

Kuptimi: “Thuaj: “Mbështetem te Zoti i njerëzve, sunduesi i njerëzve, i adhuruari i njerëzve, prej sherrit të provokatorit të maskuar që fut pasiguri e lëkundje në zemrat e njerëzve, cilido qoftë ai, prej xhindëve a prej njerëzve!”

PERMBLEDHJE

1. Ç’kuptoni me fjalën “njeri zemërpastër”?
2. Si mund ta arrijmë pastërtinë shpirtërore?
3. Ç’gjëra duhen bërë për pastërtinë e trupit?
4. Shkruani ajetet dhe hadithet që dini mbi ndershmërinë.
5. Ç’do të thotë të jesh i ndershëm në tregti, në matje e peshim?
6. Cilat janë ajetet dhe hadithet që dini mbi mëshirën dhe dhembshurinë?

BURIMET

Kur'an-ı Kerim

Sahih-i Buhari

Sahih-i Müslim

İslam İlmihali – Ö. Nasuhi Bilmen

İslam İlmihali – İ. Ansiklopedisi

İslam Ansiklopedisi – Türkiye Diyanet Vakfı

Din Kültürü ve Ahlâk Bilgisi – Doç. Dr. H. Algül, Doç. Dr. Osman Çetin, Yrd. Doç. Dr. Mustafa Öcal – Altın Kitaplar Yayınları

Din Kültürü ve Ahlâk Bilgisi – Vehbi Vakkasoğlu

M. Yaşar Kandemir, Allah'a İnanıyorum, Meleklerle İnanıyorum, Peygamberlere İnanıyorum, Ahirete İnanıyorum, Kadere İnanıyorum – Damla Yayınları